




NJË DITË *me* PROFETIN

[sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

ABDULVEHAB TUREJRI



NJË DITË ME PROFETIN

[SAL-LALLAHU ALEJHI VE SEL-LEM]



Shkup, 2019

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",
Скопје

28-29

TUREJRI, Abdulvehab

Një ditë me Profetin : (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) /

Abdulvehab Turejri ; [përktheu Osman Osmani]. - Shkup : Furkan,
2019. - 200 стр. ; 21 см

Превод на делото: A day in the life of Muhammad. - Фусноти кон
текстот

ISBN 978-608-216-174-7

COBISS.MK-ID 110404362

Abdulvehab TUREJRI

NJË DITË *me* PROFETIN

[sal-lallahu alejhi ve sel-lem]



Furkan ISM
2019

Autor:

Abdulvehab TUREJRI

Titulli i librit në gjuhën angleze:

A day in the life of Muhammad

NJË DITË ME PROFETIN

[sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Përktheu:

Osman OSMANI

Redaktor:

Hasan BAFTIJARI

Lektor:

Agim ABAZI

Radhitja kompjuterike:

Bleta OSMANI

Kopertina:

Jusuf SALIU

Botues:

SHB “Furkan ISM”

Brigada II Maqedonase lok 22, 1000 Shkup

Tel: (02) 26 22 360

<http://www.furkan.com.mk>

E-mail: furkan@furkan.com.mk

Shtypi:

Furkan Print - Shkup

Tel: (02) 26 22 360

Copyright©Furkan ISM, 2019

Tirazhi:

500

Parathënie

Qëllimi i këtij libri është paraqitja e një skene të plotë të programit njëditor të jetës së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ashtu që t'i identifikojmë qëllimet të cilat duhet t'i imitojmë, në mënyrë që të mund të nxjerrim pastaj nga jeta e tij atë që do ta vë jetën tonë në rrugën e duhur: *“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër...”* (El-Ahzab: 21)

Në vazhdën e ditës së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe ngjarjeve të jetës së tij, gjejmë atë që është përsosmërisht konsistente me përvojën njerëzore, në kontekstin më të gjerë dhe në aspektet e zakonshme. Kështu, do të mund ta shohin shembullin më të afërt të madhështores, njerëzores dhe praktikes: *“Thuaj ‘SubhanAllah - i Madhërishëm është Zoti im, a mos jam unë tjetër vetëm se njeri, Pejgamber?’”* (El-Isra: 93)

Shumica e librave rreth jetës së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kanë një qasje historike, që do të thotë e paraqesin jetën e tij. Në

anën tjetër, libri që ke në duar paraqet jetën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nga një perspektivë tjetër, kryesisht, praktikat e tij të zakonshme ditore. Neve, pa dyshim, kemi nevojë për të dyja, prandaj edhe duhet ta shikojmë jetën e tij të bekuar nga perspektivat tjera.

Skenat që janë paraqitur në këtë libër, nuk kanë ndodhur në një ditë. Ajo çfarë ndodhte në një ditë, jo doemos ndodhte çdo ditë. Megjithatë, vlera e tyre e përgjithshme, na e jep për së afërmi një panoramë të asaj që ndodhte në një ditë të jetës së tij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Hyrje

Ja qyteti i hurmave dhe zemrave të gjalla! Këtu jeton zemra e tij. Është vendi i tij, qyteti i tij, populli i tij. Është qyteti në të cilin çdo gjë u gjallërua, kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në të nisi të jetojë. Banorët e këtij qyteti dhe natyra e tij e donin shumë të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ja mali i Uhudit, me të cilin ai kishte një marrëdhënie të dashurisë së ndërsjellë! Këto rrugica të ngushta i njohin gjurmët e tij. Këtu është xhamia e tij dhe ngjitur me të janë edhe dhomat e tij të vogla. E këtu, në xhami, mbledhen një grup i madh i njerëzve, të etur për ta ndjekur atë dhe për t'iu bindur urdhrave të tij. Me ta, ai ka një lidhje të pastër të dashurisë së ndërsjellë. Ai është gjithmonë me ta, por lidhja e tij e veçantë është me Allahun e Madhërishëm.

Do të shikojmë se si i Dërguari i Allahut, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i menaxhonte ditët e tij, orë pas ore, ashtu që ta kemi një panoramë në thjeshtësinë e jetës së tij, spontanitetin e jetës së tij serioze, ekuilibrin e përsosur në

mes të aktiviteteve dhe përmbushjen e nevojave të tij.

Do të shohim gjallëri të vërtetë në jetën e tij, derisa akrepat e orës ndjekin njëri-tjetrin. Në ditën e tij, çdo çast është i begatë. Asnjë sekondë nuk tretet, nuk humbet kot. Marrëveshjet me vetë jetën bëheshin në çdo sekondë në shtëpinë e tij, në xhami, nëpër rrugicat e Medinës, në shtëpitë e shokëve të tij, në rrogozin e fortë ku ai ulej, gjatë ngrënies së ushqimit, në shtrat dhe kur bëhej gati për të fjetur.

Sahabët e tij ishin gjithnjë syhapur e vigjilentë; përpiqeshin ta ndjekin çdo fjalë dhe çdo veprim të tij. Edhe nata e errët nuk mund t'i fshehte dhe mbulonte veprimet e tij nga ato zemra të dashura, të cilat dëshironin të dinin se si ai e kalonte madje edhe natën. Asnjë mur nuk ishte aq i lartë, sa ta fshehte jetën e tij private. Që të dyja, si zemrat, ashtu edhe sytë, ishin me të në shtëpi, derisa ai shkonte në shtrat. Ata e shikonin mëshirën e njerëzimit, derisa ky i fundit flinte gjumë, dhe e vëzhgonin edhe pasi zgjohej.

Ai nuk ishte thjesht një njeri i zakonshëm, i cili e niste mëngjesin i freskët, e pastaj lodhej dhe ishte

më pak energjik në mbrëmje. Rrjedhja e vazhdueshme e energjisë së tij, ju bën të mendoni se çdo çast ishte një fillim i ri. Ai ishte njeriu i çastit; i çdo çasti. Asnjë mundësi nuk i humbiste dot atij, asnjëherë të vetme. Si një Pejgamber dhe i Dërguar i Allahut, ai instinktivisht e kuptonte se çdo çast duhej të llogaritej; duhej t'i shërbente një qëllimi të dobishëm. I njëjti rregull zbatohej çdo orë dhe çdo ditë; secila duhej t'i kishte arritjet e saj.

Në shoqëri njëditore me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Në faqet në vijim, do të jetojmë me të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], mëngjes e mbrëmje. Do të ecim me të në rrugët e Medinës; do ta ndajmë ushqimin e tij modest; do ta dëgjojmë zërin e tij të dashur, se si ai i mëson shokët e tij, dhe gjithashtu, do ta dëgjojmë atë, përplot përulësi, derisa falet dhe lutet. Do të ulemi pranë tij në rrogzin e tij modest dhe do të ndajmë pak ushqim me të, të cilin ai gjithmonë ishte i gatshëm që t'ua jepte të tjerëve.

Mund të hyni në shtëpinë e tij, të përshkruar nga përshkrimi i shokëve të tij. Mund ta shihni atë në gjumë, në qetësi të përsosur; dhe mund ta shihni të zgjuar në aktivitete të plota. Mund ta shihni një fëmijë të vogël në prehrin e tij, ose një vocërrak mbi supet e tij, duke e ndjerë ngrohtësinë dhe bekimin e të qenit afër tij.

Është e drejtë të pyesni: Si vallë, ky njeri i madh, ky i Dërguar fisnik, e përdori natyrën e tij njerëzore në rolin e tij si i Dërguari i Zotit? Si ia

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

doli mbanë me ciklin e përditshëm të jetës? Si e kaloi ditën e tij?

Le të zbulojmë së bashku, se si ky njeri: I Dërguari i Allahut, udhëheqësi, babai, bashkëshorti dhe shoku, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i kalonte ditët e tij.

Kjo është ajo që ne do ta trajtojmë në librin:
“Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]”.

Në agim me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Drita e hershme e agimit depërton nëpër errësirën e natës. Në të njëjtën kohë, zëri i Bilalit [radijallahu anhu] thyen heshtjen e natës në Medinë, derisa ai e bën thirrjen për namaz, e thirr ezanin. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në ato çaste është në gjumë, duke pushuar paksa në agim, pasi e ka kaluar pjesën më të madhe të natës në këmbë, duke falur namaz nate.

Kur Bilali [radijallahu anhu] bën thirrjen për namaz, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] zgjohet. Merr misvakun dhe i pastron dhëmbët. Pastaj thotë: *“Falënderimi i qoftë Allahut, i Cili na ktheu sërish në jetë pasi na bëri të vdekur (në gjumë)”*¹

¹ Në mbrojtjen e mesazhit të tij të Islamit, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e lidhi vdekjen me gjumin. Ai citohet t’u ketë thënë shokëve të vet: *“Pasha Allahun, ju do të vdisni, ashtu sikurse flini; dhe do të ringjalleni, ashtu sikurse zgjoheni.”* Kur’ani Fisnik gjithashtu sugjeron një ngjashmëri të fortë mes vdekjes dhe gjumit. Ai thotë: *“Allahu i merr shpirtat kur është momenti i vdekjes së tyre (i vdekjes së trupave të tyre), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur, e atij që i është caktuar vdekja e mban (nuk e kthen), e atë tjetrin (që nuk i është caktuar vdekja, por është në gjumë), e lëshon (të kthehet) deri në afatin e caktuar. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon.”* (Ez-Zumer: 42)

dhe tek Ai do të tubohemi." Pastaj i përgjigjet thirrjes për namaz, duke përsëritur atë që thirrësi thotë. Kur thirrësi thotë: *"Allahu Ekber, Allahu Ekber"*, d.m.th., *"Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi"*, edhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: *"Allahu Ekber, Allahu Ekber."* Kur thirrësi thotë: *"Esh'hedu en la ilahe il-Allah"*, d.m.th., *"Dëshmoj se nuk ka të adhurar tjetër me meritë përveç Allahut"*, edhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përsërit atë, duke u paraprirë me fjalën *"ve ene"*, që do të thotë: *"Edhe unë gjithashtu dëshmoj një gjë të tillë."* Thirrësi pastaj vazhdon: *"Esh'hedu ene Muhameden Resul Allah"*, d.m.th., *"Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguar i Allahut"*, edhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i përsërit, duke u paraprirë nga fjala *"edhe unë"*. Thirrësi mandej i nxit njerëzit, duke thënë: *"Haj ale Salah; Haj alel Falah"*, d.m.th., *"Ejani në namaz; ejani në shpëtim."* Pas secilës frazë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thotë: *"S'ka forcë e as fuqi, përveç Allahut."* Frazat përfundimtare të ezanit përsëritin se Allahu është Një dhe theksojnë Njëshmërinë e Tij. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i përsërit ato sikurse i thotë thirrësi (*muezini*).

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më pas e shton këtë lutje: *“O Allahu im, Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit që do të falet, jepi Muhamedit ndërmjetësim për ne (Ditën e Gjykimit) dhe nderim, ngrite atë në vendin e lavdishëm që ia ke premtuar.”*

Pastaj ngrihet. Në qoftë se ka nevojë për dush, dush bën, e në qoftë se ka nevojë vetëm për abdes, abdes merr. Nganjëherë, hyn në namaz pa marrë abdes fare. Dikush mund ta pyeste nëse një gjë e tillë është në rregull. Ai ua kthente: *“Vetëm sytë më flenë gjumë mua, përderisa mendja më ngelet vigjilente.”*

Pastaj i fal dy rekate² sunet të sabahut. Kurrë nuk ishte aq i shpejtë në kryerjen e faljes së namazit sunet, sikur në rastin e namazit të sabahut; i falë dy rekate të shkurtra. Ato ishin aq të shkurtra, saqë dikush mund të vriste mendjen nëse ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e kishte përfunduar këndimin e sures së parë, *Fatihasë*, e cila është

² Rekat është njësi e namazit, si e atij obligativ, ashtu edhe e atij vullnetar. Kështu, një namaz përbëhet nga 2, 3 ose 4 rekate. Çdo rekat fillon me pozitën në këmbë, ku adhuruesi këndon Kur'an. Rehati gjithashtu përfshin rukunë, që do të thotë përkuljen dhe dy sexhde me një ulje të shkurtër në mes tyre. Në të gjitha këto, adhuruesi e madhëron dhe lavdëron Allahun Fuqiplotë.

obligative për t'u kënduar në çdo rekat të namazit. Në fillim të këtyre dy rekateve, ai kryesisht e këndonte suren *El-Kafirun*:

“Thuaj: “O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni! As ju nuk jeni adhures të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhures i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju nuk do të jeni adhures të Atij që unë adhuroj! Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!” (El-Kafirun: 1-6)

Në rekatën e dytë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kryesisht e këndonte suren *El-Ihlas*:

“Thuaj: Ai, Allahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.” (El-Ihlas: 1-4)

Në disa raste, në rekatën e parë të këtyre suneteve e këndonte ajetin:

“Ju (besimtarë) thuani: “Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë

kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur.” (El-Bekare: 136)

Ose e këndonte:

“Thuaju (o i Dërguar): “O ithtarë të Librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos Allahut!” E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!”” (Ali Imran: 64)

Ose:

“E kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim (dhe qëllimin që ta mbysin), tha: ‘Kush janë ndihmëtarët e mi për në rrugë të Allahut?’ Havarijunët thanë: ‘Ne jemi ndihmëtarë të fesë së Allahut, ne i besuam Allahut, e ti dëshmo për ne se jemi muslimanë (të bindur, të dorëzuar)! Zoti ynë, ne e besuam atë që e zbrite (shpalljen), e pasuam të Dërguarin (Isain), pra shënona bashkë me ata që dëshmojnë (besimin e drejtë)!”” (Ali Imran: 52-53)

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte gjithmonë i rregullt në faljen e dy rekateve sunet para namazit farz të sabahut. *“Këto dy rekate, janë më të çmuara për mua sesa e gjithë bota dhe ajo që ndodhet në të.”*, thoshte ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Në qoftë se e gjente bashkëshorten zgjuar, pasi t’i kishte mbaruar këto dy rekate, i adresojte në mënyrë miqësore dhe të dashur. Sa e lumtur është një grua, e cila e fillon ditën me një bisedë të këndshme me bashkëshortin e saj!

Në qoftë se ajo ishte ende në gjumë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], mbështetej në anën e tij të djathtë, derisa të bëhej koha për faljen e namazit obligativ (farzit të sabahut).

Kur Bilali [radijallahu anhu] shihte se njerëzit ishin mbledhur në xhami, afrohej pranë dhomës së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe thërriste: “Koha për namaz, o i Dërguar i Allahut.” I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pastaj dilte në xhami dhe u printe njerëzve në namaz. Kur dilte nga shtëpia, ngrinte kokën kah qielli dhe thoshte:

“Në emër të Allahut. Atij i mbështetem. Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde, ashtu që të mos humbi e të mashtrohem; që të mos gaboj e të shkoj rrugës së gabuar; që të mos e dëmtoj askënd e as të dëmtohem; dhe që të mos sillem me injorancë e as mos të vuaj nga sjellja injorante.”

Kur hynte në xhami, thoshte:

“Kërkoj prej Allahut të Madhërishëm, me Fytyrën e Tij të ndershme dhe fuqinë e Tij të përhershme, të më mbrojë nga shejtani i mallkuar.”

Kur Bilali [radijallahu anhu] e shihte të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] duke hyrë në xhami, bënte thirrje për të filluar namazin, d.m.th., e thërriste *ikametin*. E kur shokët e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e shihnin këtë të fundit duke ardhur, ngriheshin për t’u falur dhe rreshtoheshin në *safa*.

Shpesh derisa u printe në namaz, i pikonte ujë nga koka - në rast se bënte dush. Në raste të rralla, shkonte në xhami, pastaj thirrej *ikameti* dhe besimtarët rreshtoheshin e ai qëndronte në vendin e tij për të udhëhequr namazin. Pastaj, i

kujtohej se ishte në gjendje të papastër.³ Ua bënte me dorë shokëve të tij, duke aluduar: “*Qëndroni në pozitat tuaja.*” Mandej, kthehej në shtëpi, bënte dush të shpejtë dhe dilte ashtu me flokë të lagura, e të cilat ende i pikonin ujë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk i fshihte çështjet e tilla dhe as nuk ndjehej i turpëruar për to. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte thjesht një qenie njerëzore e zakonshme, jeta e të cilit pasqyronte të gjitha aspektet normale të jetës së një njeriu. Ashtu siç thotë Kur’ani Fisnik në referencë me llojin e të Dërguarit që Allahu e dërgoi tek populli:

“Sikur ta bënim Ne atë (të Dërguarin) Engjëll, atë do ta bënim (në formë) njeriu e do t’ua përziem (ngatërronim) atyre atë që i përzien ata vetes së tyre.” (El-En’am: 9)

Kur i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], qëndronte në vendfalje, nga ku e udhëhiqte namazin, sigurohej që rreshtat e tyre të

³ Gjendja e papastërtisë, d.m.th., *xhunubllëku*, i referohet gjendjes kur një njeri nuk mund të falë namaz derisa të bëjë dush, që siguron larjen dhe pastrimin e tërë trupit me ujë. Ky quhet pastrim i madh ose *gusël*. Njeriu është në gjendje të papastër pas ejakulimit që vjen nga eksitimi seksual në një marrëdhënie intime, masturbimi ose nga ëndrrat e qullosura. Gruaja është në gjendje të papastër gjatë menstruacioneve ose pas marrëdhënieve seksuale.

drejtoheshin. U thoshte njerëzve: *“Drejtoni rreshtat dhe qëndroni afër njëri-tjetrit. Drejtimi i rreshtave është pjesë e përsosjes së namazit.”* Pastaj e fillonte namazin duke thënë: *“Allahu Ekber”*. Derisa e thoshte këtë, i ngriste dy duart lartë dhe pastaj e vendoste dorën e djathtë mbi të majtën. Pastaj, pa e ngritur zërin fare, thoshte: *“O Allah, më largo mua nga gjynahet e mia, siç e ke larguar lindjen nga perëndimi. O Allah, më pastro nga gjynahet e mia, sikurse pastrohet rroba e bardhë nga njollat. O Allah më pastro prej gjynaheve të mia me borë, shi dhe akull.”*

Pasi e mbaronte këtë lutje në heshtje, e këndonte me zë të lartë suren e parë të Kur’anit, *El-Fatihanë*, sure kjo, obligative për t’u kënduar në çdo rekat. E këndonte shumë qartë, duke pushuar në fund të secilit ajet, veç e veç. Kështu fillonte: *“El-hamdu lilahi rabbil alemin”* (Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve) dhe paузonte. *“Er-Rrahmani Rrahim”* (Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit) dhe paузonte. *“Maliki jevmid-din”* (Sunduesit në Ditën e Gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)), e kështu me radhë. Në këndimin e tij, i zgjaste zanoret: ‘a-në’ e dytë të *El-Rahman* dhe ‘i-në’ e *El-Rahim*, më të gjata se

ekuivalentet e tyre. Pas kësaj, këndonte pjesë të tjera nga Kur'ani, një pjesë më të gjatë në rekatin e parë dhe një më të shkurtër në rekatin e dytë. Në dy rekatet së bashku, këndonte mes 60 dhe 100 ajeteve kur'anore. Kjo është në përputhje me udhëzimet kur'anore mbi këndimin e Kur'anit në namazin e sabahut: *"Fale namazin kur zbret (nga zeniti) dielli, e deri në errësirën e natës dhe duke bërë lutjen (namazin) e agimit. Vërtet, lutja e agimit është e përcjellë."* (El-Isra: 78) Ditëve të xhumasë, zakonisht e këndonte suren *Es-Sexhde* në rekatin e parë dhe *El-Insan* në rekatin e dytë.

Ndonjëherë, pas ngritjes nga rukuja në rekatin e dytë, shtonte ndonjë lutje, veçanërisht në rast se ndonjë sprovë a fatkeqësi godiste komunitetin musliman. I lutej Allahut të që t'ia largojë sprovat dhe t'i jap rehati e fitore komunitetit musliman. Poeti, Abdullah ibn Ravahu, shoqërues i Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nga radhët e Ensarëve, e përshkroi këtë skenë si më poshtë:

"Mes nesh është i Dërguari Allahut: Derisa drita vezulluese depërton përmes errësirës në agim, ai është duke e kënduar Librin e Allahut."

Kur e mbaronte faljen e namazit, thoshte, derisa ende qëndronte ulur në vendin e tij, i kthyer në drejtim të kibles: *“Kërkoj faljen e Allahut!”* Këtë e përsëriste tri herë. Pastaj shtonte: *“O Allah, Ti je shpëtimi dhe prej Teje është shpëtimi. I lartësuar qofsh Ti që je i Madhëruar dhe Fisnik.”* Më pas kthehej në të djathtën e tij, ose kohë pas kohe edhe në të majtën e tij. Kur kthehej përballë shokëve, gjëja e parë që ata e dëgjonin të thotë ishte: *“O Zot, më kurse nga dënimi Yt në ditën kur do t'i ringjallësh robërit e Tu.”*

Pastaj fillonte ta madhërojë Zotin e tij me fjalët:

“S’ka të adhuroar tjetër përveç Allahut, Një dhe të pashoq. Atij i takon sundimi dhe lavdërimi. Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send. O Allah, atë që Ti e jep, s’ka kush që e ndalon, dhe atë që Ti e ndalon, s’ka kush që e jep. (Te Ti) nuk ka vlerë dobia e askujt, sepse çdo dobi vjen prej Teje.”

“S’ka të adhuroar tjetër përveç Allahut Një dhe të pashoq. Atij i takon sundimi dhe lavdërimi dhe Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send. S’ka ndryshim e as fuqi pa ndihmën e Allahut. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe nuk e adhurojmë askënd përveç Tij.

Dhuntitë dhe mirësitë janë prej Tij dhe vetëm Atij i takon lavdërimi më i mirë. S'ka të adhuruar tjetër përveç Allahut. Atij i besojmë dhe i nënshtrohemi me sinqeritet, edhe pse këtë e urrejnë jobesimtarët."

"I pastër është Allahu (nga të metat që ia përshkruajnë), Allahut i takon falënderimi, Allahu është më i madhi. S'ka të adhuruar tjetër përveç Allahut Një të pashoq, Atij i takon sundimi dhe lavdërimi dhe Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo send."

Pastaj e lavdëronte Allahun e Madhërishëm në format e zakonshme: *"SubhanAllah"* - i pa të meta është Allahu; *"Elhamdulillah"* - të gjitha lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun; dhe *"Allahu Ekber"* - Allahu është më i Madhi.

Kështu, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vazhdonte me lutjet kryesore të përcaktuara për mëngjes:

*"Derisa e fillojmë këtë mëngjes, i gjithë sundimi i përket Zotit. Të gjitha falënderimet i takojnë Atij. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Atij që nuk ka ortak."*⁴

⁴ Vihet re se theksimi i Njëshmërisë së Allahut ishte shumë i fortë në lutjet e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Njëshmëria e Allahut, është besimi qendror islam. Për këtë arsye, është i theksuar shumë shpesh. Duke e përsëritur atë shpesh, muslimani

Atij i takon i gjithë sundimi dhe lavdërimi. Ai është në gjendje të bëjë çdo gjë. O Zoti im, të lus që të më japësh mirësinë e kësaj dite dhe mirësinë e asaj që ajo përfshin, dhe mirësinë që vjen pas saj. Kërkoj strehim tek Ti ndaj të keqes së kësaj dite dhe asaj që vijon pas saj. Kërkoj mbrojtje tek Ti ndaj përtesës dhe gjendjes së mjerueshme të mplakjes. Më mbroj ndaj mundimit në Zjarrit dhe mundit në varr.”

I përsëriste këto fraza edhe në mbrëmje, duke e zëvendësuar referencën e mëngjesit me referencë të mbrëmjes.

“Zoti im, të lutem që të më japësh mirëqenie në këtë jetë dhe në jetën që vjen. Më fal dhe më jep siguri në besim, jetë, familje dhe pasuri. Më jep strehim që t’i mbuloj të metat e mia dhe siguri për ta qetësuar frikën time. Më mbro nga para, prapa, djathtas, majtas dhe sipër. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga rreziku që mund të më gëlltit nga nën mua.”

Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk harronte ta thotë këtë lutje në mëngjes dhe në mbrëmje.

mbetet gjithmonë i vetëdijshëm për llojin e marrëdhënieve që ka me Allahun.

Ndër lutjet e tij ishte edhe:

“Zoti im, më jep shëndet në trupin tim; të dëgjuarit tim; shikimin tim. Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Teje. Zoti im, kërkoj strehim nga mosbesimi dhe varfëria; kërkoj strehim nga dënimi në varr. Nuk ka zot tjetër përveç Teje.”

Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i përsëriste këto fraza tri herë në mëngjes dhe në mbrëmje.

Gjatë kësaj kohe, njerëz anekënd Medinës shkonin te i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] duke bartur enë uji mbi supe. Dëshironin që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] t’ua bekonte ujin. I kërkonin që ai ta fuste dorën në ujërat e tyre. Kështu vepronte ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] me secilin. Ndodhte që këtë ta bënin edhe gjatë mëngjeseve të ftohta, por prapëseprapë ai e fuste dorën në enët e tyre.

Ç’pamje madhështore! I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], me fytyrën e tij rrezatuese, duke i shikuar këto duar të çiltra, të cilat dosido e kërkonin bekimin e dorës së tij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Pothuajse po i shohim derisa i afrohen Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili si rrjedhojë, mbjell dashuri në zemrat e tyre. Të lumtura ishin ato fytyra që e fillonin ditën me një shikim të ngrohtë të fytyrës rrezuese të Dërguarit të Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Në mëngjes me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Pasi i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe shokët e tij e përfundojnë namazin e sabahut dhe madhërimin ndaj Allahut të Lartësuar, afrohen mes vete. Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shikon rreth e përqark shokëve të tij, derisa ende ngelet ulur në vendin nga ku e ka falur namazin. Kur kthehet nga ta, drita e mëngjesit e shfaqë shkëlqimin e fytyrës së tij. Kishte një fytyrë të shndritur dhe të bardhë, sikur pothuajse dielli po reflektonte në fytyrën e tij. Kushdo që e shikonte, e shihte të vërtetën në fytyrën e tij, ashtu siç Abdullah ibn Selami [radijallahu anhu] ka thënë: “Kur e shikova fytyrën e tij, e kuptova se nuk ishte fytyra e një gënjeshtari.”

Ndodhte të fillonte me ndonjë paralajmërim, siç është transmetuar nga Irbad ibn Sarija: “Një ditë, pas namazit të sabahut, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] na e dha një këshillë të zjarhtë, e cila bëri që lot të buronin nga sytë e të pranishmëve; u shqetësuan të gjithë. Njëri tha: “O i Dërguari i Allahut, kjo tingëllon si këshilla e

dikujt që ofron lamtumirën. Ç'na këshillon të bëjmë?" Ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tha: *"Ju bëj thirrje që t'ia keni frikën Allahut; ta dëgjoni dhe t'i bindeni prijësit tuaj, edhe në qoftë se ai është një rob i zi. Ata që do të jetojnë gjatë, do të shohin shumë polemika. Kujdes nga gjërat devijuese, pasi ato çojnë në humbje. Kushdo që jeton deri atëherë, le të qëndrojë në rrugën time (d.m.th. Sunetin tim) dhe rrugën e ndjekur nga pasardhësit e mi - drejtë të udhëzuar. Kapuni fort për të."*

Paralajmërimi i të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk ishte shumë i shpeshtë. Këtë e bënte me masë, ashtu që njerëzit të mos mërzhiten.

Kur shokët mblidheshin rreth tij, ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kthehej nga ta dhe i pyeste:

"A është ndokush i sëmurë, ashtu që të shkoj ta vizitoj?"

Në qoftë se përgjigjja e tyre ishte mohuese, ai pyeste:

"A mos vallë ka ndërruar jetë ndokush, ashtu që të marrë pjesë në varrimin e tij?"

Pyeste për këdo që mungonte në tubim.

Ishte një grua e zezë, e cila e pastronte xhaminë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] një ditë pyeti për të. Shokët i treguan se ajo kishte ndërruar jetë. Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] reagoi: *“Pse nuk më keni njoftuar?”* Shokët menduan se ajo nuk ishte e rëndësishme, ndaj edhe i thanë: *“O i Dërguar i Allahut, ajo vdiq gjatë natës dhe u varros. Nuk dëshiruam të të zgjonim nga gjumi.”* I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u kërkoi që t’ia tregonin varrin e saj, dhe kështu, vajti atje, ia fali namazin e xhenazes dhe u lut për të.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vuri re se shoku i tij, Thabit ibn Kajs ibn Shamasi [radijallahu anhu] po mungonte, me ç’rast pyeti: *“Pse nuk po e shoh Thabit ibn Kajsin? Mos vallë është i sëmurë?”* Sa’d ibn Mu’adhi [radijallahu anhu] ia ktheu: *“Ai është fqinji im dhe nuk kam dëgjuar gjë për të.”* Kështu, Sa’di [radijallahu anhu] i vajti në vizitë dhe e gjeti në shtëpi. Ai e kishte mbyllur derën dhe ishte ulur e po qante. Sa’di [radijallahu anhu] e pyeti se ç’kishte ndodhur? Thabiti [radijallahu anhu] iu

përgjigj: “Mjerë për mua. Allahu thotë: *“O ju që keni besuar, mos ngreni zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos iu ngërmoni atij si i ngërmoheni njëri-tjetrit, e të zhduken veprat tuaja duke mos ditur ju.”* (El-Huxhurat: 2) Unë jam njeri me zë të lartë. Kam frikë se të gjitha veprat e mia mund të treten dhe të mbaroj në zjarr të Xhehenemit.” Me ta mësuar këtë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i tha Thabitit [radijallahu anhu]: *“Ti nuk je njëri prej tyre. Ti do të jetosh mirë dhe do të vdesësh mirë. Ti u përket banorëve të Xhenetit.”*

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pyeste për shokët e tij. Madje, nuk e harronte asnjërin prej tyre. Në të vërtetë, që të gjithë ata kishin pozita të veçanta te ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Kushdo që e pasonte, merrte pjesën e tij të mirëseardhjes dhe kujdesit. Ata që mungonin, nuk harrohehin dot. Sahabëve u kërkoheshin që të konfirmonin nëse shokët e tyre që nuk ishin të pranishëm, ishin shëndosh e mirë. Nuk ka nevojë të thuhet, por kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për forcimin e lidhjeve shoqërore dhe konsolidimin e ndjenjave të atyre që i përkasin komunitetit musliman.

Në seancën e hershme të mëngjesit, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndodhte t'i

pyeste shokët e tij rreth ëndrrave të tyre. Ai u thoshte: *“Kushdo që ka parë ndonjë ëndërr, nëse dëshiron, mund të ma rrëfejë, dhe unë do t’ia interpretoj atë.”* Ata ia rrëfenin ëndrrat e tyre, ndërsa ai ua interpretonte ose ua tregonte dobinë e tyre. Një shembull i kësaj natyre është transmetuar nga Abdullah ibn Selami [radijallahu anhu]: *“Pashë një ëndërr derisa i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte ende gjallë. E gjeta veten në një kopsht shumë të gjerë dhe të shkëlqyer, me një shtyllë të hekurt në mesin e saj. Shtylla ishte shumë e thellë në tokë dhe arrinte deri në qiell. Në krye të shtyllës ishte një lakore. Mu tha që të ngjitem në të. Unë thashë: “Nuk mundem!” Një shërbëtor erdhi përpara dhe më ngriti nga shpina. U ngjita në krye dhe u kapa për lakore. Mu tha që të shtrëngohem fort për të. Pastaj u zgjova nga gjumi duke e ndjerë sikur lakorja ishte ende në dorën time. Më pas, ia rrëfeva ëndrrën të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më tha: “Ky kopsht është Islami, dhe shtylla është shtylla kryesore e Islamit. Lakorja paraqet mbështetjen më të fortë. Ajo do të thotë se do të kapeni për Islam derisa të vdisni.”*

Një ish-rabin hebre, i cili e përqafoi Islamin menjëherë pas ardhjes së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në Medine, Abdullah ibn Selam [radijallahu anhu], jetoi edhe plot 35 vjet të tjera pas vdekjes së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Gjatë këtyre viteve, grupe të caktuara njerëzish u larguan nga Islami dhe e luftuan shtetin musliman, në atë që njihet si “luftërat kundër femohuesve.” Abdullah ibn Selam [radijallahu anhu] qëndroi i vendosur në radhët e Islamit, ashtu siç i tha i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] se do të vepronte. Ai ngeli në Islam deri në vdekje. Interpretimi i ëndrrës së tij nga i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], sugjeroi në mënyrë implicite se një valë e daljes nga feja do të ndodhte, por se Abdullahu nuk do t’u bashkohej renegatëve. Kjo mund të merret si shenjë që e konfirmon statusin e tij si I Dërguar i Allahut.

Një ditë prej ditësh, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u kërkoi shokëve të tij që t’ia transmetojnë ëndrrat, natyrisht nëse ndonjëri prej tyre kishte parë ndonjë, ashtu që ai t’ua interpretonte ato pastaj. Njëri prej tyre i tha: “O i Dërguari i Allahut, pashë në ëndërr se si një re lëshonte gjalpë dhe mjaltë. Kishte nga njerëzit

që përpiqeshin ta kapnin atë me duart e tyre. Disa morën më shumë, e disa më pak. Pashë gjithashtu një litar që ngrihej nga toka e deri lart në qiell. Të pashë ty duke u mbajtur për të dhe duke u ngjitur deri lart. Pastaj, një njeri tjetër po mbahej për të pas teje, edhe ai u ngjit; pastaj një tjetër, edhe ky u ngjit lart. Më pas, kapet i treti, por litari këputet. Ai (litar) pastaj rilidhet dhe ai vazhdon e ngjitet lart.”

Ebu Bekri [radijallahu anhu] tha: “O i Dërguari i Allahut, të lutem, më lejo mua që ta interpretoj.” I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i dha leje dhe Ebu Bekri [radijallahu anhu] vazhdoi: “Reja është Islami dhe njëherit hija e komunitetit të tij. Gjalpi dhe mjalti, që është Kur’ani, pasi Kur’ani është sa i ëmbël aq edhe i pasur. Sa u përket atyre që grumbulloheshin rreth tij, janë njerëzit që mësojnë shumë nga Kur’ani dhe të tjerët që mësojnë pak prej tij. Litari që shtrihej nga toka e deri në qiell, është e vërteta që ju e përkrahni. Allahu i Lartësuar do ta ngritë statusin tuaj me anë të së vërtetës. Pas jush, një njeri do t’i kapet asaj dhe do të ngjitet lart; edhe një tjetër do ta bëjë të njëjtën gjë. Pastaj, i treti do ta kapë atë, por litari këputet para se të tërhiqet

për të dhe ai (njeri) do të ngjitet lart. Të lutem, o i Dërguari i Allahut, më thuaj nëse e interpretova drejtë apo jo?" Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia ktheu: *"Drejtë e interpretove në disa aspekte dhe jo drejtë në disa të tjerë."* Ebu Bekri [radijallahu anhu] pyeti: "Për Allahun, më trego se ku ia qëllova e ku jo?" *"Mos bëj be!"* - ia ktheu i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Duhet theksuar se ëndrrat që shokët e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia rrëfenin atij, ishin relevante me preokupimet e tyre kryesore dhe çështjet që i shqetësonin ata më së shumti, domethënë, besimin e tyre. Jeta e tyre ishte e fokusuar në besim; ata luftonin për të gjatë ditës dhe e merrnin me vete edhe në shtrat. Si rrjedhojë, ai (besim) pasqyrohej në ëndrrat e tyre. Mund të çuditeni me shokët e Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: sa afër tij ishin dhe sa të shqetësuar ishin për besimin e tyre. Në të vërtetë, preokupimi i tyre rreth besimit shtrihej që nga orët e zgjimit nga gjumi, e deri në kohën e gjumit dhe në ëndrrat e tyre.

Nganjëherë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ua rrëfente ndonjë

ëndërr që kishte parë, para se t'ua tregonte interpretimin e saj. Samure [radijallahu anhu] transmeton se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i pyeti një ditë, në qoftë se ndonjëri prej tyre kishte parë ndonjë ëndërr. Pasi nuk gjeti përgjigje pohore, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], tha: *“Natën e kaluar, i pashë dy burra të vinin drejt meje, pastaj më morën për dore dhe më dërguan në një tokë të shenjtë...”* Hadithi pastaj përmend ëndrrën e gjatë, duke përfshirë disa nga gjendjet e njerëzve që e meritojnë ndëshkimin e Zotit dhe shkaqet e ndëshkimit të tyre. Hadithi përfshin gjithashtu edhe disa aspekte të botës tjetër.

Ky sesion përfshinte ndonjë bisedë mes shokëve të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dhe, edhe ai merrte pjesë në diskutimin e tyre, ose dëgjonte se çfarë ata kishin për të thënë. Ata ndodhte të flisnin rreth ditëve të tyre paraislame dhe praktikave gjatë injorancës, dhe se si më pas e kuptuan idenë e gabuar të praktikave të tilla. Flisnin për ndriçimin që Islami ua dha. Derisa diskutonin të tilla gjëra, qeshnin me injorancën e tyre të kaluar. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndodhte të buzëqeshte, pasi ai, në përgjithësi, buzëqeshte në shumicën e rasteve.

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], normalisht qëndronte në xhami derisa dielli të lindte dhe të ishte plotësisht shkëlqyes.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pastaj vazhdonte tek dhomat e grave të tij. Kur dilte nga xhamia, ai thoshte: *“Me emrin e Allahut. Përshëndetja dhe paqja qofshin mbi të Dërguarin e Allahut. O Allah, të lutem vetëm Ty, që të më japësh nga të mirat e Tua. O Allah, më ruaj nga shejtani i mallkuar.”*

Gjëja e parë që e bënte pasi hynte në shtëpi, ishte pastrimi i dhëmbëve. Pastaj e përshëndeste familjen e tij me përshëndetjen islame: *“Eselamu Alejkum”* (Paqja e Allahut qoftë me ju!)

E vizitonte secilën nga gratë e tij, i përshëndeste të gjitha dhe lutej për to, pa qëndruar gjatë me ndonjërën prej tyre. Ndodhte të hynte në dhomën e ndonjërës prej tyre dhe ta gjente atë në vendin e saj të faljes, dhe më pas nuk e pengonte. Është transmetuar se një ditë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] hyri në dhomën e Xhurvejrijes [radijallahu anha] dhe e gjeti atë në vendin e saj të adhurimit, duke përlëvduar Allahun e Lartësuar. Kështu, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u kthye nga kishte ardhur, duke e lënë atë

të vazhdojë në çfarëdo adhurimi që ajo ishte e angazhuar.

Ndonjëherë dëshironte të hante dhe thjesht pyeste: “A ka ndonjë gjë për të ngrënë?” Nëse kishte, ia sillnin. Në shumicën e rasteve, ishte ushqim shumë i thjeshtë dhe i lehtë, si: hurma, qumësht ose *el-hajs*⁵, ose mund të ishte thjesht një gotë qumështi ose *nebidh* (musht)⁶. Në qoftë se nuk kishte asgjë, ai thoshte: “Atëherë, po agjëroj sot.”

⁵ Kjo është një përzierje e hurmave, qumështit dhe gjalpës, të cilën arabët e bënë, veçanërisht për ta marrë me vete kur udhëtonin, pasi ishte e lehtë për t'u bërë dhe ishte ushqim i qëndrueshëm.

⁶ Arabët bënë pije nga hurmat, rrushi i thatë ose mjalti, duke i vënë në ujë dhe duke i lënë ato ashtu për një ditë ose më shumë. Pijet e tilla janë të lejueshme, nëse ato nuk shndërrohen në verë, ku pastaj bëhen të ndaluara.

Në xhami me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Pasi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i vizitonte të gjitha gratë e tij, kthehej përsëri në xhami. Kur hynte brenda saj, i falte dy rekate të shkurtra namaz përshëndetës ndaj xhamisë. Zakonisht e falte këtë namaz pranë një shtylle të quajtur *Shtylla el-Muhaxhirin*,⁷ e cila ndodhet në mes të hapësirës së bekuar *El-Ravda*. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shpesh e zgjedhte atë hapësirë për të falur namaz vullnetar.

Pastaj ulej në xhami, tek hapësira e quajtur *El-Ravda*, me shpinë të kthyer nga dhoma e Aishes [radijallahu anha]. Sahabët mblidheshin rreth tij. Ky takim ishte takim i rregullt, i njohur për të gjithë, ashtu që kushdo që dëshironte diçka nga ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], të mund të

⁷ Muhaxhirin, është emri i dhënë shokëve të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], të cilët emigruan në Medinë me të dhe u vendosën atje. El-Ravda, do të thotë “kopsht”. Në këtë kontekst i referohet një hapësire të vogël në mes të xhamisë së Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në mes të shtëpisë së tij dhe minberit, ku e mbante hutben ditën e xhuma. Çdo vizitor në xhaminë e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është i prirë që të falet atje, pasi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përshkroi atë si një kopsht të Xhenetit.

vinte dhe ta takonte në xhami. Ndodhte që me të të ishin një numër i vogël ose i madh i shokëve të tij, varësisht nga rrethanat dhe koha e secilit prej tyre. Nëse ishte vetëm një numër i vogël, atëherë ata e formonin një rreth përreth tij. Por, nëse ishin më shumë, uleshin në dy rreshta, në të djathtën dhe në të majtën e tij, ashtu që ndonjë i panjohur, i porsaardhur, të mund të vinte deri tek ai, dhe kushdo që kishte ndonjë pyetje, të mund të afrohej më afër tij.

Kur ulej pranë shokëve, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] bisedonte me ta. Ai ishte më elokuenti në mesin e njerëzve. Gjithkush dëshironte ta dëgjojë atë, pasi fjalimet e tij ishin të mrekullueshme. As nuk fliste shumë shpejt dhe as shumë ngadalë, duke zgjedhur që t'i shqiptojë fjalët e tij në mënyrë të qartë, ashtu që, sikur dikush të dëshironte t'i numëronte fjalët e shqiptuara nga goja e tij, nuk do ta kishte të vështirë. Aishja [radijallahu anha] ka thënë: "I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nuk fliste me aq gjatësi siç bëni ju. Ai fliste shumë qartë, ashtu që kushdo që ulej që ta dëgjonte, do të mund të mësonte përmendësh atë që thoshte ai."

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shpesh kalonte në dialog, duke filluar me ndonjë pyetje. Parashtronte ndonjë pyetje paraprakisht, ashtu që ta rriste interesimin e të pranishmëve në gjetjen e përgjigjes. Në një rast, ai pyeti:

“A t’ju tregoj se cili është gjynahu më i rëndë?”

Të pranishmit ia kthyen: “Urdhëro, o i Dërguari i Allahut!”

“T’i shoqëroni ortak Allahut, të jeni mosrespektues ndaj prindërve dhe të dëshmoni rrejshëm.” - ua ktheu ai.

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shpeshherë parashtronte ndonjë pyetje, sa ta tërhiqte vëmendjen dhe kërshërinë e të pranishmëve. Një shembull i tillë është rasti kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pyeti: *“A e dini se kush është i falimentuar?”*

Të pranishmit thanë: “I falimentuar është ai që nuk ka para e pasuri.”

Por, I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua ktheu: *“I falimentuar në Umetin tim është ai/ajo që në Ditën e Gjykimit vjen me vepra të mira, me*

namaz, agjërim, zekat dhe sadaka, por që gjatë jetës së tij në dynja, ka abuzuar dikë, ka shpifur ndaj një tjetri, i ka marrë para padrejtësisht të tretit dhe mund ta ketë vrarë dikë dhe rrahur ndonjë tjetër. Ai detyrohet që t'i japë secilit nga veprat e tij/saj të mira si kompensim. Nëse veprat e tij të mira shteren para se t'ua kthej hakun, atëherë disa prej gjynaheve të tyre merren nga ta dhe i jepen atij/asaj. Në fund fare, hedhet në zjarr!"

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shpeshherë parashtronte ndonjë pyetje, në mënyrë që sahabët të mendonin shumë rreth përgjigjes. Një ditë prej ditësh, pasi e pranoi një enë me hurma, i pyeti të pranishmit:

"Më tregoni, cila pemë i ngjason muslimanit: asaj nuk i bien gjethet dhe jep fruta në çdo kohë."

Sahabët përmendën lloje të ndryshme të pemëve, që rriteshin në vende të ndryshme, por, përkundër përpjekjeve, nuk ia qëllonin dot. Abdullah ibn Omeri [radijallahu anhu], i cili atëbotë ishte më i riu në mesin e shokëve të pranishëm të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], mendoi se ishte palma e hurmës, por shikoi nga njerëzit përreth tij që ishin, si: Ebu Bekri dhe babai i tij, Omer bin El-Hatabi

[radijallahu anhum], dhe nuk foli fare. Atëherë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua shpallosi përgjigjen: *“Është palma e hurmave”* - tha ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Nganjëherë, i përsëriste disa prej fjalëve, që i thoshte nga tri herë, në mënyrë që të sigurohej se ajo ishte kuptuar mirë, ose për ta theksuar rëndësinë e tyre. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], madje ndodhte që ta përsëriste atë më shpesh, vetëm për të shtuar rëndësinë e saj. Kjo ndodhi, për shembull, kur i radhiti gjynahet e mëdha, duke shtuar: *“... dhe gjithashtu, gënjeshtër e qëllimshme dhe dëshmia e rreme.”* Ai vazhdoi t’i përsëriste këto fjalë, derisa të pranishmit dëshironin që ai të ndalej, duke e parë seriozitetin e shëmtueshmërisë së këtyre veprave.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ndodhte që në ndërkohë të bënte ndonjë pyetje të papritur, ashtu që të dalë me një përfundim të papritur. Për shembull, ai një ditë i pyeti shokët e vet: *“Kush prej jush është duke agjëruar sot?”*

Ata ishin krejtësisht të papërgatitur për një pyetje të tillë. Po ta kishin ditur se ai, [sal-lallahu

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

alejhi ve sel-lem], mund t'i pyeste për një gjë të tillë, që të gjithë do të kishin agjëruar atë ditë. Për këtë arsye, heshtën të gjithë, përveç Ebu Bekrit [radijallahu anhu], i cili u lajmërua si agjërues i asaj dite.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shtroi pyetjen e dytë: *"Kush prej jush ka vizituar ndonjë të sëmurë sot?"*

Përsëri, vetëm Ebu Bekri [radijallahu anhu] u ngrit.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shtroi dhe pyetjen tjetër: *"Kush prej jush ka marrë pjesë në ndonjë varrim sot?"*

Të gjithë heshtën, përveç Ebu Bekrit [radijallahu anhu], i cili konfirmoi se kishte marrë pjesë në një funeral.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pyeti edhe një herë: *"Kush e ka ushqyer një të varfër sot?"*

Të gjithë të pranishmit heshtën prapë, përveç Ebu Bekrit [radijallahu anhu], i cili tha se e kishte ushqyer dikë.

Atëherë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Në qoftë se një njeri i kombinon që të katërtat në një ditë, ai me siguri do të hyjë në Xhenet.”*

Pejgamberi Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndonjëherë përdorte gjësende të ndryshme për të ilustruar disa kuptime, siç bëri një herë kur foli mbi humbjen e besimit.⁸ Ai tha:

“Një njeri mund të shkojë në shtrat dhe besimi t’i jetë larguar nga zemra, duke lënë vetëm një gjurmë të atillë si djegia e lëkurës. Ai përsëri mund të shkojë në shtrat dhe besimi t’i jetë larguar nga zemra, duke lënë një gjurmë të atillë si ajo e punës së krahut.⁹ Megjithatë, ajo është si një shenjë e zjarrit, e cila është mbështjellë mbi këmbën tuaj dhe e djegë atë.¹⁰ Ju e shihni efektin e saj, por nuk ka asnjë substancë në të.”

⁸ Në hadithin vijues ‘amaneti’ i referohet vetë besimit, si ajo me të cilën Zoti e ka ngarkuar njeriun. Kjo i referohet ajetit kur’anor: *“Ne u ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë, u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejtë vetes, dhe ishte padijshëm.”* (El-Ahzab: 72) Hadithi flet për dobësimin e besimit në zemrën e dikujt, si rezultat i veprimeve të tij. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e shpreh këtë në mënyrë metaforike, derisa shkon të flejë gjumë.

⁹ I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] këtu i referohet ndikimit të punës së krahut, si përdorimin e një sēpate për të prerë diçka të vështirë për t’u prerë. I duhet shumë kohë për t’u zhdukur.

¹⁰ Kjo është një referencë për rezultatin e djegies së lëkurës, e cila lë flluska të plota të lëngjeve.

Pastaj e kapi një guralec dhe e rrokullisi mbi këmbën e tij.

Nganjëherë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], përdorte ndonjë vizatim për të ilustruar disa kuptime. Ai, një ditë e vizatoi një katror, me një vijë horizontale në mes, e cila shtrihej përtej katrorit. Pastaj shtoi disa vija të shkurtra pingul vijës në mes. Më pas i pyeti shokët e tij:

“A e dini se çfarë është kjo?”

Ata thanë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më miri.”

“Kjo vijë horizontale në mes, e përfaqëson njeriun, ndërsa këto vijat e shkurtra rreth saj, janë sprovat që e godasin atë. Ato i vijnë njeriut nga të gjitha anët. Nëse kjo (vijë) e huç atë (njeriun), tjetra do ta sulmojë. Ky katror është fundi i jetës së tij, i cili në fund do ta kapë atë. Kjo vijë që shkon përtej katrorit është shpresa e tij. Ai shpreson për gjërat që shkojnë përtej jetës së tij, përderisa vdekja do t'i vijë së shpejti.” - ua ktheu ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Kjo ishte një seancë e edukimit dhe këshillimit, por mësimi dhe këshillimi nuk jepej si një leksion i njëanshëm. I Dërguari [sal-lallahu alejhi

ve sel-lem] ishte i etur për përdorimin e një dialogu, ku nxënësit do të mund të involvoheshin në proces. Ishte një dialog interaktiv, që kishte për qëllim t'i pasuronte nxënësit intelektualisht.

Një tipar i rëndësishëm i këtij sesi, ishte lutja e shpeshtë e kërkimfaljes. Shokët e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vunë re se Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] gjithmonë pendohej dhe kërkonte falje. Ata e llogarisin në 100 numrin e kërkimfaljes që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], bënte gjatë një seance:

“O Zoti im, më fal mua dhe prano pendimin. Ti je i Vetmi që pranon pendimin dhe fal shumë.”

Ndodhte që fëmijët e vegjël të silleshin tek ai, derisa ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte në seancën e mëngjesit në xhami. Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] lutej për ta dhe merrte një hurmë, të cilën e zbuste në gojën e tij paraprakisht, dhe ua jepte pastaj atyre. Shpeshherë i emëronte dhe i bekonte ata.

Një rast i kësaj natyre është kur Ebu Usejd Malik ibn Rabi'a el Sa'idi e solli djalin e tij të por-salindur, Mundhirin, te Pejgamberi [sal-lallahu

alejhi ve sel-lem]. Ky i fundit, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e kapi fëmijën në krah, derisa babai biologjik rrinte ulur pranë tij. Pastaj, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u angazhua me diçka. Ebu Usejdi urdhëroi dhe dikush nga familjarët e tij e mori fëmijën dhe u ktheu në shtëpi. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u alarmua kur pa se fëmija nuk ndodhej aty. Me habi, pyeti: *“Ku është fëmija?!”*

Ebu Usejdi i tha: “O i Dërguari i Allahut, e dërguam në shtëpi.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e pyeti rreth emrit të fëmijës.

Iu tregua, por Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i tha: *“Jo! Mos ia vë këtë emër. Emërtoje Mundhir.”*

Ebu Usejdi e respektoi pëlqimin e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe e emëroi fëmijën me emrin Mundhir.

Shpesh të Dërguarit të Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i ofroheshin frutat e hershme të hurmave, pasi hurmat ishin fruti kryesor në Medine. Ata gëzoheshin kur i shihnin frutat e

para që kishin filluar të piqen dhe ia çonin të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Kur i merrte ato, ai lutej:

“Zoti ynë, bekoi frutat tona dhe bekoje qytetin tonë; beko pjesën tonë të vogël dhe beko atë të madhe. Zoti im, Ibrahim i ishte rob, mik dhe Pejgamber i Yti, dhe unë jam rob dhe Pejgamber i Yti. Ai u lut për Mekën dhe unë po të lutem për Medinën, me të njëjtat kushte siç u lut ai për Mekën dhe dyfishin e asaj.” - pastaj e thërriste fëmijën më të ri dhe ia jepte ato.

Ndonjë shaka e këndshme ndodhte të thuhej në kohëra të tilla. Fakti që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte serioz dhe se njerëzit e respektonin shumë, nuk i ndalonte shokët e tij nga sjellja ose komentet spontane.

Një ditë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po u fliste shokëve të tij, kurse në mesin e tyre ishte edhe një beduin. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], tha:

“Një njeri në Xhenet, i kërkoi Allahut leje për të mbjellë një pemë. Allahu e pyeti: “A nuk t’i kam dhënë të gjitha që i dëshiroje?” Njeriu tha: “Po, Zoti im, por më pëlqen të merrem me bujqësi.” Njeriu pastaj i mbolli farat dhe sa hap e mbyll sytë bimët u rritën

plotësisht dhe ishin të gatshme për vjelje.¹¹ Bimët ishin të mëdha sa malet. Allahu i tha: “Ja atë që e dëshirove, o biri i Ademit. Asgjë nuk të kënaq ty.”

Pasi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përfundoi rrëfimin, beduini ia ktheu:

“O i Dërguari i Allahut, pasha Allahun, ky njeri duhet të ketë qenë nga Kurejshët ose Ensarët. Ata janë të vetmit që u pëlqen bujqësia. Sa na përket ne beduinëve, neve nuk kemi asgjë të bëjmë me këtë.” Të gjithë të pranishmit qeshën, sikurse edhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Duket se kjo seancë ishte ajo kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i priste delegacionet vizituese. Udhëtarët zakonisht qëndronin natën jashtë Medinës dhe hynin në qytet në mëngjes, kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ndodhej në seancën e mëngjesit me shokët e tij. Një delegacion i tillë ishte ai që erdhi nga Mudari. Vajtën ata te i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] aty kah mesdita dhe ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], menjëherë e kuptoi se ata ishin në varfëri të

¹¹ I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po flet këtu për një ngjarje në Xhenet. Ky proces i bujqësisë do të përfundojë sa hap e mbyll sytë dhe nuk paraqet asnjë vështirësi për Zotin e Plotfuqishëm.

skajshme. Fytyrën e tij e kaploi zyrtësia, kur e pagjendjen e tyre. Pasi e fali namazin e drekës me xhemat, iu drejtua masës dhe u kërkoi të japin lëmoshë. Shumë shpejt sahabët sollën një grumbull rrobash dhe ushqimesh. Një delegacion tjetër ishte ai i fisit Abdul Kajs, i cili erdhi nga Alhasa në Arabinë Lindore. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i përshëndeti ngrohtësisht: *“Mirë se erdhët te populli i këtij delegacioni; as nuk do të poshtëroheni, e as nuk do të ndjeni keqardhje.”*

Ndoshta kjo ndodhi atëherë kur Meleku Xhibril [alejhis-selam] erdhi te i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në formën e një njeriu, rrobat e të cilit ishin jashtëzakonisht të bardha, ndërsa flokët jashtëzakonisht të zeza. Asnjë shenjë e udhëtimit nuk shihej në të dhe asnjëri prej të pranishmëve nuk e njohu atë. Ai e pyeti të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] për Islamin, imanin (besimin), ihsanin¹² dhe shenjat e Ditës së Fundit.

¹² Është e vështirë që të nxjerrët kuptimi i ihsanit në një ose dy fjalë. Gjuhësisht, *ihsan*, do të thotë: ‘veprim i duhur, mirësi, bamirësi, sinqeritet, etj.’ Rrënjët e saj nënkuptojnë gjithashtu ‘të njohurit e diçkaje ose të qenit i aftë në të.’

Mbase kjo ka mundur të ndodhë në një seancë të atillë kur Dimam ibn Tha'laba erdhi për të takuar të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. E lidhi devenë e tij afër xhamisë dhe i pyeti të pranishmit: "Kush prej jush është nipi i Abdul-Mutalibit?"

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] iu përgjigj: "*Jam unë.*"

Dimami i tha: "Do të ta bëj një pyetje dhe do të jetë e vështirë. Mos e merr atë si shumë të vështirë."

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia ktheu: "*Mund të pyesësh çfarëdo që dëshiron.*"

Dimami tha: "Të pyes për Zotin, Zotin tuaj dhe Zotin e të gjithë atyre që kanë qenë para teje. A të ka dërguar Allahu si të Dërguarin e Tij për të gjithë njerëzimin?"

"*Po, për Zotin.*" - ia ktheu i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Ai pastaj e pyeti për detyrat kryesore të Islamit dhe Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] iu përgjigj.

Vazhdoi Dimami: “Pasha Atë që të ka dërguar me mesazhin e vërtetë, as s’do të shtoj nga këto, e as nuk do të pakësoj asgjë.”

Pasi u largua që aty, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Ky njeri e mësoi mirë atë që i thashë. Do të hyjë në Xhenet në qoftë se është i vërtetë në fjalën e tij.”*

Kjo seancë e rregullt, shërbente si këshillë konsultative për Umetin musliman, ku diskutoheshin ngjarje të mëdha. Këtu u zhvillua konsultimi para se të merrej një vendim për t’u përballur me sulmin e ushtrisë së jobesimtarëve në betejën e Uhudit. Këtu u mor edhe vendimi për të gërmuar një hendek të thellë në mbrojtje të Medinës nga forcat e kombinuara të jobesimtarëve dhe hebrenjve në Luftën e Hendekut. Edhe çështje tjera të mëdha diskutoheshin aty. Asnjë udhëheqës nuk është konsultuar me shokët e tij, si Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vepronte kështu në përputhje me urdhrin e Allahut: *“... e konsultohu me ta në të gjitha çështjet.”* (Ali Imran: 159)

Shokët e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], me rend i ndiqnin takimet dhe seancat e

rregullta me të. Kjo gjë është përmendur nga Omer ibn el-Hatabi [radijallahu anhu], i cili thotë: “E kisha një fqinj ensar në zonat e larta të Medinës. Me radhë shkonim për t’i ndjekur mësimet e të Dërguarit të Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai shkonte një ditë, kurse unë shkoja të nesërmen. Kur shkoja unë, i tregoja për të gjitha gjërat që i mësonim atë ditë, duke përfshirë edhe çdo gjë që shpallej nga Kur’ani. Edhe ai e bënte të njëjtën gjë.”

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ulej me shokët e tij në këto takime, si njëri prej tyre. Nuk kishte asnjë shenjë që e dallonte atë nga të tjerët. Një i huaj mund të vinte dhe nuk do ta dinte se kush ishte Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Shpesh delegacionet pyesnin se cili nga ta ishte Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Thjesht, nuk mund ta dallonin atë nga të tjerët, përveç se me fytyrën e tij të ndritshme. Kur pyeteshin, sahabët thoshin: “Ai njeriu me fytyrë të ndritur; ai mbështetur atje, është Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].”

Një ditë, ata i sugjeruan të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] që t’ia bëjnë një stol të

ulët të baltës, ashtu që kur ndonjë i huaj të vinte, të mund ta dallonte atë. U pajtua mëshira e njerëzimit, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], me propozimin në fjalë dhe ashtu u veprua. Kjo ishte, megjithatë, në fund të jetës së tij të bekuar, në vitin e nëntë hixhri, i cili njihet si “Viti i Delegacioneve”.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e ndante buzëqeshjen dhe vëmendjen e tij në mënyrë të barabartë në mesin e shokëve të tij. Kur këta të fundit ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre, secili mendonte se ai ishte shoku i preferuar i të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Ndonjëherë, Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i sillej ushqim kur ai ishte me shokët e tij dhe që të gjithë së bashku e ndanin atë. Samure ibn Xhundubi transmeton: “Ishim me Pejgamberin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kur një tabak *tharid*¹³ iu ofrua atij. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], hëngri prej saj, siç bënë edhe të pranishmit. Ata vazhduan të hanë, grup pas grupi, derisa pothuajse u bë mesditë. Një njeri e pyeti nëse ushqimi në tabaka po rimbushej, e ai, [sal-lallahu

¹³*Tharid* ishte gjella kryesore që arabët e gatuanin. Përbërësit e tij kryesor ishin buka dhe mish.

alejhi ve sel-lem], u përgjigj: *“Jo nga toka. Po rimbushet vetëm nga qielli.”*

Një herë, një dele iu dhurua atij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në një kohë kur ushqimi ishte i paktë në Medine. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i tha familjes së vet: *“Përgatiteni këtë dele, merreni këtë bukë, prijeni në copa të vogla dhe lyeni me tharid.”* Ai kishte një tabak të madh, të quajtur *el-Gharra*, i cili duhej bartur nga katër burra. Në mëngjes, pasi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe shokët e tij e falën namazin vullnetar të duhasë, tabaka iu soll dhe njerëzit u mbledhën rreth tij. Ishin të shumtë në numër. Një beduin e pyeti: *“Nga cila anë të ulemi, o i Dërguari i Allahut?”* I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Zoti i Plotfuqishëm më ka bërë mua rob mikpritës të Tij. Nuk më ka bërë diktator kokëfortë. Hani nga pjesët më të poshtme dhe lërini majat, në mënyrë që ajo të bekohet.”* Pastaj shtoi: *“Merrni nga ushqimi dhe hani. Pasha Atë, i Cili e mban shpirtin e Muhamedit në Dorën e Tij, tharidi i tokave të Persisë dhe Bizantit do të jetë në duart tuaja. Ushqimi juaj do të jetë aq i*

bollshëm, saqë njerëzit do të hanë¹⁴ pa përmendur emrin e Allahut."

Kjo seancë mund të ishte e gjatë ose e shkurtër, ashtu siç situata e kërkonte ose siç rrethanat e diktonin. Në pjesën e vonë të mëngjesit, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ngrihej. Sa herë që i përfundonte tubimet me shokët e tij, i përfundonte duke thënë:

"Zoti im, e pafund është lavdia Jote dhe i gjithë lavdërimi të përket vetëm Ty. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Teje. Lutem të më falësh dhe pendohem për çdo gjynah."

Dikush i tha: "Nuk të kemi dëgjuar më parë t'i thojë këto fjalë."

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ia ktheu: *"Këto fjalë sigurojnë faljen e çdo gjynahu që mund të ketë ndodhur në tubim."*

Gruaja e tij, Aishja [radijallahu anha] pyeti: "O i Dërguari i Allahut, vura re se i thua këto fjalë

¹⁴ Është Sunet i konfirmuar që para se të fillojmë të hamë ushqim, duhet të themi: "Në emër të Allahut." Një lutje e shkurtër për ta begatuar ushqimin tonë, mund të shtohet gjithashtu.

për t'i përmyllur tubimet, këndimin e Kur'anit dhe lutjet. Pse?"

"Për dikë që ka thënë diç të mirë, këto fjalë do të jenë vullë e karakterit të tij deri në Ditën e Gjykimit; kurse për dikë që ka thënë diç të keqe, ato do t'ia kompensojnë fjalët e tij të këqija." - qe përgjigjja e krijesës më të mirë.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] rrallë herë largohet nga një tubim me shokët e tij, pa i thënë këto lutje:

"Zoti ynë, na bëj që të të frikësohemi Ty, ashtu që të mos jemi të pabindur ndaj Teje. Na jep bindje të atillë ndaj Teje, e cila na e mundëson ta fitojmë Xhene-tin; dhe na jep besim të mjaftueshëm, për të ndriçuar fatkeqësitë e jetës. Zoti ynë, na e ruaj dëgjimit tonë, shikimin dhe fuqinë gjatë gjithë jetës sonë. Bëj që ankesa jonë të jetë vetëm kundër atyre që janë të padrejtë ndaj nesh, dhe na jep fitore mbi ata që janë armiqësor për ne. Mos lejo që ndonjë fatkeqësi të ndodhë në besimin tonë. Mos na bëj nga ata që këtë botë kanë shqetësimin kryesor ose kufirin e njohurive. Mos u jep pushtet mbi ne atyre që nuk kanë mëshirë."

Pastaj, shokët e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shpërndareshin. Ose shkonin

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

për t'i kryer punët e tyre ose ktheheshin në shtëpi për një sy gjumë të shkurtër para mesditës.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ose shkonte në shtëpi për të bërë një sy gjumë ose ecte nëpër rrugët e Medinës, ashtu që të mund t'i përgjigjej ndonjë ftese ose ta vizitonte ndokënd ose edhe të merrte pjesë në diçka.

Në rrugët e Medinës, me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Shëtitja e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kishte dhe qëllim. Nuk kishte asnjë organizim të veçantë në shëtitjen e tij, siç jemi mësuar shpesh t'i shohim për figurat e ndryshme publike. Derisa ecte, i ngriste këmbët sikur t'i zvarriste përtokë dhe vazhdonte përpara sikur të ishte duke ecur poshtë një shpati. Kushdo që e shihte, e kuptonte se ai nuk ishte as i dobët e as dembel. Kur kthehej, kthehej me gjithë trupin e tij. Shokët e tij lëviznin ose përpara ose rreth tij, por kurrë pas tij. Kurrë dy njerëz nuk shkelnin mbi këmbët e tij.

Kjo ishte një shenjë e përlësisë ndaj tij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai asnjëherë nuk ecte përpara shokëve të tij, duke i lënë ata që ta ndjekin nga pas, siç bëjnë shumë udhëheqës sot. As nuk pranonte që shokët e tij të duken të përlurur para tij. Thjesht, ecte me ta dhe midis tyre.

Kur ecte, ndodhte ta përdorte një shkop ose një degë hurme. Po ashtu, shpeshherë e mbante një shkop të vogël ose një shkop me një maje

gjysmë-rrethore. Ky ishte një zakon i arabëve, pasi mjetet e tilla shpesh ishin të nevojshme në komunitetin e tyre.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], një ditë u takua me një çupë të vogël (robëreshë) dhe ajo ia kapi dorën. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], eci me të rrugëve të Medinës, ngado që ajo dëshiroi, duke mos ia prish qejfin fare. Mandej i ndihmoi në përmbushjen e porosive dhe detyrave të saj, pa ia lëshuar fare dorën.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] buzëqeshte sa herë që e takonte ndokënd. Xherir ibn Abdullah [radijallahu anhu] ka thënë: “Sa herë që i Dërguari i Allahut takohej me mua, buzëqeshte.”

Buzëqeshja e tij ishte rrezatuese; buzëqeshje mirëpritëse, duke i dhënë personit me të cilin takohej një ndjenjë se ishte shumë i veçantë për të. Xheriri [radijallahu anhu] mendoi se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e bënte këtë posaçërisht për të dhe që i prirë ta transmetojë këtë në shenjë vlerësimi. Në fakt, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e praktikonte këtë me të gjithë njerëzit. Abdullah ibn el-Harith ibn Xhaz thotë:

“Kurrë nuk e kam parë ndokënd të buzëqeshte më shpesh se i Dërguari i Zotit, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].”

Nëse gjatë shëtijes së tij, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], takonte ndonjë fëmijë, e përshëndeste atë dhe ia fshinte fytyrën me dorë. Xhabir ibn Samure transmeton: “I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], doli një ditë që të shëtisë rrugëve të Medinës dhe unë isha me të. Disa fëmijë u afruan pranë tij dhe ai ua fshiu faqet secilit prej tyre. Gjithashtu, fshiu edhe faqen time, dhe kam vënë re se dora e tij ishte e ftohtë dhe kishte një aromë të mrekullueshme, pothuajse e kishte nxjerrë nga një shportë e parfumeve.¹⁵ Faqja ime, të cilën i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e fshiu, mbeti më e mirë se faqja tjetër.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i vizitonte ensarët në lagjet e tyre. Djemtë e ensarëve vinin te ai dhe ecnin rreth tij. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], lutej për ta, ua përkëdhelte kokat dhe i përshëndeste.

¹⁵ Tregtarët e parfumeve i mbanin parfumet e tyre në një shportë të veçantë, dhe referenca këtu është për një shportë të tillë.

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Një ditë prej ditësh, më e mira krijesë, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kaloi nga lagjet e fisit Naxhar. Çupat e ensarëve i shfaqën mirëseardhje, duke luajtur me dajre dhe duke kënduar:

Jemi çupat e El-Naxharit,

fqinj të mirë kemi të Dërguarin e Allahut.

Pas këtyre fjalëve, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua ktheu:

“Zoti e di, se zemra ime ju do juve. O Zoti im, bekoji të gjitha ato.”

Një ditë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vajti në xhami dhe pa një grup grash ulur aty. I përshëndeti me shenjë¹⁶ (ua bëri me dorë). Saherë që e takonte ndonjërin prej shokëve të tij, e përshëndeste i pari. U fliste për dore dhe lutej për ta. Kur ia jepte dikujt dorën, nuk e hiqte dorën e tij, derisa personi tjetër ta hiqte i pari. Kur e takonte një njeri dhe i fliste, nuk e kthente shikimin larg tij, derisa ai person ta kishte kthyer kokën e tij mënjane.

¹⁶ Ai ngriti dorën e tij në një mënyrë që është njohur si përshëndetje.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ndalonte për të biseduar kur dikush dëshironte që ai të ndalej. Një çupë ose një grua mund të kërkonte nga ai që të ndalej dhe ai ndalej për të folur me të. Adij ibn Hatim transmeton në detaje takimin e tij të parë me Pejgamberin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “Derisa isha duke ecur pranë tij, një grua që kishte një fëmijë me vete, e thirri dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, kemi për të të thënë diçka.” Ata folën me të privatisht. Kështu vazhduan për një kohë të gjatë, deri sa unë lëviza në drejtim të tij. Mendova me vete dhe thashë: “Jam i sigurt se ti nuk je ndjekës i fesë time ose fesë së Nu‘man ibn el-Mundhirit.¹⁷ Po të ishte mbret, asnjë fëmijë dhe asnjë grua nuk do të mund të të ndalonte për një kohë kaq të gjatë. Ndjeva ngrohjen e zemrës time për të.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte shumë spontan në ecjen e tij, duke mos ndikuar asnjë seriozitet artificial. Një ditë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kaloi pranë një të riu, i

¹⁷ Nu‘man ibn Mundhiri ishte mbreti i Hirasë, që ndodhet në Irak. Ai ishte një mbret i krishterë, i lidhur me Perandorinë Persiane, por perandori më pas e vrau. Vetë Adiji ishte një i krishterë para se ta pranonte Islamit pas këtij takimi me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

cili po e rripte një dele të therur. Megjithatë, i riu nuk e bënte punën siç duhej. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] iu afrua dhe i tha: *“Ma lërë mua, ashtu që të të mësoj se si rripet. Po e shoh se nuk po e bën rrjepjen si duhet.”*

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pastaj e vendosi dorën e tij në mes të lëkurës dhe mishit të deles, derisa ajo u mbulua nga supet. Pastaj i tha: *“Kështu duhet rrjepur lëkurën, o çun.”* Më pas, u largua.

Shohim se si i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte i etur për të krijuar ura lidhëse të komunikimit mes brezave të ndryshëm. Ai tregonte qartë interesim rreth çështjeve të tyre dhe interesohej detajisht për jetën e tyre. Ne pyesim veten se çfarë ndjeu ky çun i ri, pasi e pa vetë Pejgamberin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] duke u interesuar në punët e tij private dhe duke e ndihmuar atë për t'i përmbushur detyrat e tij.

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], një ditë ndodhej me shokët e tij në shtëpinë e njërit prej tyre. Bilali [radijallahu anhu] vajti dhe e njoftoi se koha për namaz kishte hyrë. Në çast, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u nis drejt xhamisë.

Kaloi pranë një njeriu, i cili kishte vendosur një tigan të madh në një stufë për të përgatitur diçka. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e pyeti: *“A është ushqimi gati?”*

“Po, gati është, o i Dërguari i Allahut.” - ia ktheu ai.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e mori një kafshatë të vogël ushqimi dhe filloi ta hajë derisa po ecte. Vazhdoi ta bëjë këtë, derisa ishte gati për të filluar namazin.

Shohim se jeta e tij ishte e thjeshtë dhe spontane. Kështu jetonte i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], me shokët e tij. Në këtë rast, ai mori një kafshatë të vogël dhe vazhdoi ta përtyp derisa po ecte rrugës për në xhami. Sa larg është sjellja e tij nga ajo e arrogantëve dhe mendjemëdhenjve! Sa i përket atij që ishte nikoqir i Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në këtë rast, ai ishte shumë i lumtur. Mbase u tregoi të gjithë atyre që i takoi atë ditë, se si i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mori një kafshatë nga ushqimi i tij dhe e hëngri para tij; sikur ky veprim ishte një medalje e veçantë për të. Përmes sjelljeve të tilla të shquara dhe spontane, i Dërguari i

Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duhet të ketë qenë shumë i afërt me njerëzit në jetën e tyre.

Kur e vizitonte ndonjërin, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nuk rrinte përballë derës së tij. Mënjanohet nga ana e djathtë ose e majtë, sepse shtëpitë ishin të vogla dhe nuk kishte asnjë perde prapa derës. Prandaj, kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] qëndronte pranë derës, i përshëndeste: *“Eselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu! - Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ju.”* Në rast se nuk kishte përgjigje, ai e përsëriste këtë tri herë. Në qoftë se edhe pas kësaj nuk kishte asnjë përgjigje, atëherë largohej.

Një ditë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vizitoi Sa’d ibn Ubejden dhe derisa po qëndronte para derës, përshëndeti: *“Eselamu alejkum ve rahmetullahi ue berekatuhu!”* Sa’di [radijallahu anhu] e dëgjoi përshëndetjen dhe u përgjigj qetas, por i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk e dëgjoi dot. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përsëri tha: *“Eselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu.”* Përsëri Sa’di [radijallahu anhu] u përgjigj me zë të ulët. Edhe një herë i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përsëriti përshëndetjen dhe Sa’di

[radijallahu anhu] sërish e bëri të njëjtën gjë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më pas u nis të largohej. Sa'di [radijallahu anhu] doli me të shpejtë dhe i tha: "Pasha Atë që të ka dërguar me mesazhin e së vërtetës, saherë që më përshëndete, unë ta ktheva. Doja vetëm që ti të më ofrosh më shumë paqe dhe bekime nga Allahu i Lartësuar."

Në vizitë ndaj të afërmve dhe miqve me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], gjatë orëve të mëngjesit, ndodhte t'i vizitonte të afërmit ose miqtë e tij. Për shembull, nganjëherë e vizitonte të bijen, Fatimen [radijallahu anha], ashtu që ta shihte nipin e tij Hasanin. Ebu Hurejre [radijallahu anhu] transmeton: "Një ditë mëngjesi, i Dërguari i Allahut doli nga shtëpia dhe më takoi në xhami. Ma kapi dorën dhe së bashku morëm rrugën. Ma mbante dorën dhe ashtu vazhduam rrugën, duke mos folur as edhe një fjalë të vetme; as unë e as ai. Fillimisht shkuam në treg të fisit hebrenj, Kajnuka. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u end nëpër treg për të parë se çfarë po ndodhte. Pastaj doli që aty dhe unë ngela me të. Më pas, arritëm në oborrin e Fatimes [radijallahu anha] dhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u ul.

"Ku është vogëlushi? Ku është vogëlushi? Ku është vogëlushi? Thirre Hasanin!" - thirri i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Askush nuk iu përgjigj. Fatimja [radijallahu anha] e mbajti Hasanin për pak kohë dhe ne menduam se është duke e larë ose duke ia vendosur qaforen.¹⁸ I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pastaj u largua, dhe u largova edhe unë së bashku me të, derisa arritëm në xhami, me ç'rast ai u ul dhe u mbulua. Pastaj tha: *"Ku është vogëlushi? Thirreni atë."*

Me të shpejtë doli Hasani, plot nxitim; kërcëu mbi mbulesën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe u ul në prehrin e tij. Që të dy e përqaftuan njëri-tjetrin. Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e puthi Hasanin dhe e mbajti në gjoks, ndërsa Hasani e vuri dorën e tij në mjekrën e gjyshit, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ky i fundit e hapi gojën dhe djaloshi e futi dorën e tij në gojën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Atëherë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u lut:

"O Zot, unë e dua atë, andaj dua edhe Ti, dhe dua që çdokënd i cili e do atë."

E përsëriti këtë lutje tri herë.

¹⁸Ajo qafore ishte bërë nga disa bimë aromëmira.

Ebu Hurejre [radijallahu anhu] shpeshherë e kujtonte këtë skenë. Ai thoshte: “Sa herë e shihja Hasanin, lotët m’i mbulonin faqet.”

Një ditë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vajti në shtëpinë e Fatimes [radijallahu anha] dhe pyeti se ku ndodhej bashkëshorti i saj, Aliu [radijallahu anhu]. Ajo ia ktheu: “Kishim një mosmarrëveshje dhe ai u largua.” Babai i Fatimes [radijallahu anha] e dërgoi dikë që ta kërkojë Aliun [radijallahu anhu], dhe iu tha se ai po flinte gjumë në xhami. Vajti Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në xhami dhe e gjeti Aliun [radijallahu anhu] të shtrirë në dysheme. Trupi i Aliut [radijallahu anhu] ishte pluhurosur i tëri. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia largoi pluhurin dhe i tha: “*Ngrihu o Ebu Turab*¹⁹, *ngrihu!*”

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shpesh e vizitonte Umu Ajmanin, kujdestaren e tij të fëmijërisë. Një ditë prej ditësh, Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vajti që ta vizitojë atë dhe ajo i shërbeu ushqim e pije. Ai, ose ishte agjërueshëm ose nuk dëshironte të hante, pasi e ktheu ushqimin pa ngrënë as edhe një kafshatë të vetme. Në

¹⁹ Turab, do të thotë pluhur.

çast, ajo u kthye nga ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], me qortim, duke shfaqur pakënaqësi dhe duke ngritur zërin për shkak se ai nuk e preku ushqimin fare. Umu Ajmani e bëri këtë, për shkak të pozitës së saj si kujdestare derisa ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte i ri. Pakënaqësia e saj ishte për shkak të dashurisë së madhe që ndjente për Muhamedin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pikërisht ashtu siç e ëma e qorton të birin e saj. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Muhamedin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili e toleronte këtë me buzëqeshje të butë.

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i vizitonte edhe shokët e tij. I vizitonte të ngratët dhe të sëmurët. I pranonte ftesat e tyre dhe nganjëherë shkonte tek ta i vetëm. Për shembull, ai e pranoi ftesën e Mulejhes, gjyshes së Enes ibn Malikut, për një vakt ushqimi. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], iu përgjigj ftesës dhe hëngri nga ushqimi që ajo kishte përgatitur. Pasi e përfunduan ushqimin, ai u tha: *“Tani çohuni, ashtu që të mund të falemë së bashku.”*

Enes ibn Maliku tregon: “E mora një qilim, i cili ishte vjetërsuar për shkak të përdorimit të

gjatë dhe e spërkata pak me ujë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u ngrit dhe unë qëndrova prapa tij. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], na priu në namazin dyrekatësh dhe pastaj u largua.”

Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nganjëherë, pranonte ftesë nga dikush dhe i përgjigjej asaj me disa prej familjarëve të tij. Enesi [radijallahu anhu] transmeton se i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e kishte një fqinj persian, i cili shquhej për gatim të shijshëm. Në fakt, gatimi i tij kishte një aromë të mrekullueshme. Një ditë, ai përgatiti diçka për të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe e ftoi për një vakt. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e pyeti nëse mund ta merrte edhe Aishen [radijallahu anha] me vete ose jo.

“Jo!” - ia ktheu ai.

Atëherë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i tha: “*Nuk vij as unë.*”

Persiani edhe një herë i bëri ftesë, por i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] përsëri i tha:

“*Aishja, vjen me mua, apo jo?*”

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

“Jo!” - i tha ai përsëri.

Në të njëjtën mënyrë i tha edhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Përsëri persiani e ftoi atë, dhe, edhe kësaj radhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i tha:

“Vij, nëse vjen edhe Aishja.”

Herën e tretë, persiani pranoi. Kështu, që të dy vajtën tek shtëpia e tij.

Një ditë, ai u ftua nga një rrobaqepës. Enesi [radijallahu anhu] tregon: “Vajta me të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], për një vakt ushqimi tek rrobaqepësi. Ai servoi para të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ca bukë të bërë nga elbi me kungull dhe mish të terur, dhe pastaj vajti në punë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] hëngri nga kungulli dhe i pëlqeu shumë. E shihja duke e për zgjedhur kungullin nga pjata. Kur e pashë të vepronte kështu, e mora kungullin që e kisha para vetes dhe e vendosa para tij. Nuk e hëngra në ato çaste, edhe pse më hahej më shumë se kurdoherë më parë.”

Kur ftohej, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndodhte të shkonte me disa nga sahabët e tij. Një shembull i tillë ishte vizita e tij tek Itban ibn Maliku, i cili i kërkoi atij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], që të shkojë dhe të falej në shtëpinë e tij. Ai i tha: “O i Dërguari i Allahut! Shikimi më është dobësuar shumë. Unë i prij popullit tim në namaz. Kur ka të reshura, lugina mes meje dhe tyre vërshon, dhe s’mund të mbërrij tek xhamia e tyre që t’ua fal namazin. Do dëshiroja që të vije në shtëpinë time dhe të falesh, ashtu që ta bëj vendin ku ti falesh, vendfaljen time.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i tha: *“Do të vij, me emrin e Allahut.”*

Pastaj vajti tek ai të nesërmen në mëngjes. Me vete e kishte marrë Ebu Bekrin [radijallahu anhu], Omerin [radijallahu anhu] dhe disa sahabë të tjerë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e pyeti Itbanin: *“Në cilin vend dëshiron që të falem?”*

Itbani ia tregoi vendin dhe ia solli një sexhade prej kashte, pasi i spërkati këndet e saj (sexhades) me ujë. Pastaj, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u priu në një namaz dy rekatësh. Itbani i kërkoi të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve

sel-lem] që të ndalojë dhe të hajë diçka, pasi ai kishte përgatitur ca ushqim. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] qëndroi dhe hëngri në vendin e tij.

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pëlqente shumë që t'i kënaqte mikpritësit. Sillej mirë me të gjithë. Sjelljet e tij të mira kaplonin edhe fëmijët e tyre. Enesi [radijallahu anhu] thotë:

“I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte më i sjellshmi ndër njerëzit. Ai vinte tek ne, që të na bënte shoqëri. E kisha një vëlla të moshës tre vjeçare. Quhej Umejri. Kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] na vizitoi, filloi të lozte dhe kënaqej me të. Një ditë prej ditësh, erdhi tek ne, por e gjeti atë të mërzhitur. E pyeti nënën time: *“O Umu Sulejm! Çfarë i ka ndodhur Umejrit? Duket i mërzhitur dhe i rrënuar.”* Ajo ia ktheu: *“O i Dërguari i Allahut! Nugejri²⁰ i tij, me të cilin lozte, ka ngordhur.”* Iu afrua i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] Umejrit, ia ngriti kokën dhe e pyeti: *“O Umejri! Çfarë i ka ndodhur Nugejrit? O Umejri! Çfarë i ka ndodhur Nugejrit?”*

²⁰ Nugejr, është një emër arab, i cili i referohet një zogut të vogël sikur harabeli.

Thotë Mahmud ibn el-Rabi: “Mbaj mend kur i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ma spërkati fytyrën me ujin që e mori nga një tas, të cilin e nxori nga pusi jonë. Atëherë isha vetëm pesëvjeçar.”

Pra, mund të shihet se si kjo shfaqje e kënaqshme e impresionoi Mahmudin, i cili e mbajti mend këtë për një kohë të gjatë. Vras mendjen se si, të Dërguarit të Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], përkundër të gjitha angazhimeve që kishte, i dilte kohë edhe për një fëmijë të mërzitur, që ta pyeste për zogun e tij të vogël, dhe orvatjet e tij që t’i kënaqte fëmijët. Sa të kënaqur duhet të jenë ndjerë ata, kur e shihnin të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duke iu afruar. Sa të lumtur duhet të jenë ndjerë prindërit, derisa i shihnin fëmijët e tyre të duhen nga i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Kur i Dërguari i Allahut e vizitonte ndonjërin prej shokëve të tij dhe drekonte ose darkonte në shtëpinë e tij, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], lutej për të dhe familjen e tij. Një ditë, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vizitoi Sa’d ibn Ubejden [radijallahu anhu], i cili i servoi bukë dhe

vaj. Pasi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mbaroi ushqimin, tha: *“Bëftë Zoti që agjëruesit ta prishin agjërimin tek ju; bëftë Zoti që njerëzit e devotshëm të hanë nga ushqimi juaj; dhe bëftë Zoti që Melekët të luten për ju.”*

Një ditë, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vizitoi Busri ibn Ebi Busrin. Kur iu afrua shtëpisë së tij, Busri me bashkëshorten dolën për t’i uruar mirëseardhje. Vendosën një petk kadifeje, ashtu që krijesa më e bukur të ulet mbi të. Pastaj, Busri i tha bashkëshortes: “Na e shërbej ushqimin.” E solli ajo një pjatë, në të cilën kishte miell të gatuar me gjalpë, ujë dhe kripë, dhe e vendosi para të Dërguarit të Allahut. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], mori nga ushqimi, dhe morën edhe të pranishmit e tjerë. Në fund, ngeli ca ushqim në pjatë. Atëherë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u lut për ta me fjalët: *“O Zoti im! Ua fal gjynahet dhe zbrit mëshirë mbi ta. Begatoji dhe furnizoji me furnizim të bollshëm.”*

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] një ditë e vizitoi Xhabir ibn Abdullahun në shtëpinë e tij. Xhabiri i tha bashkëshortes: “I Dërguari i Allahut do të vijë në mesditë. Mos bëj asgjë me të cilën ai s’do të ndihet i kënaqur, as mos fol me të,

e as mos e pyet për asgjë.” Pastaj e theri një dhi të majme. Pasi e shërbeu para të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ky i fundit e shikoi Xhabirin dhe i tha: *“O Xhabir! Më duket se e dini se e dua mishin.”*

Pastaj hëngrën ushqim të gjithë së bashku. Derisa i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po bëhej gati për t’u nisur, bashkëshortja e Xhabirit, e cila ishte fshehur diku në dhomë, e thirri Pejgamberin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe i tha: *“O i Dërguari i Allahut! Lutu për mua dhe bashkëshortin tim.”* I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia ktheu: *“Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty dhe bashkëshortin tuaj.”*

Më vonë, Xhabiri i tha bashkëshortes së tij: *“A të thashë të mos flasësh me të Dërguarin e Allahut?”* Ajo ia ktheu: *“A mendove se Zoti do ta sjellë të Dërguarin e Tij në shtëpinë time dhe unë të mos i kërkoj atij që të lutet për mua dhe bashkëshortin tim, para se të largohet?”*

Ata fisnikë, shokët fisnikë të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishin përfitues të lutjeve dhe bekimeve të tij. Vetë fakti se i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], jetonte në mesin e tyre, ishte një begati e madhe nga Allahu i Lartësuar.

Siç edhe pamë, vizitat e tij ishin burim i lumturisë për të gjithë ata që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i vizitonte. Këto vizita ishin nder për moshërriturit, përplot kujdes dhe vëmendje për fëmijët e tyre, dhe begati e plotë mbi ta. Në të njëjtën kohë, vizitat e tij ishin përplot me edukim dhe udhëzim, që synonin konsolidimin e vlerave të drejta dhe të mirëfillta në zemrat e tyre, në mënyrë të rafinuar, të lartë dhe unike të edukimit pejgamberik.

Abdullah bin Amir ibn Rabi'a transmeton: "Na vizitoi i Dërguari i Allahut, derisa unë ende isha një kalama. Dëshirova që të dilja për të lozur dhe në çast nëna më tha: "O Abdullah, eja, dua të të jap diçka." I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e pyeti: "*Çfarë do t'i japësh?*" "Ca hurma!" - tha ajo. "*Po të mos i jepje asgjë, do të të regjistrohej një gënjeshtër.*" - ia ktheu i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Këtu shohim se si i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e udhëzon nënën e Abdullahut, me qëllim që ta mbjellë vendosmërisht vlerën e të folurit vetëm të vërtetën në mendjen e fëmijës. Fëmija e mësoi këtë vlerë tërësisht dhe ia transmetoi komunitetit musliman në

vitet e mëvonshme. Prandaj, lexues i dashur, edhe unë e mësova këtë.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], një herë e vizitoi Sa'd ibn Ubejden [radi-jallahu anhu]. Pasi u ul me të, derisa ishte i përcjellë edhe nga të tjerët, Beshir ibn Sa'di [radi-jallahu anhu] tha: "O i Dërguar i Allahut! Allahu na ka urdhëruar të të përshëndesim (të dërgojmë salavate) ty. Si ta bëjmë këtë?"²¹ I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] heshti për pak dhe të pranishmit uronin që kjo pyetje të mos bëhej fare. Pastaj, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], iu adresua të pranishmëve: *"Thoni: "Allahumme sal-li ala Muhamedin ve ala ali Muhamed, kema sal-lejte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim, ineke Hamidun Mexhid. Allahumme barik ala Muhamedin ve ala ali Muhamed, kema barekte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim, ineke Hamidun Mexhid - O Zot, lartësoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç e pate lartësuar Ibrahimin dhe familjen e tij, se vërtet Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar. O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e tij, siç*

²¹ Pyetja e Beshirit i referohet ajetit kur'anor: *"Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam."* (El-Ahzab: 56)

e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij, se vërtet Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar."

Ne çuditemi pse i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ngeli i heshtur për pak çaste. Mendjet e njerëzve bridhnin sa gjerë e sa gjatë. Ata ishin të etur që të dëgjonin përgjigjen e tij. Pastaj, kur ai e dha përgjigjen, ata nuk donin ta harronin dot më. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi mësuesin më të mirë të mirësisë.

Kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vizitoi Itban ibn Malikun, një numër i madh njerëzish u mbledhën në shtëpinë e tij. Njëri ndër ta tha: "Çfarë i ka ndodhur Malik ibn el-Dukshumit? Ka kohë që se kam parë." Një tjetër tha: "Ai është munafik. Nuk e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij."

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] brofi dhe tha: "Mos thuaj ashtu. A nuk e ke dëgjuar duke thënë: "Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut", duke e kërkuar vetëm kënaqësinë e Allahut?"

"Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri!" - tha njeriu. - "Sa na përket neve, ne e shohim atë duke u shoqëruar dhe duke folur me munafikët."

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia ktheu: *“Allahu ia ka ndaluar zjarrin e Xhehenemit atij që thotë: “Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut.”*

Neve duhet të reflektojmë mbi atë se si i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e përdori këtë vizitë për t’i mësuar shokët e tij dhe të gjithë muslimanët, se duhet ta mbrojnë nderin e vëllezërve të tyre muslimanë. Nuk duhet të flasin fjalë të këqija në mungesë të tyre. Mësimi i tij, gjithashtu tregon se duhet gjithmonë t’i shikojmë aspektet pozitive tek njerëzit. Më e rëndësishmja ndër to është Njeshmëria e Allahut. Kjo shihet qartë në tërheqjen e vëmendjes nga i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ndaj të pranishmëve, për faktin se njeriu në fjalë kishte deklaruar besimin e tij se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut.

Vras mendjen se sa të pastra do të ishin tubimet dhe bisedat tona, në rast se abstenojmë nga të folurit keq për këdo që deklaroi se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut.

Në vizitë ndaj të sëmurëve me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i vizitonte edhe të sëmurët. Me të vërtetë, prania e tij në kohë të dhimbjes dhe vuajtjes u jepte shërim²² dhe i qetësonte pacientët.

Një shembull i tillë ishte vizita e tij ndaj Sa'd ibn Ubejdes, kur ky i fundit ishte kapluar nga një sëmundje. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vizitoi atë i shoqëruar nga Abdurr-Rahman ibn Aufi, Sa'd ibn Ebi Vekasi dhe Abdullah ibn Mes'udi [radijallahu anhum]. Kur hyri në dhomë, pa se Sa'di kishte humbur vetëdijen. E gjithë familja e tij i ishin afruar përreth.

"Vallë ka ndërruar jetë?" - pyeti i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

"Jo, o i Dërguari i Allahut!" - u përgjigjën ata.

²² I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shpesh këshillonte se çfarë duhet të përdorë pacienti për t'iu lehtësuar dhimbjet.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më pas filloi të lotojë. Kur të pranishmit panë se ai po qante, filluan edhe ata të qajnë.

“Allahu nuk e dënon askënd për sy të përлотur ose zemër të pikëlluar. Ai dënon për atë çfarë kjo (iu drejtua gjuhës) mund të bëjë, ose Ai mund të zbresë mirësinë e Tij.” - tha ai [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Ky është vetëm një shembull i dhembshurisë së Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: sytë iu mbushën me lot, thjesht për shkak se njëri nga shokët e tij kishte humbur vetëdijen. Vras mendjen se çfarë ishin ndjenjat e Sa’d ibn Ubejdes [radijallahu anhu] pasi iu kthye vetëdija dhe u shërua, e pastaj mësoi se i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kishte qarë kur e kishte parë në atë gjendje. Si u ndjenë bijtë, familjarët dhe të afërmit e Sa’dit, kur panë se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po e ndante brengën dhe pikëllimin me ta? Ai i përjetoi të njëjtat ndjenja të dhimbjes dhe pikëllimit si familjarët e tij.

E tillë ishte dashuria dhe dhembshuria e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. S’ka dyshim, Allahu i Lartësuar, i Cili e njeh atë më së

miri, e përshkroi me fjalët: *“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tua, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”* (Et-Teube: 128)

Shembull tjetër është vizita e tij ndaj Xhabir ibn Abdullahut [radijallahu anhu]. Xhabiri transmeton:

“Më kaploi sëmundja. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i shoqëruar nga Ebu Bekri [radijallahu anhu] erdhi të më vizitojë. Erdhën derisa po mjekohesha te fisi im, fisi Selem. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më pa se kisha humbur vetëdijen. Nuk dija asgjë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mori abdes dhe më pas më spërkati me ujë të abdesit. Shumë shpejt mu kthye vetëdija dhe e pashë atë pranë meje. E pyeta: “O i Dërguari i Zotit, çfarë të bëj me pasurinë time, pasi nuk kam trashëgimtarë, as prindër as fëmijë?” Ai nuk mu përgjigj, derisa u shpall ajeti kur’anor që shpjegon trashëgiminë në raste të tilla.”

Ajo çfarë duhet të dimë, është se Xhabiri, pacienti që e pyeti të Dërguarin [sal-lallahu alejhi

ve sel-lem] se si duhet ta ndajë pasurinë e tij nëse vdes në këtë sëmundje, jetoi 70 vjet pas vdekjes së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Kjo skenë ngeli e pranishme me të.

Duhet të reflektojmë paksa në fjalët e Xhabirrit: “Shumë shpejt mu kthye vetëdija dhe e pashë të Dërguarin e Allahut pranë meje.” Derisa e transmeton ngjarjen, ai tingëllon sikur të ishte duke e parë atë tani.

Asgjë nuk është më e pëlqyer nga njerëzit, se sa t’u gjendesh pranë kur goditen nga ndonjë dhimbje ose kur ndjehen të dobët. I tillë ishte i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], me shokët e tij. Sa herë që sahabët goditeshin nga ndonjë dhimbje, ai gjendej pranë tyre për t’i qetësuar dhe ngushëlluar. Por, nuk mungonte as në çastet e lumtura. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u gjendej pranë për t’i kënaqur ata. E këtillë ishte dashuria e pakrahasueshme e tij.

Në kopshtet e Medinës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Shpesh herë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shkonte në kopshte të caktuara të Medinës për të pushuar dhe kënaqur nën hijen e tyre. Atje ndodhte t'i takonte shokët e tij më të ngushtë. Për shembull, shkonte te një kopsht i quajtur *Bejruha*, i cili i takonte Ebu Talha el-Ensariut. Shkonte atje, ulej nën hije dhe pinte nga uji i freskët i tij. Ky kopsht ndodhej përballë xhamisë nga ana veriore. Tash nuk ekziston ky kopsht, pasi ishte pjesë e zgjerimit të xhamisë së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Nganjëherë shkonte tek kopshtet që u përkisnin ensarëve. Ebu Hurejre [radijallahu anhu] e transmeton një rast të tillë:

“Ishim ulur përreth të Dërguarit të Allahut dhe me ne ndodheshin Ebu Bekri, Omeri dhe të tjerët. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më pas u largua. Nuk u kthye për një kohë të gjatë, dhe druajtëm se diçka e pakëndshme mund t'i ketë ndodhur. Me të vërtetë u brengosëm shumë, andaj edhe u ngritëm që ta kërkonim. Unë isha i

pari që u brengosa. Si rrjedhojë, dola në kërkim të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Arrita tek një kopsht që i përkiste një ensariu. U solla përreth kopshtit në kërkim të portës së tij, por s'kishte asnjë portë. Ishte një përroskë e vogël që shkonte në kopsht nga një pus jashtë tij. Vendosa të futem përmes saj sikur një dhelbër. Hyra brenda dhe e gjeta të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], aty brenda. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më tha: *"O Ebu Hurejre!" "Urdhëro, o i Dërguari i Allahut!" - ia ktheva. M'i dha këpucët e veta dhe më tha: "Merri këpucët e mia dhe dil nga kopshti. Këdo që e takon jashtë këtij kopshti dhe i cili dëshmon se: 'S'ka të adhuruar me meritë përveç Allahut', duke besuar vendosmërisht në këtë, jepi sihariq se do të hyjë në Xhenet."*

Kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shkonte në Kuba, shkonte edhe në Aris gjithashtu, vend ky që ndodhet në perëndim të xhamisë Kuba. Është pusi në të cilin ra unaza e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] gjatë sundimit të halifes së tretë, Othmanit [radijallahu anhu], dhe nuk mundi të gjendej më. Brezat muslimanë dhe shtetet muslimane e ruajtën pusin për shumë shekuj, por ai (pusi) ishte varrosur në kohërat tona

moderne. Ebu Musa El-Esha'riu [radijallahu anhu] transmeton:

“I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vajti tek vendi i pusit Aris. Unë u ula tek porta e cila ishte bërë nga degët e hurmave të thata, derisa ai e kreu nevojën fiziologjike dhe mori abdes. Vajta te ai dhe e gjeta ulur tek pusi Aris, mbi murin e vogël të tij, ndërsa këmbët i kishte të vendosura brenda pusit. Në dorë mban-te një shkop, me të cilin e përziehte ujin me baltë. E përshëndeta dhe u ula te porta. Mendova se do të jem roje e të Dërguarit të Allahut atë ditë, edhe pse ai nuk më urdhëroi ta bëja këtë. Ebu Bekri [radijallahu anhu] u afrua dhe kërkoi leje për të hyrë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më tha: *“Lejoje dhe jepi myzhde se do të jetë nga banorët e Xhenetit.”*

Ai e falënderoi dhe lavdëroi Allahun e Lartësuar para se të hynte. Pastaj, u ul në të djathtën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Më pas erdhi Omeri [radijallahu anhu], dhe edhe ky kërkoi leje për të hyrë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më tha: *“Lejoje dhe jepi myzhde se do të jetë nga banorët e Xhenetit.”*

Ai e falënderoi dhe lartësoi Allahun e Lartësuar para se të hynte dhe u ul në të majtën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Othmani [radijallahu anhu] ishte sahabiu tjetër që kërkoi leje për të hyrë.

“Lejoje dhe jepi myzhde se do të jetë nga banorët e Xhenetit, pasi të kalojë përmes disa vështirësive.” - më tha i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Vajta tek ai dhe i thashë: “Eja brenda! I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], të jep myzhde se do të jesh nga banorët e Xhenetit, por do të ballafaqohesh me disa vështirësi.” Ai ma ktheu: “Lutem për ndihmën e Allahut. O Zoti im, më ruaj në vështirësi.” Hyri brenda, por pa se muri i vogël ishte zënë i tëri, prandaj u ul përballë tyre.”

Vizita e kopshteve të Medinës nga i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte për qëllim të pushimit, ku kërkonte të qëndrojë nën hije të kopshtit gjatë ditëve të nxehta që mbretëronin në Medinë. Vizitat e tilla i jepnin freski dhe ia përtërinin forcën dhe fuqinë që të merrej me detyrat ditore. Veç tjerash, ato (vizita) u sillnin shumë gëzim

dhe lumturi pronarëve, të cilët ndiheshin të privilegjuar ta pranonin të Dërguarin e Allahut në kopshtet e tyre. Ata ishin të vetëdijshëm se prania e tij sillte begati në kopshtet e tyre, pasi ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte i bekuar kudo që ndodhej.

Në kotjen ditore me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Vonë në mëngjes, kur afrohej mesdita, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shkonte te dhoma e bashkëshortes tek e cila e kishte radhën të shkonte atë ditë. Gjëja e parë që bënte kur hynte brenda, ishte pastrimi i dhëmbëve dhe përshëndetja me selam. Pastaj e falte namazin vullnetar të *duhasë* (paraditës) në katër rekate, ose nganjëherë edhe gjashtë deri në tetë rekate.

Nëse gjente ushqim në shtëpi, hante, në rast se nuk kishte ngrënë atë ditë. Kishte raste kur i ofrohej ushqim dhe ai qëllonte duke agjëruar, por e prishte agjërimin. Aishja [radijallahu anha] transmeton se një ditë i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Na është dhuruar diçka nga ushqimi dhe ta ruajta ca.”

“Çfarë ashtu?” - pyeti ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

“El-Hajs!” - tha ajo [një ushqim i bërë nga hurmat, gjalpi dhe qumështi i ngrohtë].

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

“Epo, na e shërbej atëherë!” - i tha i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Ajo e shërbeu dhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] hëngri.

Pasi e mbaroi, tha: *“E kisha filluar ditën me agjërim.”*

Ishte pikërisht në një rast të këtillë, kur Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e pa bashkëshorten e tij, Xhuvejrijen [radijallahu anha], duke ndenjur ulur në vendin ku ishte falur dhe po e madhëronte Allahun. Hyri ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në dhomën e saj herët në mëngjes, para sesionit të tij të zakonshëm me sahabët, dhe e gjeti Xhuvejrijen [radijallahu anha] në pozitën e njëjtë.

E pyeti për herën e dytë: *“A ke qëndruar në të njëjtën gjendje prej se u largova unë?”*

“Po!” - i tha ajo.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia ktheu: *“Që kur u largova prej teje, i thashë katër fraza nga tri herë, dhe sikur këto të peshoheshin karshi madhërimit tënd sot, do të ishin më të rënda në peshojë*

dhe në vlerë. Këto fraza janë: “I pafund është Zoti në madhërinë e Tij dhe i tërë lavdërimi është mbi Të, aq sa është numri i krijesave të Tij dhe siç do ta kënaqte Atë, dhe ekuivalente me Fronin e Tij, dhe ngjyrën për t’i shkruar fjalët e Tij.”

Kjo ishte koha kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte i vetëm me familjen e tij në shtëpi. Përsëri ndodhte që disa gra të vijnë dhe ta kërkojnë në këshillën e tij për disa çështje fetare, për të cilat ndiheshin të turpëruara ta pyesnin para burrave. Ato ia parashtronin këto pyetje kur bashkëshortet e tij ishin të pranishme. Kështu i mësuan rregullat mbi çështjet e intimitetit femëror.

Një rast i tillë ishte kur një grua ensare erdhi ta takojë derisa i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte në shtëpinë e Aishes [radijallahu anha].

Ajo e pyeti se si duhej të pastrohej gruaja pas ciklit menstrual.

I Dërguari i Allahut iu përgjigj: “Ajo duhet ta sjellë ujin dhe materialin pastrues. Pastaj, të merr abdes me kujdes. Më pas, ta hedh ca ujë mbi kokë dhe ta fërkojë kokën mirë, ashtu që uji të arrijë deri në lëkurë. Pastaj të derdh ujë mbi tërë trupin e saj. Më pas, të

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

merr një pjesë myshku të pambukut dhe të pastrohet me të."

Gruaja në fjalë e pyeti: "E si vallë të pastrohet me të?"

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], tha: "E pafund është Lavdia e Zotit. Ju pastroheni me të."

U ndje i turpëruar dhe u largua.

Thotë Aishja [radijallahu anha]: "Kur e pashë të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] se po ndjehej i turpëruar, e tërhoqa gruan nga unë dhe i thashë: "Duhet ta fërkosh me të hapësirën ku është shkarkuar gjaku." Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më dëgjoi dhe s'më kundërshtoi dot."

Një ditë, Umu Sulejme vajti te Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] derisa ky i fundit ndodhej me bashkëshorten e tij, Umu Selemen. Ajo e pyeti:

"O i Dërguari i Allahut! Në rast se një grua sheh në ëndërr veten duke kryer marrëdhënie intime me bashkëshortin e saj, a duhet të bëjë dush?"

Umu Seleme [radijallahu anha] i tha: “Turp të kesh, o Umu Sulejme! Si flet kështu para të Dërguarit të Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].”

Umu Sulejme ia ktheu: “Allahu nuk turpërohet nga thënia e së vërtetës. Më mirë është ta pyesim të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] rreth çështjeve problematike, sesa të ngelim injorante.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përkrahu Umu Sulejmen dhe i tha bashkëshortes së tij, Umu Selemes [radijallahu anha]:

“Ty është dashur të të thuhet turp të kesh. Më e mira ndër ju, është ajo e cila pyet rreth asaj që e shqetëson. Po, Umu Sulejme, ajo duhet të bëjë dush në rast se ejakulon.”

Umu Seleme pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Vallë ejakulojnë gratë?”

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], iu përgjigj: *“E çfarë tjetër i bën fëmijët e saj të ngjashëm me të? Gratë janë motrat e plota të burrave.”*

Gratë ensare ishin sypatrembura dhe të paturpshme në parashtrimin e pyetjeve në kërkim të

qartësimeve. Aishja [radijallahu anha] thoshte për to: “Sa gra të mira janë gratë ensare: turpi nuk i ndalon nga kërkimi i ditorisë fetare.”²³

Nganjëherë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vizitohej prej shokëve të tij më të afërt. Një ditë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u shtri në shtëpi dhe veshur kishte një petk që i përkiste Aishes [radijallahu anha].²⁴ Kofshët e poshtme të këmbëve i ishin ekspozuar. Ebu Bekri [radijallahu anhu] erdhi dhe kërkoi leje për të hyrë. Ai u pranua, por i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk lëvizi dot nga vendi. Pastaj kërkoi leje për të hyrë edhe Omeri [radijallahu anhu] dhe iu dha leja, por edhe kësaj radhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk lëvizi dot nga vendi i tij. Pastaj, Othmani [radijallahu anhu] kërkoi leje për të hyrë. Tani, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u ul dhe u sigurua se rrobat i kishte të veshura në mënyrë të duhur, para se t’i jepte leje atij. Hyri Othmani [radijallahu

²³ Kjo është pjesa e fundit e hadithit, ku e përmend gruan ensare e cila e pyeti të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] se si të pastrohet pas ciklit menstrual.

²⁴ Lloji i petkut të përmendur këtu, vishej si nga burrat, po ashtu edhe nga gratë. Ai mund të përdorej nga burrat si petk i epërm ose i poshtëm.

anhu], tha çfarë kishte për të thënë dhe më pas u largua. Aishja [radijallahu anha] i tha: “O i Dërguari i Allahut! Hyri Ebu Bekri [radijallahu anhu] dhe nuk lëvize dot (nuk bëre asgjë)²⁵. Pastaj hyri Omeri [radijallahu anhu] dhe vepruat njëjtë. Kur hyri Othmani [radijallahu anhu], u ulët dhe u siguruat se ishit veshur në mënyrë të duhur.” I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tha: “*Ndjehem i turpëruar para një njeriu, para të cilit turpërohen edhe Melekët. Othmani [radijallahu anhu] është njeri i turpshëm dhe druaja se po ta pranoja derisa isha në atë pozitë, turpi i tij do ta ndalonte nga thënia e asaj që kishte për të ma thënë.*”

Aishja [radijallahu anha] e përshkroi statusin e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] brenda shtëpisë (kur ndodhej vetëm me bashkëshorten e tij), me fjalët: “Kur ndodhej në shtëpi, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte më bujari dhe më i miri ndër njerëzit; ishte thjesht një njeri sikurse ju, përveçse gjithnjë kishte një fytyrë të buzëqeshur. Nuk dallohej nga ndonjë qenie njerëzore dhe gjithmonë ishte pranë nevojave të familjarëve të tij. I qepte këpucët dhe rrobat, i milte

²⁵ Ajo çfarë ajo nënkuptoi, ishte se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk u bezdis që të ndryshojë se si dukej.

delet dhe shërbehej vetë. I bënte në shtëpi ato të cilat çdo burrë i bën.”

Këtu shohim një skenë të bashkimit shpirtëror në jetën e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Shtëpia e tij përbëhej nga një dhomë e vogël për secilën nga gratë e tij. Pak kishin nevojë ato për ndihmën e tij, “që t’i përmbush nevojat e familjes së tij.”

Me të vërtetë, ky përshkrim e reflekton kulmin moral që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e kishte arritur, duke ndarë me familjarët e tij çfarëdo që bënin; kjo, që ata të ndiheshin se shtëpia u përkiste të gjithëve dhe se e ndanin jetën së bashku. Qëndrimi i tij në shtëpi përçon shumë mesazhe, të cilat janë të përqendruara në kujdesin që bashkëshorti duhet të ketë për bashkëshorten e tij dhe rëndësinë që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia kushtonte jetës familjare. Të gjitha bekimet i takojnë atij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili ishte më i miri për njerëzimin dhe më i miri për familjen e tij.

Ashtu siç kishte hapësirë të mjaftueshme dhe të bollshme për dashuri dhe dhembshuri në shtëpinë e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-

lem], në të njëjtën masë kishte edhe shumë mundësi për argëtim, kënaqje dhe sjellje spontane e të paplanifikuar. Një ditë prej ditësh, Sevda [radijallahu anha] e vizitoi Aishen [radijallahu anha] në dhomën e saj, dhe i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u ul në mes të dy bashkëshorteve të tij. Njërën këmbë e vendosi mbi prehërin e Aishes, ndërsa tjetrën mbi atë të Sevdës. Aishja [radijallahu anha] kishte gatuar *harira* - një gjellë e përbërë nga supa dhe mielli. Ajo e ftoi Sevdën [radijallahu anha] që të hajë, por Sevda ia ktheu: “Nuk më pëlqen.”

Aishja [radijallahu anha] i tha: “Do të hash ose do të ta hedh në fytyrë.”

Sevda [radijallahu anha] refuzoi, dhe Aishja [radijallahu anha] mori nga gjella me dorën e saj dhe ia lerosi fytyrën Sevdës. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] qeshi dhe e ngriti këmbën nga prehri i Sevdës [radijallahu anha], ashtu që kjo e fundit të hakmerrej. E mori ca ushqim nga ena dhe ia dha Sevdës [radijallahu anha]: “*Lerosja fytyrën!*” - i tha. E mori ajo atë dhe ia lerosi fytyrën Aishes [radijallahu anha]. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vazhdoi të qeshë nga argëtimi

që ndodhi në shtëpinë e tij. Derisa po qeshnin me gaz në dhomën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u dëgjua Omeri [radijallahu anhu], i cili ndodhej në xhami, duke e thirrë të birin e tij: “O Abdullah, o Abdullah!” I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u tha bashkëshorteve: “*Shkoni dhe pastroni fytyrat*”, pasi mendoi se Omeri [radijallahu anhu] dëshiron të hyjë brenda.

Iu afrua derës së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] Omeri [radijallahu anhu] e tha: “Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ty, o i Dërguari i Allahut. A mund të hyj?”

“*Hyr!*” - ia ktheu i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Një lojë dhe atmosferë e tillë relaksuese ishte karakteristikë e lirisë, çiltërsisë dhe sinqeritetit që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i dha jetës islame. Besimi ynë lejon lojëra të tilla.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kotej deri para kohës së drekës. Kotej në shtëpinë ku jetonin bashkëshortet e tij. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], asnjëherë nuk vajti në shtëpinë e ndonjë gruaje tjetër përveç

bashkëshorteve të tij, përpos në të Umu Sulejmes. Ajo ishte një nga të afërmet e tij, me të cilën e kishte të ndaluar martesën.²⁶ Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u pyet për këtë, dhe tha: *“Ndjej dhimbje për të, pasi vëllai i saj u vra duke luftuar me mua.”*

Hynte në shtëpinë e Umu Sulejmes dhe flinte në kanapën e saj, kur ajo nuk ndodhej në shtëpi. Një ditë, iu tha se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po flinte në kanapën e saj dhe ajo vajti në shtëpi. Ishte verë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte djersitur tejte shumë, deri në atë masë sa që djersët i ishin grumbulluar në një pjesë gëzofi që ndodhej në kanape. Umu Sulejme mori diçka për t'i mbledhur ato djersë dhe që pastaj t'i ndrydhë ato në një shishe. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u zgjua derisa ajo po e bënte këtë. E pyeti se çfarë po bënte. Ajo ia ktheu: “Po i fus në shishe

²⁶ Dijetarët pajtohen se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vajti në shtëpinë e Umu Sulejmes, sepse kishin lidhje gjaku dhe e kishin të ndaluar martesën. Dijetarët dallonin megjithatë, në shkakun nëse kjo ndalesë ishte për arsye të lidhjeve të gjakut mes vete, ose për shkak të lidhjeve qumështore, ose nëse ky ishte një rast i veçantë për të Dërguarin e Allahut. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kurrë nuk hyri në shtëpinë e ndonjë gruaje tjetër, pos të bashkëshorteve të tij, Umu Sulejmes dhe motrës së saj, Umu Haramit. El-Neveviu, Sharh Sahih Muslim dhe Ibn Haxheri, Fet’h ul-Bari.

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

djersët e tua. Shpresoj t'ua jap ato (djersë) fëmijëve të mi për begati." Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i tha se po vepronte drejt dhe u lut për të.

Në Kuba me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Çdo të shtunë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shkonte herët në Kuba, hipur mbi deve ose në këmbë. Atje falte namaz. Banorët e Kubasë, të cilët i përkisnin fisit të Auf ibn el-Harithit, shpesh e vizitonin atë në xhami. E përshëndetnin madje edhe derisa ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], falej, ndërsa i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua kthente selamin me shenjë.

Kur shkonte në Kuba, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kotej në shtëpinë e Umu Haram bin Milhanit, motrës së Umu Sulejmes dhe bashkëshortes së Ubejde ibn el-Samit. Ajo ishte njëra nga të afërmet e tij, me të cilën e kishte të ndaluar martesën. Një ditë, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vizitoi atë. Ajo i shërbeu ushqim dhe ia krehu flokët. Derisa po e bënte këtë, të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e kaploi gjumi. Më pas, u zgjua i buzëqeshur. E pyeti ajo plot habi:

“Ç’të shtyri të qeshësh, o i Dërguari i Allahut?”

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ia ktheu:
*“Mu shfaqën disa njerëz nga Umeti im, të cilët po
luftonin në rrugën e Allahut duke lundruar në det, si
mbretër mbi frone.”*

“Të lutem, lute Allahun që unë të jem në
mesin e tyre.” - iu lut ajo.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u lut
dhe e kaploi gjumi për të dytën herë. Përsëri u
zgjua duke buzëqeshur. Ajo edhe një herë e pyeti
se çfarë e shtyri të buzëqeshte, ndaj të cilës ai u
përgjigj:

*“Mu shfaqën disa njerëz nga Umeti im duke
luftuar në rrugën e Allahut.”*

Edhe një herë ajo i kërkoi Pejgamberit [sal-
lallahu alejhi ve sel-lem] që ta lusë Allahun që ajo
të jetë në mesin e tyre.

“Ti je me grupin e parë.” - ia ktheu i Dërguari
[sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Umu Harami, në fakt, udhëtoi në det me
flotën muslimane gjatë sundimit të Mu'avije ibn
Ebi Sufjanit. Pasi zbarkuan në Qipro, ajo u rrëzua
nga deveja dhe si rrjedhojë ra dëshmore.

Çfarë lajmi të mirë për ngjarjet e së ardhmes po jepte i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në një vendbanim të vogël, thellë në mes të Arabisë, në një kohë kur Umeti musliman ishte në skamje dhe mungesë të burimeve. Përsëri, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], po i tregonte sahabes së tij se Umeti i tij do të lundrojë në Gadishullin Iberik në një gjendje të fuqisë dhe krenarisë: “Si mbretër mbi frone”, edhe pse deti ishte larg nga Medina.

Në atë kohë, lundrimi mbi det ishte diçka krejtësisht e panjohur për arabët, saqë as që mund të paramendohej, e lëre më të luftojnë beteja në të. Cila ishte më e shquar: lajmi që u dha nga i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili ishte përtej të gjitha mundësive, pritshmërive dhe kushteve rrethuese, apo besimi që Umu Harami e shfaqti kur e dëgjoi lajmin? Ajo nuk e pyeti të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] për këtë. Nuk pyeti as se si mund të ndodhë kjo, kur gjendja e muslimanëve ishte aq e pashpresë. As nuk pyeti për kohën se kur kjo do të ndodhë. Thjesht, i kërkoi që të lutej për të, që ajo të jetë në mesin e këtij grupi, pasi ajo e besonte se kjo do të ndodhë.

Në mesditë me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Kur Bilali [radijallahu anhu] e thirrte ezanin për namazin e drekës, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] zgjohej nëse ende ishte duke fjetur. I përgjigjej thirrjes së ezanit, duke i përsëritur frazat e njëjta. Më pas, merrte abdes, nëse nuk kishte, dhe mandej i falte katër rekate në shtëpi. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], thoshte: *“Kjo është një orë në të cilën portat e qiellit hapen dhe dua që ndonjë vepër e mirë e imja të dhurohet.”*

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], priste në shtëpi derisa vinte koha për faljen e namazit farz me xhemat. Nëse në shtëpi gjendeshin nipat e tij Hasani dhe Husejni, djemtë e të bijës së tij, Fatimes [radijallahu anha], ose Uameja, e bija e bijës së tij, Zejnebes [radijallahu anha], ai luante me ta. Kur Bilali [radijallahu anhu] e njoftonte se ishte koha për namazin farz, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dilte nga shtëpia. Kur dilte, Bilali [radijallahu anhu] e thirrte ikametin. Me ta parë atë duke ardhur, sahabët ngriheshin për t’u falur.

Shpeshherë befasoheshin kur e shihnin atë, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duke ardhur, e në krahë mbante nipat e tij Hasanin ose Husejnin apo mbesën e tij Umamen. Ndodhte ta vendoste atë pranë tij derisa e udhëhiqte namazin. Në një rast, Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] doli për të falur namazin, duke e mbajtur në krahë Hasanin. Pastaj, e lëshoi në tokë atë dhe e filloi namazin. Gjatë faljes së namazit, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], qëndroi gjatë në sexhde. Njëri nga sahabët e tij, Sheded ibn el-Hadi, e ngriti kokën paksa dhe pa Hasanin e vogël të hipur mbi shpinën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] derisa ky i fundit ndodhej në sexhde. Kur përfundoi namazi, të pranishmit iu drejtuan të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]:

“O i Dërguari i Allahut, qëndrove aq gjatë në sexhde, saqë menduam se të ndodhi diçka ose po pranoje Shpallje.”

“Jo, as njëra e as tjetra, por biri im (duke aluduar në nipin) më hipi mbi shpinë dhe nuk dëshirova ta nxitoj, derisa ai vetë të zbriste.” - ua ktheu Mustafaja [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Ndodhte që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ta bartte atë mbi supe derisa falej. Kur përkulej, e lëshonte në tokë, ndërsa kur ngrihej, e kapte përsëri. Këtë e bëri duke e bartur mbesën e tij, Uname bint Zejnebin.

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e falte namazin e drekës menjëherë pasi hynte koha e tij. Këndonte rreth 30 ajete kur'anore në secilën nga dy rekatet e para, duke e bërë rekatën e parë më të gjatë se të dytën. Ndodhte ta zgjaste namazin aq gjatë, sa që kur thirrej ikameti, njeriu mund të shkonte në *el-Beki* për ta kryer nevojën, pastaj të shkonte në shtëpi të merrte abdes dhe të kthehej në xhami, t'i bashkëngjitej namazit derisa i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ende ishte në rekatën e parë. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], këndonte në heshtje, por të pranishmit e dinin se ai po këndonte Kur'an, pasi e shihnin mjekrën e tij duke lëvizur. Nganjëherë e dëgjonin të këndonte një ose disa ajete me zë.

Kur e përfundonte namazin, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kthehej me fytyrë nga shokët e tij..Nëse kishte ndonjë ngjarje ose diçka të pazakonshme, iu adresojë atyre pas namazit të drekës, pasi kjo ishte koha kur shumica e njerëzve

ishin të pranishëm në xhami. Aty çlodheshin dhe e çmonin lartë atë që thuhej. Diçka e tillë ndodhi kur një delegacion nga Mudari u vajti në vizitë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vuri re se ata po vuanin nga skamja dhe uria. U shqetësua dhe u mërzit shumë kur i pa në këtë gjendje. U ngjit në minber dhe iu adresua Umetit pas namazit të drekës. Filloi ta lartësojë dhe lavdërojë Allahun e Madhërishëm dhe më pas shtoi: *“Zoti ka shpallë në Librin e Tij, Kur’anin: “O ju njerëz! Kinie frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kinie frikë Allahun që me emrin e Tij përbe-toheni, ruajeni farefisën (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.”* (En-Nisa: 1) Pastaj shtoi: *“O ju që besuat, kini parasysh frikën ndaj Allahut dhe le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër, dhe kini frikë Allahun, e s'ka dyshim se Allahu është që e di në detaje atë që punoni!”* (El-Hashr: 18) Njeriu mund të dhurojë diç në të holla, qoftë ajo pak ose shumë, ose mund të dhurojë diçka nga veshmbathja e tij, një pjesë hurmash ose miell.” Vazhdoi kështu, derisa tha se mund ta jepnin madje edhe gjysmë hurme, duke i inkurajuar që të jenë dorëdhënës.

Një shembull tjetër, ishte adresimi i tij kur Ibn el-Lutbije u kthye, pasi e kishte përmbushur një mision me të cilin e kishte ngarkuar i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai tha: “O i Dërguari i Allahut, këto të përkasin ty, ndërsa këto mu dhanë mua si dhuratë.”

Pas namazit të drekës, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] iu adresua të pranishmeve. Filloi duke e deklaruar Njëshmërinë e Allahut, pastaj e lavdëroi dhe lartësoi Atë, dhe më pas vazhdoi:

“Ndodh ta ngarkoj dikë me detyrë. Ai shkon e përmbush atë dhe kthehet e thotë: “Kjo të përket ty, ndërsa kjo më është dhuruar mua.” Le të ulet ai në shtëpi tek familjarët e tij dhe të presë derisa të pranojë dhuratën e tij. Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, kushdo që merr diçka për të cilën nuk ka të drejtë, do të vijë në Ditën e Gjykimit duke e bartur atë. Do të ketë nga ata që bartin deve zhurmajike, ose lopë duke pallur, ose dele duke blegëruar.” Më pas i ngriti duart kah qielli, saqë edhe bardhësia e sqetullave i shihej, dhe tha: “O Zoti im, e përcolla mesazhin Tënd”, duke e përsëritur këtë tri herë.

Një ditë, pas namazit të drekës, Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u ngjit në minber dhe e përmendi Ditën e Gjykimit. Ndër të tjera, deklaroi se ajo paraprihet nga përjetimet e varrit. Më pas tha: *“Kushdo që dëshiron të më pyesë për ndonjë gjë, le të urdhërojë. Pasha Allahun, çfarëdo që të më pyesni, do t’u përgjigjem përderisa qëndroj në këtë pozitë.”* Shumica e njerëzve ia plasën vajit. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e përsëriti disa herë kërkesën që t’i parashtrojnë pyetje. Një njeri i quajtur Abdullah ibn Hudhejfe, nga fisi Sehm, u ngrit dhe tha: *“O i Dërguari i Allahut, kush është babai im?”*

Kur Abdullahu pati një grindje dhe ngatërresë me disa njerëz, ata u betuan se ai nuk i përkiste babait të tij.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] iu përgjigj: *“Babai yt është Hudhejfe.”*

Derisa i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] po i nxiste ata që t’i parashtrojnë pyetje, Omeri [radijallahu anhu] u ul dhe tha: *“Jemi të lumtur që Allahu është Zoti ynë, Islami feja jonë dhe Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i Dërguari ynë.”*

Atëherë i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndaloi së përsërituri kërkesën. Më pas tha: *“Avla.²⁷ Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, m’u shfaqën Xheneti dhe Xhehenemi për pak kohë përballë këtij muri. Kurrë nuk kam parë ndonjë gjë kaq të mirë dhe kaq të keqe deri më sot. Po ta dinit ju atë që e di unë, do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë.”*

Kjo ishte dita më e rëndë në jetën e sahabëve. Ata madje i mbuluan kokat dhe filluan të qajnë me zë.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] gjithashtu iu adresua popullit pas namazit të drekës në ditën kur dënimi i zinasë u detyrua mbi Ma’izin. Pasi e lavdëroi dhe e lartësoi Allahun Fuqiplotë, tha: *“A do të ndodhë që saherë që dalim në një fushatë ushtarake për kauzën e Allahut, dikush të ngelet prapa me familjet tona, të bëjë zhurmë si çjapi.²⁸ Ai mund t’i japë ndonjë gruaje diç të vogël.²⁹ Pasha Zotin, pasha Zotin, nëse sillet para meje dikush që ka vepruar kështu,*

²⁷ Kjo fjalë arabe bart një kuptim kërcënimi. Në këtë kontekst, ajo do të thotë: “Së shpejti do ta shihni atë që nuk ju pëlqen.”

²⁸ I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] këtu iu referua zhurmës së çjapit kur blegërinë.

²⁹ Kjo i referohet çfarëdo shume të paguar ndaj një gruaje, për të bërë marrëdhënie intime me të.

pa dyshim se do ta ndëshkoj.” Ai as nuk u lut për faljen e Ma’izit, e as nuk foli keq për të.

Duket se këto fjalime u adresuan kur diçka e rëndësishme kishte ndodhur, e me të cilën duhej marrë menjëherë; nuk mund të lihej deri në xhumanë tjetër.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më pas kthehej në shtëpinë e tij, ku i falte dy rekate namaz, të cilat i falte rregullisht pas farzit të drekës.

Pastaj shkonte te shokët e tij. Ndodhte të qëndronte me ta derisa hynte koha e ikindisë, ashtu siç bëri kur ndejti me delegacionin e fisit Abd Kajs, me të cilët ndejti nga dreka e deri në namazin e ikindisë.

Gjatë kësaj kohe, ndodhte t’u vihej në ndihmë nevojave të komunitetit të tij. Në një rast, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], iu tha se banorët e Kubasë, konkretisht fisi i Amr ibn Aufit, kishin ca konflikte dhe telashe mes vete, deri në atë masë saqë e gjuanin me gurë njëri-tjetrin. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i porositi disa nga shokët e tij që ta shoqërojnë dhe të vënë paqe mes

tyre. I tha Bilalit [radijallahu anhu]: *“Nëse hyn koha e namazit të sabahut dhe unë nuk kthehem, thuaj Ebu Bekrit t’u prijë njerëzve në namaz.”*

Kur erdhi koha, Bilali [radijallahu anhu] e thirri ezanin dhe i tha Ebu Bekrit [radijallahu anhu] se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk ndodhej aty dhe se koha e faljes së namazit kishte hyrë. Ndër të tjera, Bilali [radijallahu anhu] e pyeti: *“A mund të na prijsh në namaz, o Ebu Bekr?”* Ebu Bekri [radijallahu anhu] ia ktheu: *“Po, nëse doni.”* Atëherë, Bilali [radijallahu anhu] e thirri ikametin, ndërsa Ebu Bekri [radijallahu anhu] lëvizi para dhe e filloi namazin. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] erdhi në ndërkohë dhe eci përpara, derisa hyri në rreshtin (safin) e parë. Xhemati po i godisnin gjunjët e tyre me shuplaka, por Ebu Bekri [radijallahu anhu] nuk u kthye gjatë namazit. Kur kjo u intensifikua, ai e ktheu kokën paksa dhe e pa të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai dëshiroi të largohej, ashtu që ta lejojë të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] t’u prijë në namaz, por i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e sinjalizoi që të qëndrojë aty ku ishte. Por, Ebu Bekri [radijallahu anhu] eci mbrapa që të hyjë në saf dhe i Dërguari i Allahut,

[sal-lallahu alejhi ve sel-lem], eci përpara që ta udhëheqë namazin. Kur e përfundoi, u kthye nga xhema dhe u tha: *“Pse i goditnit gjunjët me shuplaka gjatë namazit. Shuplaka është e lejuar vetëm për gratë. Nëse diçka ndodh gjatë namazit, duhet të thoni SubhanAllah, d.m.th., i pa të meta është Allahu. Kushdo që e dëgjon këtë, do ta kthejë fytyrën.”* Pastaj iu adresua Ebu Bekrit [radijallahu anhu], duke e pyetur se pse nuk vazhdoi ta udhëheqë namazin kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], qartazi i sinjalizoi që ta bënte një gjë të tillë. Ebu Bekri [radijallahu anhu] ia ktheu: *“Nuk është e drejtë që unë ta udhëheq namazin, kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është i pranishëm.”*

Një tjetër shembull ishte kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vajti tek *Avsafi*, në veri të Bekijes për t'i takuar bijat e Sa'd ibn el-Rabit, ashtu që t'ua ndante pasurinë e babait të tyre. Ato ishin femrat e para që trashëguan në Islam. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vajti t'i takojë ato në mëngjes. Ia sollën ca ushqim që përmbante bukë dhe mish. Vetë ato ia kishin përgatitur ushqimin. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] hëngri, sikurse edhe të pranishmit që ndodheshin me të. Më pas, mori abdes për namazin e drekës. Të pranishmit që ndodheshin me

të, morën abdes gjithashtu. Pasi e falën namazin, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u ul që ta kompletojë ndarjen e pasurisë në mesin e bijave të Sa'dit, derisa hyri koha e ikindisë, kur kjo punë u krye. Ato i shërbyen atij atë që kishte ngelur nga buka dhe mishi. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe shokët e tij hëngrën sërish, dhe pas ngrënies, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u ngrit që t'u prijë të pranishmëve në namazin e ikindisë. As ai dhe as të tjerët që ishin me të nuk patën nevojë që të marrin abdes përsëri.

Pasdite me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Kur thirrej ezani për namazin e ikindisë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] priste derisa të mblidhej xhemati. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i inkurajonte ata që vullnetarisht t'i falnin katër rekate para namazit farz. U thoshte: *"Allahu e mëshiroftë atë që i falë katër rekate para ikindisë."*

Kur mblidheshin njerëzit, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dilte nga shtëpia për ta udhëhequr namazin. E falte në fillim të kohës, derisa dielli ishte ende lart. Enesi [radijallahu anhu] transmeton: "Askush nuk ishte më i shpejtë në faljen e namazit të ikindisë, se i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]."

Në këtë namaz, këndimi i Kur'anit nga Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte sa gjysma e asaj që e këndonte në namazin e drekës.

Kur e përfundonte namazin, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kthehej kah shokët e

tij. Në qoftë se kishte për t'ju thënë diçka, ua thoshte.

Një ditë, pasi e përfundoi namazin, iu adresua të pranishmëve: *“Nuk jam i sigurt nëse duhet t'ju tregoj diç ose jo.”*

Ata i thanë: *“O i Dërguari i Allahut, nëse është diç e mirë, na trego; e nëse është e kundërta, atëherë, Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.”*

“Secili musliman, i cili merr abdes mirë dhe plotësisht, pastaj i falë pesë namazet obligative, këto namaze ia sigurojnë faljen nga ndonjë gjynah, të cilin ka mundur ta bëjë ndërmjet tyre.” - ua ktheu I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Një ditë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pasi e fali namazin e ikindisë, u ngrit që t'u adresoj të pranishmëve. Në fjalimin e tij, ndër të tjera shtoi: *“Kushdo që merr abdes mirë dhe më pas thotë: “Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Tij”, do t'i hapen tetë dyert e Xhenetit. Ai mund të hyjë nga cilado derë që do. Secili musliman, i cili merr abdes mirë dhe më pas ngrihet dhe i falë dy rekate të plota, duke qenë i*

përqendruar me zemër, pa dyshim se do të hyjë në Xhenet."

Krahasuar me ligjërimin e tij pas namazit të drekës, fjalimi i të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pas namazit të ikindisë ishte shumë më i shkurtër. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e dinte se njerëzit ishin të lodhur dhe kishin nevojë t'i kryenin punët ditore e ta përgatitnin darkën. Pasi e përfundonte faljen e namazit të ikindisë, shkonte tek bashkëshortet e tij dhe i vizitonte që të gjitha. Ndodhte të ulej dhe të bisedonte me to. Pastaj përfundonte në shtëpinë e asaj tek e cila e kishte radhën atë natë.

Nganjëherë, të gjitha bashkëshortet mblihdeshin në shtëpinë e asaj tek e cila e kishte radhën ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], të qëndronte atë natë. Ndoshta kjo ishte në kohën e dimrit, kur ditët ishin të shkurtra dhe koha mes ikindisë dhe akshamit ishte shumë e shkurtër për të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] që ta vizitonte secilën prej tyre veç e veç. Në këtë rast, i takonte të gjitha përnjëherë.

Në një rast, ato u mbledhën në shtëpinë e Aishes [radijallahu anha]. Në ndërkohë erdhi

Zejnebe bint Xhahshi. Kur hyri i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ai e vendosi dorën e tij mbi të. Aishja [radijallahu anha] i tha: “Kjo është Zejnebeja”, dhe i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e largoi dorën. Ato dyja filluan të grindeshin dhe e ngritën zërin. Shumë shpejt hyri koha për namaz. Ebu Bekri [radijallahu anhu] kaloi pranë dhe i dëgjoi derisa ato po grindeshin. Ai thirri: “Eja në namaz, o i Dërguari i Allahut, dhe vëju rërë në gojët e tyre.”

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], doli në xhami. Aishja [radijallahu anha] tregon: “Tani, pasi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ta përfundojë namazin, Ebu Bekri [radijallahu anhu] do të vijë dhe do të jetë i ashpër ndaj meje.”³⁰

Pasi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përfundoi namazin, Ebu Bekri [radijallahu anhu] vajti dhe iu drejtua ashpër vajzës së tij,

³⁰ Zejnebeja [radijallahu anha] ishte njëra nga bashkëshortet e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Pasi ky takim ishte në shtëpinë e Aishes [radijallahu anha], atëherë ishte radha e saj atë ditë. Ajo xhelozoi pse i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e vendosi dorën e tij mbi Zejneben [radijallahu anha] dhe i bëri të qarta ndjenjat e saj. Megjithatë, Aishja [radijallahu anha] ishte e brengosur se babai i saj do të zemërohet për atë që ndodhi.

Aishes [radijallahu anha]: “Si mund ta bësh këtë?!”

Kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shkonte në shtëpi pas namazit të ikindisë, ndodhte t’i falte dy rekate namaz vullnetar, edhe pse e dekurajonte faljen e namazit vullnetar pas ikindisë e deri në kohën e akshamit. Kjo ndodhi kur një delegacion nga fisi Abd ul-Kajs erdhi në Medine që t’i thonë të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] se populli i tyre e kishte pranuar Islamin. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i takoi ata pas namazit të drekës. Pasi ishte i preokupuar me ta, nuk i fali dy rekatet sunet të drekës. Në këtë rast, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i fali dy rekate pas ikindisë, si kompensim. Por që andej, rregullisht i falte ato. Nëse e falte një namaz nafie në ndonjë rast, bëhej praktikë e tij që ta falte rregullisht atë pastaj. Aishja [radijallahu anha] transmeton:

“Pasha Atë i Cili i grumbullon shpirtrat, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk i ka braktisur këto dy rekate (d.m.th., ato pas ikindisë), derisa e takoi Zotin e tij.”

Në shumicën e rasteve, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e kalonte kohën pas ikindisë në shtëpi, me bashkëshortet e tij.

Gjatë kohës që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e kalonte me bashkëshortet, gjithmonë mbretëronte atmosferë e këndshme familjare. Gjithmonë kërkohej dituria dhe diskutonin rreth pyetjeve dhe problemeve të ndryshme. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] gjithmonë i mirëpriste pyetjet e tilla dhe iu përgjigjej me kënaqësi. Një shembull i tillë ishte kur Aishja [radijallahu anha] pyeti rreth përvojës më të vështirë lidhur me bartjen e mesazhit të Zotit dhe përpjekjes për t'i bindur njerëzit ndaj të vërtetës. Ajo e pyeti:

“O i Dërguari i Allahut, a ke përjetuar ndonjë ditë më të vështirë se atë të Uhudit?”

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u përgjigj:
“Kam pranuar shumë keqtrajttime nga populli juaj. Më e keqja ishte ajo që e përjetova në Ditën e Akabes (dita e udhëtimit në Taif), pasi e kisha mbrojtur kauzën time ndaj Ibn Abd Xhelilit ibn Abd Kulelit. Ai më refuzoi. Dola i shqetësuar, duke mos ditur nga t’ia mbaja. Mu

rikthye vetëdija kur pashë Karn el-Tha'libin.³¹ E ngrita shikimin dhe vërejta një re mbi mua. E shikova dhe pashë se ishte Xhibrili. Ai më thirri dhe më tha: "Zoti e ka dëgjuar atë që populli yt ta tha dhe mënyrën se si të nënçmuan. Ai e ka dërguar Melekun e kodrave që ta urdhërosh kundër tyre." Meleku i kodrave më thirri dhe më përshëndeti, më pas më tha: "O Muhamed, Zoti e ka dëgjuar atë që të thanë populli yt. Unë jam Meleku i kodrave. Zoti yt më ka dërguar që t'i bart urdhrat e tu. Mund ta thuash atë që do. Nëse dëshiron, mund t'i përplas dy kodrat mbi ta."³² Unë i thashë: "Jo. Shpresoj që Zoti të nxjerrë pasardhës prej tyre, të cilët do ta adhurojnë Allahun duke mos i shoqëruar ortak."

Ky diskutim i ngrohtë mes Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe Aishes [radijallahu anha], tregon se sa e interesuar ishte ajo për çdo gjë që e brengoste të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ajo dëshironte të mësonte rreth përvojës së tij të rëndë, ashtu që të mund t'i ndante ndjenjat e tij me të.

³¹ Ky është një emër tjetër i Karn el-Manazilit, afër Taifit, i cili është vendi ku haxhilerët e veshin ihramin para se të arrijnë në Mekë.

³² Këto janë dy kodra afër Mekës, Kubejsi dhe Ku'ajkiani. Njihen për shkëmbinjtë gurëror.

Qëndrimi i të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në këtë rast, ishte tejet i shpërblyer nga Zoti i tij. Para se t'i vjen fundi jetës së tij të begatshme, shpresat e tij u përmbushën. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i pa shumë nga bijtë dhe bijat e idhujtarëve ta përqafojnë Islamin, ta adhurojnë vetëm Allahun, të mos i shoqërojnë ortak Atij dhe ta demonstrojnë gatishmërinë për t'i sakrifikuar jetët e tyre në mbrojtje të të Dërguarit të Allahut dhe mesazhit të tij.

Një ditë, derisa po bisedonte me Aishen [radijallahu anha], ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], tha: *“Kushdo që merret në llogari në Ditën e Gjykimit, do të dënohet.”*

Aishja [radijallahu anha] pyeste rreth gjërave, e veçanërisht kur ato dukeshin problematike, pasi ishte e etur që të mësonte. Kur e dëgjoi këtë nga i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pyeti:

“Por Allahu thotë për besimtarët: “E përsa i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta, ai do të llogaritet me një llogari të lehtë.” (El-Inshikak: 7-8)”

“Ajeti nuk i referohet llogaridhënies. Ai i referohet prezantimit të veprave. Kushdo i cili pyetet rreth veprave të tij në Ditën e Gjykimit, do të dënohet.” - ia ktheu ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Një ditë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], po fliste me bashkëshorten e tij, Hafsen [radijallahu anha], kur i tha: *“Shpresoj që askush nga ata të cilët morën pjesë në Betejën e Bedrit dhe Hudejbisë, të mos hyjnë në Xhehenem.”*

Ajo i tha: “Po, ata do të hyjnë në Xhenet, o i Dërguari i Allahut.” Ai iu afrua asaj, e ajo tha: “A nuk thotë Allahu në Kur’an: ***“Dhe nuk ka asnjë prej jush që nuk do t’i afrohet atij. Ky (kontaktim i Xhehenemit) është vendim i kryer i Zotit tënd.”*** (Merjem: 71) I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ia ktheu: “A nuk e keni dëgjuar Atë të thotë: ***“Pastaj, (pas kalimit pranë tij) do t’i shpëtojmë ata që ishin ruajtur (mëkateve), e zullumqarët do t’i lëmë aty të gjunjëzuar.”*** (Merjem: 72)

Ndodhte që bashkëshortet t’i parashtronin pyetje ose kundërargumente, pasi ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i inkurajonte ato që të pyesnin dhe të mendonin rreth asaj që u thuhej. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pa dyshim këtë e bënte

përmes diskutimeve dhe bashkëveprimeve, mënyra më mirë për të qenë të përkushtuar.

Disa nga shokët e tij nganjëherë e ftonin që të shkonte te ta pas namazit të ikindisë, derisa ndodhte ata të bënëin diç dhe dëshironin që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], të qëndronte me ta. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i pranonte ftesat e këtilla.

Një ditë, pas namazit të ikindisë, një burrë nga fisi i Selemes, i tha: “O i Dërguari i Allahut, do ta therim një deve dhe do të donim që të na bashkëngjitësh.” Për ta, ky ishte një rast i mrekullueshëm, ngase mishi ishte i paktë në atë kohë. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pranoi dhe vajti me ta. Po ashtu, edhe një numër sahabësh iu bashkuan. Me të arritur, panë se deveja ende nuk ishte therur. Më pas ajo u ther dhe u nda në shumë pjesë. Ca nga mishi i saj u përgatit dhe hëngrën prej saj para muzgut.

Reflektoni në këtë ngjarje. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vajti në një ditë vere tek shtëpia e Selemes në veri të Medinës, lagjja më e largët nga xhamia e tij, vetëm që t’u bashkohet njerëzve dhe të ndajë gëzimin me ta në

therjen e devesë. Mund ta imagjinoni se ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vajti atje në këmbë, vetëm e vetëm që t'i kënaqë njerëzit dhe që t'ua shtojë gëzimin e lumturinë. Pastaj, kjo ngjarje u transferua nga thjesht therje e një deveje, në një vizitë nga i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dhe ndarje e gëzimit dhe lumturisë me ta. Fisi i Selemes duhet të kenë folur rreth kësaj çështje për një kohë të gjatë.

Sa i mirë, i butë, i dashur dhe zemërngrohtë ishte i Dërguari Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai ishte çdo herë i gatshëm që t'u ofronte mundësi kënaqësie, me qëllim që ta ngriste lumturinë dhe gëzimin e njerëzve. Është kjo karakteristikë, ajo që i dha atij pozitë unike në jetën e sahabëve të tij.

Pas perëndimit të diellit me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Kur thirrej ezani për namazin e akshamit, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dilte në xhami. I gjente sahabët afër shtyllave të xhamisë, duke i falur dy rekate namaz nafile, pasi vetë ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i inkurajonte ta bënëin këtë. U thoshte: *“Falni dy rekate para namazit të akshamit.”* Këto janë dy rekate të shkurtra, sepse koha mes ezanit dhe fillimit të faljes së farzit të akshamit me xhemat është e shkurtër.

Kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] hynte në xhami, thirrej ikameti dhe ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], fillonte menjëherë namazin farz. E falte namazin e akshamit sapo që hynte koha e tij dhe e përfundonte para se të binte terri. Thuhet se kur ndonjëri largohej nga xhamia pas namazit të akshamit, ende ishte dritë. Po ta hidhje ndonjë shigjetë, mund ta shihje se ku do të përfundonte ajo.

Këndimi i tij i Kur’anit në namazin e akshamit dhe vetë namazi, në të shumtën e rasteve, ishte i shkurtër. Nganjëherë ndodhte ta lexonte

një pasazh të gjatë, por kjo ndodhte rrallëherë. Një ditë, në namazin e akshamit e këndoi suren *El-A'raf*³³, ndërsa në një rast tjetër suren *Et-Tur*. Namazi i akshamit ishte namazi i fundit që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e udhëhoqi para se të ndërrojë jetë. Në atë rast, ai e këndoi suren *El-Murselat*.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nuk ulej që t'u mbante ligjeratë sahabëve pas namazit të akshamit, siç ndodhte pas namazeve tjera gjatë ditës. Kjo për faktin se njerëzit duhej të shkonin në shtëpi për të darkuar dhe për të pushuar. Pasi e përfundonte namazin farz, kthehej në shtëpi dhe i falte dy rekate sunet. Më pas, darkonte, pasi kjo ishte koha e rregullt e darkimit. Ndodhte të darkonin para se ta falnin namazin e akshamit, nëse ishin agjërueshëm. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thoshte: *"Nëse u shërbehet ushqimi, hani para se ta falni akshamin. Mos e lini pas namazit."*

Shpesh herë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u thoshte sahabëve që të marrin me vete

³³ Surja El-A'raf është surja e katërt më e gjatë e Kur'anit, e përbërë nga 26 faqe, përderisa surja Et-Tur ka dy faqe e gjysmë.

ndonjë të varfër: *“Kush ka ushqim për dy persona, le ta marrë edhe të tretin, dhe kush ka ushqim për katër persona, le ta marrë të pestin ose të gjashtin.”*

Vetë ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ndodhte që t’i merrte dhjetë njerëz që të darkonin së bashku me të, nëse kishte mjaft ushqim. Shpeshherë ndodhte të shkonte në shtëpi dhe nuk gjente për të ngrënë diç tjetër, pos ca hurma dhe ujë. Kalonin ditë të tëra dhe asgjë nuk gjendej në shtëpinë e tij për të ngrënë.

Një ditë, një burrë, i cili dukej i rraskapitur dhe i uritur, erdhi te Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Shenjat e urisë dhe lodhjes së skajshme dukeshin qartë në fytyrën e tij. Ai iu drejtua Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] me fjalët: *“O i Dërguari i Allahut, jam në një gjendje dëshpërimi.”* I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] menjëherë e dërgoi dikë tek njëra prej bashkëshorteve të tij, për të pyetur nëse kishte ndonjë gjë për ta ushqyer mysafirin e uritur. Përgjigjja e saj, në atë rast qe: *“Pasha Atë i Cili të ka dërguar me të Vërtetën, nuk kam asgjë tjetër, pos ujit.”* E dërgoi atë (të deleguarin e tij) tek bashkëshortja tjetër e tij, dhe përgjigjja e saj ishte e njëjtë. Në fakt,

e dërgoi të deleguarin e tij tek secila nga bashkëshortet e tij, por që të gjitha i dhanë të njëjtën përgjigje. Ato nuk kishin asgjë, pos ujit. Më pas, u kthye kah sahabët dhe i pyeti: *“Kush po e merr këtë burrë mysafir sontë, Allahu e mëshiroftë.”*

Ebu Talha el-Ensariu [radijallahu anhu] u ngrit dhe tha: *“Do ta marr unë, o i Dërguari i Allahut.”* - dhe e mori mysafirin atë natë.

Ushqimi i të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] gjithmonë shtrohej në një tabak mbi dysHEME. Kur i shërbehej ushqimi, thoshte: *“Në emër të Allahut”*, dhe hante nga ajo që ndodhej para tij. Hante me tre gishtërinj. I udhëzonte ata që ishin me të që të hanë para vetes dhe të mos marrin nga mesi,³⁴ duke u thënë: *“Bereqeti është aty.”*

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kurrë nuk ishte i bezdisshëm rreth ushqimit. Hante çfarëdo që i shërbehej. Ndodhte t'i pyeste bashkëshortet e tij:

“A u ka mbetur gjë (nga ushqimi)?”

³⁴ D.m.th. maja e ushqimit në tabak.

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Nganjëherë i thoshin: “Nuk na ka ngelur gjë.” E herave tjera: “Kemi vetëm uthull.”

“Eh sa e shëndetshme është uthulla.” - u thoshte ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] asnjëherë nuk gjente mangësi në ushqime. Nëse i pëlqente, e hante, përndryshe, e linte.

Kur ulej për të ngrënë me shokët e tij, aty zhvillohej një bisedë e këndshme. U tregonte rreth sjelljeve të mira ose edhe përhapte dituri mes tyre.

Për ta dhënë një shembull, Omer ibn Ebi Seleme, djali i birësuar i të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte rritur në shtëpinë e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Umu Seleme [radijallahu anha], bashkëshortja e tij, ishte e ëma e fëmijës. Ai hante ushqim me të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] një herë vuri re se dora e djaloshit po bredhte nëpër tabak, duke marrë ushqim nga të gjitha pjesët e enës. Atëherë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i tha: “O djalosh,

fillo duke e përmendur Allahun, ha me dorën e djathtë dhe ha para vetes."

Omeri tha më vonë: "Që atëherë, ashtu haja më."

Një ditë prej ditësh, një tabak me *tharid* (hurma dhe mish) iu servua të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai e mori shpatullën e qengjit, që i pëlqente më së shumti, dhe e kafshoi një herë.³⁵ Më pas tha:

"Unë do të jem lideri i njerëzimit në Ditën e Gjykimit."

Pastaj e kafshoi edhe një herë dhe e përsëriti atë që e tha më parë. Askush nuk e pyeti gjë.

"A nuk do të më pyesni, si?" - pyeti të pranishmit ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Ata pyetën: "Si, o i Dërguari i Allahut?"

"Në Ditën e Gjykimit, Allahu do t'i grumbullojë të gjithë njerëzit e gjeneratave të kaluara, të tashme dhe të ardhshme në një vend, kështu që ata do ta dëgjojnë thirrësin dhe do ta shohin me sytë e tyre. Dielli do t'u

³⁵ Shprehja në gjuhën arabe nënkupton: "Kafshim vetëm me dhëmbët e parë."

jetë mbi koka dhe do ta ndjejnë nxehtësinë e tij. Do të vuajnë shumë derisa ai (dielli) iu afrohet. Njerëzit do të jenë në vështirësi të mëdha. Vështirë se do t'i bëjnë ballë situatës. Disa prej tyre do të thonë: "A nuk e ndjeni se sa shumë po vuajmë? A nuk mund ta mendoni ndokënd i cili do të mund të ndërmjetësonte për ne tek Zoti ynë?" Disa prej tyre do të thonë: "Le të shkojmë tek Ademi [alejhis-selam]." - ua ktheu ai.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua rrëfeu hadithin e gjatë, i cili flet rreth privilegjeve të ndërmjetësimit që Zoti i Madhërishëm ia ka dhënë atij.

Pasi e përfundoi ngrënien e ushqimit, i lëpiu gishtërinjtë. Gjithashtu, i porositi të tjerët që t'i lëpijnë pjatat e tyre³⁶, duke u thënë: "Nuk e dini se në cilën pjesë të ushqimit tuaj është bereqeti."

Pasi u largua ushqimi, ai e falënderoi Allahun e Lartësuar me një lutje prekëse:

³⁶ Kjo ishte mënyra sesi i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ua mësonte rëndësinë e mosçarjes dëm të ushqimit. Asgjë nuk duhet hedhur. Madje edhe ajo që ngelet në gishtërinj është e shëndetshme dhe duhet të përdoret. Ushqimi është begati e Allahut ndaj nesh dhe që të jemi mirënjohës ndaj Zotit, kërkohet që mos ta çojmë dëm atë.

“Falënderuar qoftë Zoti, me një falënderim të madh dhe të begatuar. Falënderuar qoftë Zoti, i Cili na ka dhënë ushqim të bollshëm për të ngrënë dhe për të pirë. Zoti ynë nuk mund të mos falënderohet ose të mos i tregohet mirënjohje. Neve as nuk ia kthejmë shpinën Atij dhe as nuk e mohojmë nevojën tonë për begatitë e Tij. Zoti ynë, Ti je Ai i Cili na ke dhënë ushqim dhe pije, pasuri dhe bollëk, na ke furnizuar me udhëzim dhe jetë. Ty të takon falënderimi për tërë atë që na e ke dhuruar.”

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e pastronte gojën pasi hante ushqim dhe pinte qumësht. Thoshte se qumështi përmban yndyrë.

Kur darkonte, e kishte të përgatitur një pije që nga mëngjesi,³⁷ dhe në rast se hante drekë herët gjatë ditës, e kishte të përgatitur një pije që nga mbrëmja paraprake.

Nëse ndonjëra nga bashkëshortet e tij hante me të, ata zhvillonin një bisedë të këndshme gjatë ngrënies. Në fakt, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-

³⁷ Pija mund të ishte ujë, në të cilin hurmat, rrushi i thatë apo mjalti ishin përzier. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] asnjëherë në jetën e tij nuk kishte konsumuar pije dehëse.

lem], e inkurajonte këtë, duke thënë: *“Sadakaja më e mirë, është kafshata që burri ia jep bashkëshortes me dorën e tij.”*

Aishja [radijallahu anha] na e sjell një shembull se çfarë bënte i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kur darkonte me të:

“I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më thërriste që të haja ushqim me të kur e kisha ciklin menstrual. Ai merrte ndonjë asht të mveshur me mish dhe më luste që të haja nga mishi. Haja pak dhe tjetrën e lija. Ai më pas e merrte atë dhe e hante, duke i vendosur buzët aty ku unë i kisha vendosur paraprakisht. Më pas kërkonte ndonjë gjë për të pirë dhe më luste që unë të pija para tij. E merrja gotën, pija nga ajo dhe më pas e lija. Ai pastaj e kapte gotën, i vendoste buzët e tij aty ku unë i kisha vendosur buzët e mia më parë, dhe pinte.”

Eh, sa mesazhe të dashurisë dhe butësisë një bashkëshort i tillë ia dërgonte bashkëshortes së tij të dashur! Eh, çfarë niveli të kënaqësisë i siguronte asaj! Pa pasur nevojë të themi, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i jepte ushqim shpirtëror dhe fizik asaj.

Në namazin e natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], qëndronte në shtëpi derisa thirrej ezani i jacistë. Nuk ngutej që menjëherë ta falte atë. I priste njerëzit. Nëse ata mblidheshin herët, atëherë e falte, e nëse vonoheshin, e shtynte faljen e saj. Preferonte ta shtynte këtë namaz, por nuk dëshironte t'ua vështirësonte gjërat njerëzve.

Një herë, e vonoi faljen e namazit të jacistë. Erdhi Omeri [radijallahu anhu] dhe e thirri: “O i Dërguari i Allahut, burrat dhe gratë kanë shkuar për të fjetur.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] doli duke i pikuar koka. Më pas i tha: *“Kjo është koha e duhur. Po të mos frikësohesha se do t’ia vështirësoja gjërat Umetit tim, do të urdhëroja që ta falin namazin e jacistë në këtë kohë.”*

Një natë, pasi u thirr ezani për ta falur namazin e jacistë, një burrë u ngrit në këmbë dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, kam për të të thënë diçka.” I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u

ngrit, u veçua me të dhe biseduan. Të pranishmit pritën, ndërsa disa prej tyre madje edhe u ndjenë të përgjumur.

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e falte namazin lehtas, por thoshin se ishte i përkryer. Enesi [radijallahu anhu] ka thënë: “Kurrë nuk jam falur prapa një imami, namazi i të cilit ishte më i lehtë dhe në të njëjtën kohë më i përkryer sesa ai i të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].”

Derisa ishte duke falur namaz, ndodhte ta dëgjonte ndonjë fëmijë duke qajtur, e nëna e fëmijës qëllonte duke u falur, dhe më pas këndonte sure të shkurtra, ashtu që të mos ia vështirësonte gjërat nënës së fëmijës. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], thoshte: *“E filloi namazin duke synuar që ta zgjas, por pastaj dëgjoi të qarat e ndonjë fëmije dhe e shkurtoi, ngase e di se sa e shqetësuar është nëna e tij për shkak të qarjes.”*

Kur e përfundonte namazin e jaxisë, u drejtohej shokëve të tij nëse ishte nevoja që t’u drejtohej. Për shembull, një natë, nga fundi i jetës së tij, e përfundoi namazin e jaxisë dhe u ngrit. Më pas tha: *“Shikojeni këtë natë. 100 vjet nga kjo natë, askush nga ata të cilët janë gjallë sot, nuk do të jenë më.”*

Një natë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e vonoi namazin e jacisë; më pas i priu xhematit dhe me ta përfunduar, iu drejtua atyre me fjalët: *“Disa e kanë falur namazin e tyre dhe kanë shkuar në shtrat. Llogariteni se jeni në namaz për aq kohë sa e prisni atë.”*

Një natë tjetër, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e vonoi namazin e jacisë shumë³⁸. Pasi përfundoi falja e namazit, iu adresua të pranishmëve: *“Prisni pak! Gëzohuni, pasi Zoti ka derdhur mbi ju mirësinë e Tij, ku askush tjetër pos jush nuk ka qenë duke falur namaz në këtë kohë.”* Sahabët vajtën në shtëpi të gëzuar pasi e mësuan këtë gjë, pasi ky ishte një lajm i mirë që iu dha atyre nga i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], rrallëherë u mbante ligjëratë sahabëve pas namazit të jacisë, ndërsa kur këtë e bënte, iu drejtohej shkurtimisht, ngase njerëzit normalisht ishin të lodhur për gjumë. Thënë në përgjithësi, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nuk preferonte që t’u adresohet njerëzve pas namazit të jacisë.

³⁸ Vonimi u bë deri në mesnatë.

Kur e përfundonte namazin, qëndronte në vendin e tij derisa gratë largoheshin nga xhamia, dhe më pas shkonte në shtëpi. Kur ngrihej për të marrë rrugën drejt shtëpisë, gjithashtu ngriteshin edhe burrat e tjerë.

Në pjesën e parë të natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më pas kthehej në shtëpi dhe e falte sunetin³⁹ e rregullt të jacisë. Pastaj ulej për pak kohë dhe bisedonte me bashkëshorten e tij, butësisht. Ishte kjo kohë e një bisedeje të këndshme me familjen e tij. E nganjëherë shkonte tek ndonjëri prej shokëve të tij për ndonjë bisedë relaksuese. Ndonjëherë shkonte te ensarët dhe kalonte kohë me ta. Shpesh herë kalonte ca kohë me Ebu Bekrin dhe Omerin [radijallahu anhum] në shtëpinë e Ebu Bekrit [radijallahu anhu]. Në të tilla raste, ata flisnin për Umetin musliman dhe nevojat e tij. Kur Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] largohej, edhe ata dilnin me të, duke e shoqëruar deri te shtëpia e tij. Shkonin edhe në xhami së bashku.

Derisa merrte rrugën i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ndodhte të kalonte pranë ndonjë sahabiu që po këndonte Kur'an në mesnatë

³⁹ Namazi sunet rekomandohet, por nuk është obligativ. Secili nga pesë namazet obligative ditore është i shoqëruar me sunete, të cilat dallojnë për nga numri i rekateve.

me një zë melodik. Ndalej pa hezitim që ta dëgjonte këndimin e tij të bukur. Një natë, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kaloi pranë Ebu Musa el-Eshariut [radijallahu anhu] dhe u ndal që ta dëgjojë atë derisa këndonte Kur'an. Kur e takoi të nesërmen në mëngjes, i tha: *"O Ebu Musa, (do të kënaqeje) të më shihje duke e dëgjuar këndimin tënd të Kur'anit natën e kaluar? Ke një zë të mrekullueshëm, sikur pothuajse posedoje psalmet e Davudit."*

Pejgamberi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vajti një natë në xhami dhe e gjeti Abdullah ibn Mes'udin [radijallahu anhu] duke u falur. Ky i fundit po e këndonte suren *En-Nisa*, e i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u ndal ta dëgjojë. Më pas i tha Ebu Bekrit [radijallahu anhu] dhe Omerit [radijallahu anhu]: *"Kush dëshiron ta këndoje Kur'anin ashtu siç është zbritur, le ta këndoje si Ibn Um Abdu⁴⁰."*

Kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] hynte në xhami, përshëndeste me selam me një zë që mund të dëgjohej nga një person që ishte zgjuar, por jo aq me ton të lartë sa të zgjonte nga

⁴⁰ Ibn Um Abd, një shprehje dashurie të cilën i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përdorte vetëm kur i referohej Abdullah ibn Mes'udit.

gjumi të fjeturin. Gjithmonë kishte disa muslimanë të varfër që flinin në xhami. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], fillimisht falej në xhami para se të hynte në shtëpinë e tij.

Kur shkonte në shtëpi dhe dëshironte të flinte gjumë, e merrte një pjesë të rrobës që ndodhej në shtrat dhe mbulohej me të nga beli e teposhtë. Më pas zhvishej, duke i mbajtur dy rroba dhe i bashkohej bashkëshortes në shtrat. Shtrati i tij ishte një dyshek i mbushur me fije; jastëku të cilin e ndante me bashkëshorten, ishte i po të njëjtit material. Kur shkonte në shtrat, e linte misvakun afër jastëkut, ashtu që ta përdorë pasi të zgjohej nga gjumi. Saherë që zgjohej, qoftë nëse flinte ditën ose natën, gjëja e parë që bënte ishte pastrimi i dhëmbëve me misvak. Pasi i pastronte dhëmbët, misvakun ia jepte Aishes [radijallahu anha], por ajo fillimisht e përdorte atë për t'i larë dhëmbët, ashtu që ta shijonte pështymën e tij të bekuar, e pastaj e pastronte atë dhe ia jepte Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ky i fundit gjithmonë e mbante misvakun afër dorës, ashtu që ta pastrojë gojën. Në fakt, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], frikësohej se mos po humbte ndonjë dhëmb për shkak të pastrimit të shumtë të tyre.

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], donte që gjithmonë ta kishte gojën e pastër; kjo pasi fliste me Melekë. Prandaj nuk hante fasule dhe perime që kishin erë të fortë. Nëse pyetjesh rreth kësaj, ai thoshte: *“Turpërohem nga Melekët e Zotit. Këto (ushqime) nuk janë të ndaluara që të hahen, por unë flas me ata me të cilët ju nuk flisni.”* Prandaj e mbante misvakun pranë vetes, ashtu që ta pastronte gojën pasi të zgjohej nga gjumi, dhe e mbante pranë saherë që shkonte për të fjetur.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], fliste me bashkëshorten e tij për ca kohë. Mund ta marrim me mend llojin e bisedës në mes të një bashkëshorti dashurues e fisnik dhe bashkëshortes së tij, në natën e qetë. Ajo ishte një bisedë që përmbante dashuri dhe lumturi, e kjo pa dyshim kontribuonte në thellimin e lidhjes shpirtërore mes çiftit.

Pas kësaj bisede të bukur, nëse e ndjente nevojën e burrit për grua, përfshihej në marrëdhënie intime. Edhe nëse bashkëshortja ishte me cikël menstrual, kjo gjë nuk e privonte atë nga kënaqësia. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i thoshte bashkëshortes ta mbështjellë belin dhe

përfshiheshin në paralojë⁴¹, por jo edhe në penetrim. Pa pasur nevojë të themi, kjo ia jepte bashkëshortes një ndjenjë se ajo ishte e dëshiruar dhe se barriera natyrore që parandalon marrëdhëniet seksuale nuk e ndalonte çiftin e martuar të jenë afër njëri-tjetrit dhe në intimitet.

Umu Seleme [radijallahu anha] transmeton: “Isha me të Dërguarin e Allahut në shtrat, kur më filloi cikli menstrual. Unë u largova nga mbuloja e shtratit.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më pyeti: “A të kanë ardhur të përmuajshmet?”

I thashë: “Po!”

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ma ktheu: “Kjo është diçka që Allahu e zbaton tek të gjitha gratë.”

Më pas u ktheva përsëri. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më tha: “Eja pranë meje, mu afro në shtrat.” Në fakt, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më tërhoqi afër tij nën mbulojë.

⁴¹ Në Islam, marrëdhënia seksuale mes një burri dhe gruaje është e ndaluar gjatë ciklit të saj menstrual, por përqaftimet, puthjet dhe paraloja janë të lejuara.

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], normalisht pastrohej, d.m.th., merrte gusëll para se të flinte gjumë. Në mënyrë alternative, merrte abdes dhe shkonte për të fjetur. Nganjëherë, së bashku me bashkëshorten e tij e përdornin të njëjtën vaskë uji për t'u pastruar, duke i futur duart e tyre në të. Ajo i thoshte: "Ma lër ca ujë edhe mua," dhe të njëjtën gjë ia thoshte edhe ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ky, përsëri është një shembull i marrëdhënies së afërt dhe të kënaqshme në mes të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe bashkëshorteve të tij.

Kur shtrihej në shtrat, I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] thoshte:

"I tërë falënderimi i takon Zotit, i Cili na ka dhënë ushqim dhe pije të mjaftueshme, dhe na ka dhënë strehim. I tërë lavdërimi i takon Zotit, i Cili ka derdhur mbi Mua mirësinë e Tij; mirësi të bollshme. Lavdëruar qoftë Allahu në të gjitha situatat. Zoti im, Zoti i të gjithëve, Poseduesi i gjithçkaje, Ty të takon çdo gjë. Kërkoj mbrojtje nga zjarri i Xhehenemit."

Më pas i bashkonte shuplakat e duarve, frynte mbi to dhe i këndonte tri suret e shkurtra

të Kur'anit⁴², para se me to ta përshkonte kokën, fytyrën dhe pjesët e përparme të trupit. Këtë e përsëriste tri herë.

Në shtrat, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shtrihej në anën e djathtë dhe e vendoste dorën nën faqe. Në këtë pozitë, thoshte:

"Zoti im, me emrin e Tënd jetoj dhe me emrin Tënd vdes.⁴³ Zoti im, më ruaj nga dënimi Yt në Ditën kur do t'i ringjallësh robërit e Tu."

"O Allah, Ti krijove shpirtin Tim dhe Ti më bën të vdes. Në Dorën Tënde është jeta dhe vdekja ime. Nëse më jep jetë, më mbroj, e nëse më bën të vdes, m'i fal mëkatet. O Allah, të lutem më jep shëndet."

⁴² Suren Ihlas: *"Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë."* Suren Felek: *"Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit, prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron."* Dhe suren Nas: *"Thuaj: "Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve! Të adhruarin e njerëzve! Prej të keqes së cytësit që fshihet, i cili bën cytje në zemrat e njerëzve. Qoftë ai (cytësi) nga xhinët ose nga njerëzit."*

⁴³ Kjo duhet të kuptohet nën dritën e konceptit se gjumi është formë e vdekjes dhe zgjimi nga gjumi është formë e ringjalljes.

Veç tjerash, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] gjithashtu i thoshte edhe lutjet vijuese:

“O Allah, Zot shtatë qiejve dhe Zot i Arshit të madh, Zoti ynë dhe Zot i çdo sendi, Zbërthyes i farës (i kokrrës së saj) dhe i bërthamës (së pemës), Zbritës i Teoratit, Inxhilit dhe Furkanit (Kur’anit). Kërkoj mbrojtjen Tënde nga sherri i çdo sendi, balli i të cilit është në Dorën Tënde. O Allah, Ti je i pari dhe para Teje nuk pati asgjë. Ti je i fundit dhe pas Teje nuk mbetet asgjë. Ti je i dukshmi dhe mbi Ty s’ka asgjë. Ti je i padukshimi dhe nën Teje s’ka asgjë. Largoje nga ne borxhin dhe na shpëto prej varfërisë.”

“O Allah, unë ta dorëzova Ty shpirtin tim. Ty ta kam dorëzuar çështjen time dhe fytyrën time e ktheva kah Ti. Te Ti e strehova shpinën time, me shpresë dhe me frikë prej Teje. S’ka shpëtim dhe as strehim përveçse te Ti. E besova Librin Tënd (Kur’anin) që e ke zbritur dhe e besova lajmëtarin (Pejgamberin) që e dërgove.”

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], po ashtu, ndodhte t’i këndonte suret 32, 67, 39 ose edhe suren 17 të Kur’anit Fisnik.

Më pas flinte. Kur ishte i përgjumur, frymëmarrja e tij mund të dëgjohej. Nëse kthehej në shtrat gjatë natës, thoshte:

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

“Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Një dhe të Plotfuqishëm, Zoti i qiejve dhe i tokës dhe krejt çka ka ndërmjet tyre, Krenari, Falësi i gjynaheve.”

Saherë që kthehej në shtrat natën, e merrte misvakun dhe e pastronte gojën para se të flinte sërish. Ngelte në gjumë deri në mesnatë. Duket se kjo ishte periudha më e gjatë që flinte i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Në thellësinë e natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Kur afrohej mesnata ose pak pas saj, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] zgjohej. Ulej dhe e fërkonte fytyrën me dorë, ashtu që ta largonte gjumin. E merrte misvakun dhe e pastronte gojën. Pastaj, e ngrinte kokën kah qielli, duke medituar në heshtje të plotë të mirësisë së natës së Zotit, siç manifestohej në kirjimtarinë e Tij. Derisa e bënte këtë, i lexonte ajetet kur'anore vijuese:

“Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): “Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! Zoti ynë, atë që Ti e fute në zjarr, atë e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtarë! Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): “Të besoni Zotin tuaj!” E ne besuam! Zoti ynë, na i falë mëkatet tona, na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët! Zoti ynë, jepna

atë që nëpërmjet të Dërguarve Tu, na e premtove dhe në Ditën e Kijametit mos na turpëro; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel premtimin!" Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre (e tha): "Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë ose femër. Ju jeni njëri nga tjetri por ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i fus në xhenete në të cilët burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana e Allahut, se më i miri i shpërblimeve është te Allahu. Të mos u mashtrojë bredhja nëpër qytete e atyre që nuk besuan. Ajo është një kënaqësi e pakët, e pastaj vendi i tyre është Xhehenemi që është vend mjerimi. Por ata që ia patën frikën Zotit të tyre, ata i kanë xhenetet nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe aty janë përgjithmonë. Ajo është pritje nga ana e Allahut, e për të mirët më e dobishmja është ajo që është te Allahu. Po edhe nga ithtarët e librit ka që besojnë Allahun, e besojnë atë që u është shpallur juve, e besojnë atë që është shpallur atyre, janë të bindur ndaj Allahut në shpallje nuk i shesin për pak send të kësaj jete. Të tillët kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre, e Allahu është që llogarinë e bën shpejt. O ju besimtarë, bëni durim, bëhuni të

qëndrueshëm kundër armikut, rrini të përgatitur dhe, që të shpëtoni, ruajuni dënimit të Allahut."

(Ali Imran: 190-200)

Më pas, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ngrihej dhe e merrte një kënatë uji. E hapte kënatën dhe e derdhte ca ujë në një ibrik që e posedonte. Pastaj merrte abdes, por gjithnjë duke treguar kujdes që ta kursente ujin. Më pas i veshte dy mantela dhe e zhveshte rrobën që e kishte lidhur për beli. Pas kësaj fillonte ta falë namazin e natës.

Ndodhte ta madhëronte Allahun e Lartësuar dhe t'i lutej para se të niste faljen e namazit të natës, ashtu që të përfshihej në një atmosferë të plotë të adhurimit natën. Aishja [radijallahu anha] transmeton se kur i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] zgjohej, i përsëriste këto fraza nga dhjetë herë: 'Allahu Ekber (Allahu është më i madhi)'; 'Elhamdulillah (I tërë falënderimi i takon Allahut)'; 'SubhanAllah (I pa të meta është Allahu)'; 'Subhan el-Malik el-Kudus (E pambarim është lavdia dhe sovraniteti i Tij)'; "Estagfirullah (Kërkoj falje te Allahu)"; "La ilahe il-laAllah (Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut)'. Më

pas thoshte dhjetë herë: *"Zoti im, kërkoj falje te Ti nga ngushtësia e kësaj bote dhe nga ngushtësia në Ditën e Ringjalljes."* Pastaj e fillonte namazin.

E fillonte namazin e natës me dy rekate të shkurtra. I falte rekatet e shkurtra kur u printe xhematit, por kur falej i vetëm, namazi i tij ishte më i gjati në të gjitha aspektet, si në fillim, në këndim të Kur'anit, ashtu edhe në lutje. Këtë e bënte në pajtim me udhëzimin e Allahut të Lartësuar: *"Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj."* (El-Muzemil: 2)

Po ta shikojmë me kujdes namazin e tij të natës, shohim se ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte tërësisht i involvuar në namaz. Të gjitha ndjenjat, ndjesitë dhe adresimet e tij ishin të përqendruara në namaz, sikur pothuajse shpirti i tij ngjitej në shoqërinë më të lartë, për të marrë dritën që vjen nga Zoti. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dukej sikur po e shihte Fronin e Allahut të Lartësuar dhe po i fliste Atij drejtpërsëdrejti. Glorifikimet e tij ndaj Zotit të Madhërishëm ishin më të shprehurat dhe lavdërimet e mirënjohjet e tij ishin ndjenja më e madhe njerëzore. Lutja e tij e përmbledhte tërë atë për të cilën njerëzit

faleshin. Ishte ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili udhëtoi natën kur shtatë portat e qiellit iu hapen. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u ngrit në një nivel ku i dëgjoi lapsat hyjnor derisa shkruanin se çfarë po ndodhte.

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kishte njohurinë më të madhe rreth Zotit; kishte besimin më të përkryer. E tha të vërtetën e qartë kur u shpreh: *“Unë jam ai që ia ka frikën më së shumti Allahut në mesin tuaj.”*

E fillonte namazin duke e lartësuar Allahun, duke shprehur dashuri ndaj Tij dhe duke aspiruar të jetë me Të. Fillimin e namazit e bënte me frazat më glorifikuese dhe lavdëruese, si: *“Zoti im, Zoti i Xhibrilit, Mikalit dhe Israfililit, Krijues i qiejve dhe i tokës, Ti ke dituri të plotë mbi të dukshmen dhe të padukshmen. Ti je Gjykues mes robërve Tu në tërë atë që ata dallojnë. Më udhëzo me lejen Tënde në kursin e drejtë rreth asaj që njerëzit dallojnë. Ti je Ai i Cili e udhëzon kë do në rrugën e drejtë.”*

Një shembull tjetër i lutjeve me të cilat e fillonte namazin, ishte:

“Zoti Ynë, i tërë lavdërimi të takon Ty. Ti je drita e qiejve dhe e tokës, dhe i të gjitha krijesave në të.”

I tërë falënderimi të takon Ty. Ti je Mbreti i qiejve dhe tokës, dhe i të gjitha krijesave në të. I tërë lavdërimi dhe falënderimi të takon Ty. Ti je e vërteta; premtimi Yt është i vërtetë; takimi me Ty është i vërtetë; fjala Jote është e vërtetë; Xheneti është i vërtetë; Xhehenemi është i vërtetë; Pejgamberët janë të vërtetë; Muhamedi është i vërtetë; dhe Dita e Fundit është e vërtetë. Zoti im, Ty të jam mbështetur, në Ty besoj, Ty të nënshtrohem, Ty të kthehem, tek Ti mbështetem për vendime. Më fal atë që e kam vepruar në të kaluarën dhe atë që mund ta veproj në të ardhmen; atë që e kam bërë fshehtas ose haptas, dhe atë që Ti e di më mirë se unë. Ti je Ai i Cili jep sukses dhe mosesukses. Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Teje. Asnjë fuqi nuk operon përveçse me lejen Tënde.”

Një tjetër lutje hyrëse ishte:

“E kam kthyer fytyrën time me pëkushtim të plotë dhe të pastër ndaj Atij i Cili i solli në ekzistencë qiejt dhe tokën. Nuk jam nga ata që i shoqërojnë Allahut ortak. Namazi im, adhurimi im, jeta dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e të gjitha botëve. Ai nuk ka ortak. Jam urdhëruar dhe jam nga ata të cilët ia dorëzojnë vetveten Atij. Zoti im, Ti je Mbreti; nuk ka të adhuruar me meritë përveç Teje. Ti je Zoti im dhe unë jam robi Yt. I kam bërë padrejtësi vetvetes dhe i pranoj gjynahet

e mia; m'i fal të gjitha gjynahet, pasi askush nuk i fal ato pos Teje. Më udhëzo me sjelljet më të mira, pasi askush nuk udhëzon në sjellje të mira përveç Teje. Më mbaj larg sjelljeve të këqija, pasi askush nuk të largon prej tyre përveç Teje. Të përgjigjem ty. E tërë mirësia është në Dorën Tënde, ndërsa ligësia nuk është nga Ti. Jetoj për Ty dhe tek Ti. Lavdëruar dhe lartësuar qofsh Ti. Kërkoj faljen Tënde dhe tek Ti pendohem."

Në namazin e natës, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], këndonte Kur'an në mënyrë të qartë dhe të ngadaltë. Saherë që këndonte ndonjë ajet që fliste rreth mëshirës së Allahut, lutej për mëshirë, e saherë që përmendte ndonjë ajet që përshkonte dënimin, i lutej Allahut që ta kursente nga ai dënim; kur këndonte ndonjë ajet që e konfirmonte lartësimin dhe lavdërimin e Allahut, e lavdëronte dhe lartësonte Atë.

Kur ngrihej për të falur namaz nate, e zgjaste atë. Transmeton Abdullah ibn Mes'udi [radijallahu anhu]: "Një natë, u fala me të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dhe ai qëndroi aq gjatë në këmbë, saqë isha gati të bëja diçka jo-të hijshme." Njerëzit e pyetën se çfarë ishte gati të bënte. Ai tha: "Mendova të ulem dhe ta lë të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në këmbë."

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndodhte të këndonte sure të gjata kur'anore në namazin e natës, duke falur vetëm një numër të vogël rekatesh. Namazi i tij i natës asnjëherë nuk i kalonte 13 rekate. Rukuja e tij zgjaste po aq sa edhe qëndrimi në këmbë. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], thoshte në ruku:

“O Zoti im, Ty të përulem; Ty të besoj; Ty ta dorëzoj veten time; Ty të mbështetem. Ti je Zoti im. Shikimi, dëgjimi, mishi, gjaku, truri, eshtrat, nervat dhe hapi im, i nënshtrohen Zotit; Zotit të të gjitha botëve. I tërë lavdi i takon të Gjithëmëshirshmit, Supremtit. Lartësuar qoftë Zoti i Melekëve dhe i Shpirtit.”

Nga fundi i jetës së tij, shpesh thoshte në ruku dhe sexhde: *“I tërë lavdi të takon Ty, o Zoti im. Më fal o Zot.”*

Aishja [radijallahu anha] një ditë e pyeti se pse e bëri këtë. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ia ktheu: *“Zoti im më tha se do ta shoh një sinjal të qartë në Umetin tim, dhe kur e pashë atë, thashë: “I tërë falënderimi i takon Allahut. Atij i kërkoj falje dhe tek Ai kthehem i penduar.” E kam parë këtë: “**Kur erdhi ndihma e Allahut dhe çlirimi (ngadhënjimi). Dhe i pe njerëzit që po hyjnë turma-turma në fenë***

e Allahut. Ti, pra, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin.” (En-Nasr: 1-3) Ky ishte një sinjal që jetës së tij po i vinte fundi.

Sexhdeja e tij ishte po aq e gjatë sa edhe rukja. Në sexhde i thoshte të gjitha llojet e lutjeve. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], një ditë tha: “Njeriu më së afërti Zotit të tij është në sexhde, andaj, lutuni sa më shumë në sexhde.”

Në sexhde thoshte:

“Zoti im, Ty të bëj sexhde; Ty të besoj; Ty të dorëzohem. Fytyra ime i përkulet Atij që e ka krijuar atë, duke i dhënë asaj pamje të plotë, me shikim dhe dëgjim. Lartësuar qoftë Allahu, Krijuesi më i mirë. O Zot, m’i fal të gjitha gjynahet: të mëdhatë dhe të voglat, të mëhershmet dhe të tanishmet, të fshehtat dhe të dukshmet. Zoti im, të lutem të jesh i kënaqur me mua dhe jo i pakënaqur, të më falësh e jo të më dënosh. Kërkoj sttrehim tek Ti nga dënimi Yt. Nuk mund të të falënderoj sa duhet; të të lartësoj ashtu siç Ti e lartëson Veten. Lavdëruar qoftë Zoti i Melekëve dhe i Shpirtit.”

Ç’njeri fisnik ishte Pejgamberi Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]! Ai i drejtohej Zotit të tij në qetësinë e thellë të natës, duke e lavdëruar

dhe duke u përulur para Tij. Deri në ç'horizont sublim shpirti i Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mallëngjehej dhe ngrihej derisa i thoshte këto glorifikime, duke ia përkushtuar veten tërësisht Atij. Mund ta imagjinojmë se të gjitha malet në tokë po e dëgjonin dhe yjet në qiell po e shikonin. Pastaj, këto të fundit mund të pëshpëritnin ndërmjet vete se ky ishte njeriu që u përshkrua në Librin e Zotit: *"Po ti përmende Zotin tënd dhe plotësisht përkushtoj Atij!"* (El-Muzemil: 8)

Pejgamberi Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] vazhdonte ta kalojë natën në këndim të Kur'anit me përkushtim, duke i thënë me pasion dhe duke i përsëritur madhërimet ndaj Zotit të Lartësuar në pjesën e tretë të natës. Kështu e përfundonte namazin e natës dhe i ngelte vetëm vitri⁴⁴ pa falur. Më pas e zgjonte bashkëshorten e tij, ashtu që edhe ajo ta falte vitrin me të. I falte tri rekate vitër, duke e kënduar suren 87 në rekatën e

⁴⁴ Namazi i vitrit është sunet i fortë. Duhet të jetë namazi i fundit që falet natën. Ai mund të falet menjëherë pas namazit të jacisë ose të lihet deri më vonë, nëse besimtari fal namaz nate. Ai përbëhet zakonisht nga tri rekate, por mund të falet edhe vetëm një, veçanërisht në raste udhëtimi. Nga të gjitha namazet sunet, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] asnjëherë nuk i linte dy rekate para farzit të sabahut dhe vitrin pas jacisë.

parë, suren 109 në të dytin dhe suren 112 në rekatën e tretë. Në fund të namazit vitër, thoshte:

“O Zot, të lus të më dhurosh kënaqësi, në vend të pakënaqësisë; falje, në vend të dënimit. Kërkoj falje të Ti nga dënimi Yt. Nuk mund t’i numëroj begatitë Tua, dhe as që mund të të falënderoj sa duhet, të të lartësoj ashtu siç Ti e lartëson Veten. Lartësuar qoftë Zoti i Melekëve dhe i Shpirtit.”

Pasi e pëfundonte vitrin, thoshte: *“I tërë falënderimi i takon Mbretit.”* Këtë e përsëriste tri herë, duke e bërë të tretën më të gjatë.

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], falej natën në dhomën e tij, e cila nuk posedonte asgjë komode të një jete të lehtë. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], falej në një sexhade prej kashte ose nuk bënte sexhde diku tjetër, pos në dyshekun e bashkëshortes së tij. Falej dhe ajo ndodhte të flinte gjumë para tij. Nuk kishte drita në shtëpi në atë kohë. Kur falej, e prekte bashkëshorten dhe ia shtynte këmbën. Kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ngrihej, ajo e shtrinte këmbën përsëri.

Në raste të rralla, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shkonte në xhami për ta falur

namazin e natës. Ndoshta e bënte këtë për diçka që ka mundur të ndodhte. Mendoj se është frikësuar në mos e zgjon bashkëshorten e tij, nëse ajo ndodhej në gjumë. Aishja [radijallahu anha] transmeton: “Një natë, pashë që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk ndodhej në shtrat dhe dola ta kërkoja. Dora ime preku shputat e tij në xhami.⁴⁵ Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], po thoshte: *“Zoti im, kërkoj kënaqësinë Tënde dhe jo moskënaqësinë Tënde, faljen Tënde dhe jo dënimin Tënd. Kërkoj strehim tek Ti nga dënimi Yt, nuk mund të të lavdëroj ashtu siç Ti e lavdëron Vetën.”*

Ajo gjithashtu tregon: “Një natë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nuk ndodhej në shtrat dhe mendova se kishte shkuar te ndonjëra prej bashkëshorteve të tij. E kërkoja gjithandej dhe më pas u ktheva në shtëpi. E gjeta në ruku ose në sexhde, dhe po thoshte: *“I tërë falënderimi të takon Ty, o Zoti im. Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Teje.”* Mendova me vete: “Sa fisnik që je, o i Dërguari i Allahut! Ti je i angazhuar me diçka, ndërsa unë me diçka krejtësisht tjetër!”

⁴⁵ Kjo nënkupton se ai ndodhej në sexhde.

Ecja në thellësinë e natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shpesh dilte jashtë shtëpisë kah fundi i natës, kohë kjo më e mira për adhurim nate, dhe shkonte te shtëpia e bijës së tij Fatimes dhe bashkëshortit të saj Aliut [radijallahu anhu]. I thirrte shpesh: *“A nuk do të zgjoheni për t’u falur?”*

Aliu [radijallahu anhu] një ditë i tha të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: *“O i Dërguari i Allahut, ne falim vetëm atë që është bërë obligim mbi ne. Shpirtrat tanë janë në Dorën e Allahut. Nëse Ai dëshiron të na zgjojë, këtë e bën Vetë.”*

Aliu [radijallahu anhu] rrëfen se i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pas këtyre fjalëve, doli që aty dhe nuk foli më. Derisa u largua, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] i godiste kofshët dhe thoshte: *“Në këtë Kur'an Ne shtruam çdo lloji shembulli për hir të njerëzve, po njeriu (jobesimtar), më shumë se çdo tjetër është kundërshtar.”* (El-Kehf: 54)

Kah fundi i jetës së tij, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shkante te varrezat *el-Bekije* gjatë natës dhe lutej për të vdekurit. Rasti i parë, ishte ai i transmetuar nga Aishja [radijallahu anha]:

“Në natën që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e kishte radhën të qëndronte me mua, e veshi mantelin, i zbathi këpucët dhe i vendosi afër këmbëve. E vendosi cepin e petkut të poshtëm në shtrat dhe u shtri. Qëndroi ashtu vetëm derisa mendoi se mua më kishte kapluar gjumi. Më pas, e mori mantelin, qetë, i mbathi këpucët, e hapi derën dhe doli jashtë, pa bërë zhurmë fare. Unë menjëherë u vasha, e vendosa mbulesën dhe iu qepa nga pas. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vajti në *el-Bekije*, ku qëndroi për një kohë të gjatë, pastaj i ngriti duart kah qielli tri herë. Më pas u kthye dhe u ktheva edhe unë; eca sa më shpejt që munda, fillova edhe të vrapoja; dhe më pas ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e rriti shpejtësinë, dhe edhe unë e bëra të njëjtën gjë. Unë isha më e shpejtë se ai. Mezi hyra në shtrat. Kur hyri ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], brenda, më tha: “Çfarë ndodhi me ty, o Aishe? Dukesh e lodhur.” I thashë se s’kisha gjë. Më tha: “Do të më tregosh vetë apo do të

më tregojë Allahu, i Cili i di të gjitha?" I thashë: "O i Dërguari i Allahut, ti je më i dashur tek unë se kushdo tjetër." Pastaj i tregova gjithçka. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më tha: "A ishe ti ajo me të zeza që po vrapoje para meje?" "Po!" - i thashë. Më goditi pak në gjoks dhe më tha: "A mendove se Allahu dhe i Dërguari i Tij mund të jenë të padrejtë ndaj teje?" "Çfarëdo që fshehin njerëzit, do të mësohet nga Allahu." - shtoi ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. "Po!" - i thashë. Ma ktheu: "Xhibrili më erdhi kur ti më pe se çfarë bëra dhe më thirri, duke e fshehur këtë nga ti. Ai nuk hyri në dhomën tënde kur ti i kishe zhveshur rrobat. Mendova se kishe fjetur dhe nuk dëshirova të të zgjoj, duke menduar se mund të ndjehesh e vetmuar (pasi të kem dalë unë). Ai ma përçoi urdhrin e Zotit që të shkoj në Bekije dhe të lutem për të vdekurit."

Aishja [radijallahu anha] vazhdon: "E pyeta si t'u adresohemi atyre në varreza. Më porositi të themi: "Paqja qoftë mbi ju, o banorë të këtij vendi, muslimanë dhe besimtarë. Allahu i mëshiroftë ata që kanë shkuar dhe ata që do të shkojnë më vonë. Edhe ne, me lejen e Allahut, do t'u bashkohemi juve."

Kështu, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dilte shpesh te varrezat el-Bekije dhe lutej: "Paqja

qoftë mbi ju, në një vend të besimtarëve. Keni takuar atë që u është premtuar. Ju jeni duke e pritur të nesërmen. Edhe ne do t'u bashkohemi, me lejen e Allahut. Zoti im, fali banorët në Bekije el-Garkad."

Sa për t'u admiruar që ishte i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kur doli nga shtëpia, qetë, në thellësinë e natës, dhe qëndroi pranë varrezave të shokëve të tij, të cilët kishin vdekur pa e parë fitoren e madhe të Islamit, kohën kur njerëzit kishin filluar ta përqaфонin fenë e Allahut turma-turma. Ata kishin shkuar te Zoti i tyre kur Umeti islam ishte ende i vogël numerikisht, duke kaluar përmes vështirësive dhe duke u përballur me masakra dhe persekutive nga armiqtë e ndryshëm. Ikën nga kjo botë, pa fituar ndonjë shpërblim në të.

Në atë kohë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] pranonte delegacion pas delegacioni nga e gjithë Arabia. Tani, as këto delegacione dhe as zgjerimi i territorit islam nuk e ndaloi nga të menduarit rreth atyre që tashmë kishin vdekur. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ia kushtoi një pjesë të kohës qëndrimit pranë varreve, duke i kujtuar fytyrat e tyre dhe duke i ngritur duart në lutje për ta.

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Në atë kohë, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte gati t'i jepte lamtumirën e fundit jetës së kësaj bote. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], po ua jepte lamtumirën, si të vdekurve, ashtu edhe të gjallëve, pasi ishte gati të shkonte te Allahu i Lartësuar.

Një sy gjumë para agimit me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Kur orët e natës të kishin kaluar dhe të kishte ngelur vetëm pjesa e fundit e saj, saktësisht rreth 1/6 e saj, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] shkante përsëri në shtrat, që të pushonte pas një adhurimi të gjatë plot lutje, madhërime ndaj Zotit, kujdesje ndaj të afërmëve dhe shokëve. Flinte vetëm një sy gjumë, ashtu që të përgatitej për namazin e sabahut dhe punët ditore. Kështu, ora para agimit kalohej në gjumë nga Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Aishja [radijallahu anha], nëna e besimtarëve, thotë: “Sa herë që i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte me mua natën, flinte para agimit.”

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kënaqej me këtë kotje, derisa drita e agimit nuk çante errësirën e natës, kur Bilali [radijallahu anhu] e thirrte ezanin për namazin e sabahut, duke e thyer kështu qetësinë e Medinës.

Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] zgjohej nga ezani, për ta filluar ditën e re pastaj; ditë kjo e bekuar me frymën peygamberike, e ndriçuar nga drita e mesazhit islam.

Përmbledhje e shëtitjes njëditore me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Dita e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] paraqet një seksion të jetës së tij të gjerë.

1. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e shihte ditën e tij brenda një kornizeje kohe për t'i përmbushur synimet që kishte. Historia njerëzore asnjëherë nuk ka dëshmuar për ndonjë njeri që do t'i afrohej arritjeve të Pejgamberit të Allahut, Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

2. Gjëja e parë që e kap vëmendjen tonë në jetën ditore të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], është qartësia e saj superiore e cila shkëlqen gjatë gjithë kohës. Nuk kishte kënde të errëta e as mungesë zinxhiri në jetën e tij. Çdo gjë ishte e qartë dhe transparente. E dimë se çfarë bënte në shtëpi, çfarë bënte kur i mbyllte dyert, si shtrihej në shtrat; e dëgjojmë frymëmarrjen e tij kur flinte dhe gjënë e parë që e thoshte kur zgjohej nga gjumi.

Pasi e studiova programin njëditor të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], mendoj se di rreth tij më shumë sesa që di rreth babait tim. Jeta e tij shkëlqente; ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte një rol model, këmba e të cilit hidhte hapin nën qiellin e kësaj bote.

3. Në ditët e tij, e shohim praktikisht kuptimin e thënies së tij: *“Namazi është molla e syrit tim.”* Namazi, obligativ a vullnetar, ose adhurimi gjatë natës, ishte qartë i dukshëm gjatë ditës së tij. Ai (namazi) i jepte komoditet psikologjik ditës së tij. Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dukej sikur po pranonte fuqi dhe begati shtesë nga Allahu Fuqiplotë derisa falte namaz. Si rrjedhojë, pas çdo namazi, fuqia e tij ripërtërihej dhe zmadhohej dukshëm. Namazi ishte burim i fuqisë dhe rehatisë për të. Ai i thoshte Bilalit [radijallahu anhu], derisa shprehte dashuri ndaj namazit: *“O Bilal, na qetëso me namaz.”* Mbase qartë dhe në mënyrë të duhur shprehej se shpirtërisht kishte mall për të, duke iu drejtuar Bilalit [radijallahu anhu] me fjalët: *“Na qetëso.”* Kjo tregon rehatinë mes tij dhe Krijuesit.

Ibn Kajimi përmend se numri i përgjithshëm i rekateve që i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i falte gjatë ditës dhe natës ishte 40, të cilin tempo ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e mbante rregullisht. Nga to, 17 ishin obligative, 10 ose 12 sunet të rregullt dhe 11 ose 13 namaz nate. Diçka shtesë nuk kishte të rregullt. Këtu mund të hynte namazi i paraditës (duha) ose namazi përshëndetës i xhamisë. Muslimani duhet të bëjë çmos që ta mbajë një ritëm të ngjashëm ose të përafërt përgjatë jetës. Imagjinojeni të trokitni 40 herë gjatë ditës dhe natës në një derë: Vallë, a s' do të gjenit një përgjigje të shpejtë apo një hapje të shpejtë të derës?

4. Adhurimi i tij gjatë natës ishte aq magjepsës, sa që ia ofronte kënaqësinë më të madhe të adresimit ndaj Zotit. Adhurimi ishte një rast i shkëlqyeshëm i përvojës shpirtërore.

5. Nuk duhet të mjaftohemi dhe të ngelim skajshmërisht të habitur dhe të befasuar se si i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili ishte i sigurt se Allahu i Lartësuar ia kishte falur të gjitha gjynahet, të kaluarat dhe të tashmet, gjithmonë i lutej Allahut të Madhërishëm për falje

gjynahesh. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e fillonte ditën duke kërkuar falje nga Allahu 100 herë në ditë. Në një tubim, shokët e tij numëruan se ai kishte thënë 100 herë: *“O Zot, më fal dhe ma prano pendimin; Ti je Ai i Cili pranon pendimin dhe i fal të gjithë.”*

Në adhurimin e natës, ai përsëri kërkonte falje: *“Zoti im, m’i fal ato që i kam bërë në të kaluarën dhe ato që mund t’i bëj në të ardhmen; ato që i kam bërë fshehtas dhe haptas, dhe Ti e di më mirë se unë. Ti je Ai i Cili jep sukses dhe mossakses. Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Teje. Asnjë forcë nuk operon përveçse me lejen Tënde.”*

Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], lutej aq shumë për falje, edhe pse ishte i sigurt se Allahu i Lartësuar ia kishte falur të gjitha gjynahet, të kaluarat dhe të ardhmet. Ç’të themi ne për veten tonë, kur mezi ikim nga një gjynah i qëllimshëm apo i paqëllimshëm? O Zoti ynë, na fal!

6. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] gjithmonë e përmendte Allahun dhe e madhëronte Atë. Ju e dini se dashuria ndaj Zotit dhe aspirata për të qenë me Të ishte në qendër të jetës së tij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai dukej sikur po

e shihte madhështinë e Zotit, prandaj asnjëherë nuk ndalej së madhëruari Atë. Gjëja e parë që e thoshte kur zgjohej nga gjumi, ishte lutja ndaj Zotit. I fillonte dhikret e mëngjesit dhe mbrëmjes duke e lavdëruar Allahun e Lartësuar dhe gjithmonë i përsëriste ato. Ishte i vëmendshëm ndaj dashurisë së Zotit, shërbimit ndaj Tij dhe njohjes së Atributeve të Tij të mëdha.

7. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], gjithmonë i falte namazet obligative në kohë, përveç jacisë, të cilën e shtynte.

8. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kryesisht iu adresojte shokëve të tij pas namazeve obligative. Zakonisht këtë e bënte pas sabahut dhe drekës, ngase njerëzit ishin të freskët dhe vigjilentë në këto kohëra. Këto dy namaze parapriheshin nga gjumi i natës dhe kotja ditore. Rrallëherë u mbante ligjëratat pas ikindisë dhe jacisë, ngase njerëzit zakonisht ishin të lodhur në këto kohëra dhe kishin nevojë për pushim. Nuk është transmetuar që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], t'u jetë drejtuar atyre pas namazit të akshamit, ngase njerëzit në atë kohë kishin nevojë të darkonin. Prandaj, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-

lem], e falte akshamin në fillim të kohës, duke mos e zgjatur shumë dhe nuk iu drejtohej shokëve të tij.

9. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] mbante një ekuilibër të duhur në të gjitha aktivitetet: në përmbushjen e detyrave, në përmbushjen e kërkesave jetësore, në adhurime, në bartjen e mesazhit të Allahut, në kujdesin ndaj familjes, në kujdesin ndaj shokëve të tij, në kujdesin ndaj vetvetes dhe në kryerjen e të gjitha detyrave tjera në kohë. Të gjitha këto i bënte në një mënyrë të ekuilibruar. Nuk gjeni në jetën e tij ndonjë shpërfillje të obligimeve ose dështim në atë që ishte e drejtë. Por e gjeni një vëmendje mirë të ekuilibruar ndaj të gjitha obligimeve private dhe publike. Në jetën e tij, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e zbatonte atë që i nxiste të tjerët ta bëjnë: *“Trupi juaj ka hak mbi ju; fqinji ka hak; fëmijët kanë hak; dhe ju dhe shoku juaj keni hak.”* Në jetën e tij, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte një model i dhënies së të drejtave secilit.

10. Jeta e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte përplot me aktivitete, por asnjëherë e tensionuar dhe konfuze. Ai, [sal-lallahu alejhi ve

sel-lem], ishte gjithmonë i qetë dhe i relaksuar. Tensioni në jetën e tij ishte i paktë ose jo-ekzistent. Sikur ta shihnit duke bërë diçka, do të mendonit se ai nuk kishte bërë asgjë para saj dhe asgjë pas saj. Mënyra se si qëndronte në shtëpi, nuk linte të kuptohej se barrat e rënda po e prisnin jashtë. Po ta shihnit me shokët e tij, nuk do ta vërenit se ishte i shqetësuar për ndonjë gjë. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], sillej dhe fliste me ta i relaksuar. Sjelljet e tij të rafinuara ndjeheshin nga të gjithë. Ishte sikur të mos kishte punë tjetër, pos t'i takonte shokët e tij dhe t'i përmbushte nevojat e tyre. Gjendja e tij ishte e ekuilibruar përsosmërisht saherë që i qasej të gjitha detyrave me lehtësi dhe komoditet.

11. Jeta e tij ishte në binarë të duhur dhe jo monotone. Kishte mjaft fleksibilitet sa t'i ndjek rrethanat ndryshuese. Kaosi dhe konfuzioni ishin të panjohura në jetën e tij; njësoj ishin edhe ngurtësia dhe lodhja. Kombinimi i rregullit dhe fleksibilitetit ndihmohej nga namazet obligative. Takimet e tij me shokë ndodhte të ishin të shkurt-ra dhe të gjata, varësisht nga situata. Kështu, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte në gjendje të

ketë dobi nga pozitiviteti i organizimit dhe ta heq qafësh negativitetin e monotonisë dhe ngurtësisë.

12. Nuk mund që mos ta vërejmë spontanitetin dhe thjeshtësinë në jetën e të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Serioziteti i ndikuar dhe ngurtësia ishin të huaja për të, përderisa spontaniteti ishte natyra e tij. E ndante me shokët atë që ishte e mirë dhe gjithnjë ishte i etur ta shfaq kënaqësinë e tij me çfarëdo që i jepte kënaqësi. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], nxitonte ta takonte atë që e donte, e të cilin s'ë kishte parë kahmoti, si pasojë e mungesës së tij të gjatë; derisa ngutej, manteli i binte nga supet. Ndodhte që derisa ecte rrugës, të shkonte t'i fliste një të riu i cili e rripte një dele. I përvilte mangët për t'i treguar si ta rrjepë delen në mënyrën e duhur. Ndodhte të kalonte pranë dikujt i cili po përgatiste mish dhe ta pyeste nëse ushqimi ishte përgatitur ose jo. Mandej e hante një kafshatë mish.

Një spontanitet i tillë në marrëdhëniet me njerëzit, i largonte të gjitha barrierat. Kështu, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte në gjendje të ketë marrëdhënie të afërta me shokët e tij. Ata e

mendonin veten e tyre si fëmijët që e shikojnë babanë e tyre.

13. Kënaqësia dhe dëfrimi ishin prezente në shtëpinë, tubimet dhe në jetën e tij në përgjithësi. Në shtëpi, gjithmonë ishte i buzëqeshur dhe buza gaz. Në tubime, gjithmonë kishte hapësirë për shaka të lehta dhe biseda të këndshme. Një ditë, doli nga shtëpia që t'i shikojë abisinasit duke bërë vallëzim popullor në xhami. U kënaq dhe e thirri edhe bashkëshorten e tij që ta shikojë këtë ngjarje. E ngriti këtë parim duke thënë rreth abisinasve: *"Vazhdoni me shfaqjen tuaj, o Benu Arfide, ashtu që çifutët dhe të krishterët ta ndiejnë se feja jonë i akomodon të gjithë. Më është dhënë një mesazh i pastër dhe i butë."*

Besimi i tij ishte pa dyshim i butë dhe jeta e tij i lejonte mjaft hapësirë për kënaqësi dhe argëtim.

14. Gjithashtu, vërejmë se jeta e tij familjare karakterizohej me emocione të forta. Kjo manifestohej në vepra të thjeshta, si: duke u ofruar ujë, duke vënë një kafshatë ushqimi në gojën e bashkëshortes së tij, nga bisedat dashurore gjatë

natës, nga vizitat gjatë ditës, nga përmbushjet e nevojave familjare dhe kontaktit intim në shtrat.

15. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tregonte mirëkuptim të madh rreth natyrës së njerëzve, nevojave familjare dhe punëve. Kjo madje refleктоhej edhe në adhurimin e tij. Kur udhëhiqte namazin me xhemat, namazi i tij ishte i shkurtër, por kur falej i vetëm, namazi i tij ishte më i gjati. Ndodhte ta fillonte namazin me xhemat duke synuar ta zgjasë atë, por pastaj dëgjonte ndonjë fëmijë duke qarë dhe e shkurtonte atë, në shenjë dhembshurie ndaj nënës së fëmijës e cila mund të ndjehej në siklet.

16. Kur studiojmë se si i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e kalonte ditën, kuptojmë se adhurimi më i shquar i tij, në të cilin angazhohej tërësisht, ishte ai që e bënte vetë, në vetminë e shtëpisë së tij, në thellësinë e natës. E praktikonte këtë adhurim nate gjatë gjithë jetës.

Kjo, në fakt, është një ndër dëshmitë e profetësisë së tij. Një përkushtim i tillë i vazhdueshëm, të cilin i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e praktikoi gjatë jetës, kurrë nuk ka mundur

të bëhet nga një mashtrues. Ajo është dëshmi e besimit të thellë dhe të Vërtetës që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e predikonte.

17. Mund t'i identifikojmë tri periudha të aktivitetit të tij:

a) Periudha e freskisë së qetë dhe vitalitetit në thellësinë e natës. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e falte namazin e natës pas periudhës së gjatë të gjumit që e bënte në 24 orët ditore. Kjo periudhë e fjetjes bëhej gjatë pjesës së parë të natës. Duhej ta siguronte freskinë e tij për këtë aktivitet, sepse për të, namazi ishte qetësia dhe rehatia e syrit të tij.

b) Pas namazit të sabahut. Kjo ishte periudha që pasohej me një kotje në agim. E falte farzin e sabahut, e falënderonte Allahun, e madheronte Atë dhe ulej me shokët e tij, duke i udhëzuar dhe këshilluar ata.

c) Pas namazit të drekës. Përsëri kjo ndodhte pas kotjes në mes të paraditës. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e falte drekën dhe iu adresojte shokëve rreth çdo gjëje që mund të ndodhte, ose thjesht ulej me ta për t'ua dëgjuar hallet.

18. Namazet e tij ditore faleshin në kohë. Dita ndahej në njësi kohore të ndara nga këto namaze. Mund ta identifikojmë programin vijues të ditës në jetën e të Dërguarit të Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]:

a) Sabahu. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] zgjohej pas kotjes së agimit, e falte namazin e sabahut, pastaj ulej me shokët e tij në xhami deri sa lindte dielli. Pastaj i vizitonte bashkëshortet e tij. Pas kësaj, d.m.th., herët në mëngjes, ulej në xhami me shokët e tij në një sesion udhëzimi dhe edukimi. Nganjëherë i bënte disa vizita pas këtij sesi. Ndodhte t'i vizitonte bijat e tij ose ndonjë nga shokët, ose mbase i kryente disa punë të tjera. Në gjysmën e paraditës, ishte koha për kotje. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kotej para namazit të drekës, ashtu që të pushojë dhe të bëjë gati për aktivitetin e natës.

b) Dreka. Zgjohej për namaz dhe e falte me xhemat. Nëse diç ndodhte, iu drejtohej shokëve pas namazit. Shumica e predikimeve të tij bëheshin në këtë kohë. Pastaj kthehej në shtëpi për t'i falur sunetet e rregullta. Mandej dilte dhe takohej me shokët e tij. E nganjëherë, kryente ndonjë punë ditore. Koha mes drekës e ikindisë ishte kohë pune dhe e kryerjes së nevojave.

c) Ikindia. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e falte ikindinë herët; pastaj i vizitonte bashkëshortet. Që të gjitha ndodhte të mbledheshin në shtëpinë e asaj tek e cila ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e kishte radhën për të ndenjurr atë natë. Qartazi, koha mes ikindisë dhe akshamit ishte shumicën e kohës pushim me familjarët.

d) Akshami. I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e falte herët akshamin, e më pas darkonte. Kjo ishte koha kur e hante ushqimin kryesor të ditës.

e) Jacia. E falte namazin e jaxisë me xhemat para se të kthehej në shtëpi. Ulej për ca kohë me familjen ose e vizitonte ndonjë shok ensarij, ose kalonte kohë me Ebu Bekrin dhe Omerin [radijallahu anhum] në shtëpinë e Ebu Bekrit [radijallahu anhu], duke diskutuar mbi çështjet e shtetit dhe Umetit. Pas vizitave të tilla, kthehej në shtëpi dhe flinte deri në mesnatë. Pastaj zgjohej për të falur namaz nate. Në këtë kohë, ishte freskia pas një periudhe të gjatë të kaluar në gjumë. E kalonte përafërsisht 1/3 natës në namaz dhe lutje. Kur ngelte vetëm 1/6 e natës, shkonte në shtrat për të pushuar. Ky ishte gjumi i agimit, i cili zgjaste derisa arrinte koha e namazit të sabahut.

19. Ngjarjet e jetës së tij ditore ishin thjesht një skenë tjetër që e konfirmonin faktin se ai ishte i Dërguar i Allahut. Askush nuk mund ta shikonte atë e të mos e kuptonte se ai ishte i Dërguari i Allahut, i cili e pranonte Shpalljen nga lartë. Kushdo që e vrojtonte, vinte në përfundim se ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], as nuk bënte ndonjë pretendim të rremë dhe as nuk kërkonte përfitime personale. Thumame ibn Uthali u zu rob dhe u soll në Medine nga muslimanët. Për të, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte njeriu më i urryer mbi sipërfaqen e tokës. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], urdhëroi që ai të lidhej në njërën nga shtyllat e xhamisë. Kur Thumame pa se çfarë po bënte i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ditën dhe natën, e pa atë të dilte dhe hynte, dhe mënyrën se si ai i trajtonte njerëzit përreth tij, e kuptoi se Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk ishte as mbret dhe as diktator; erdhi në përfundim se Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte i Dërguar i Allahut. Pas disa ditëve, i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] urdhëroi lirimin e tij; e la të lirë të bënte ç'të dëshironte. Thumame thjesht u largua, u pastrua dhe u kthye përsëri. U ul para të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe tha:

“Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij. Pasha Allahun, o Muhamed, nuk kishte fytyrë mbi këtë tokë të cilën e urreja më tepër se fytyrën tënde. Tani fytyra jote është më e dashura për mua. Nuk kishte fe të cilën e urreja më tepër se fenë tënde. Tani feja jote është më e dashura për mua. Nuk kishte qytet që e urreja më tepër se qytetin tënd. Tani ai është qyteti që më së shumti e dua.”

I ngjashëm ishte edhe përfundimi i ardhjes së Adij bin Hatimit, i cili ishte udhëheqës i fisit të tij dhe ishte i krishterë. Derisa po ecte me të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], një grua që me vete e kishte një fëmijë e thirri atë, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Adiji tha: “Ata folën me të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] privatisht derisa ai po qëndronte me ta. Vazhduan për një kohë të gjatë, derisa unë vazhdova drejt tij. Mendova me vete: “Jam i sigurt se ti nuk je pasues i fesë time ose fesë së Nu’man ibn Mundhirit. Po të ishe mbret, asnjë djalë dhe grua nuk do të mund të të ndalte. Ndjeva se zemra ime po anonte nga ai.” Adiji pas pak kohësh e pranoi Islamin.

20. Programi i tij ditor tregon se i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], jetonte një jetë shumë të lumtur dhe të bekuar.

Lumturia që ai e nxirrte nga besimi, ishte e një standardi shumë të lartë, të cilën jo çdo njeri e arrinte. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte njeriu që e njihte Zotin më së miri dhe e besonte Atë si askush tjetër.

Në udhëtimin e tij në Isra dhe Miraxh, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u ngrit mbi shtatë qiej, deri në një nivel ku mund t'i dëgjonte lapsat e Caktimit derisa shkruanin çfarëdo që urdhëronte Allahu Fuqiptotë. Ai e pa Xhenetin me sytë e tij dhe dëshiroi të merrte ca prej frutave të tij. Gjithashtu, e pa Keutherin, një lumë në Xhenet. Zbuloi se balta e tij ishte misk i pastër dhe guralecët e tij ishin margaritarë.

A mund ta imagjinoni se çfarë ndjenja duhet të ketë pasur një Pejgamber i tillë, kur u ngrit në një status të këtillë të lartë, dhe sesi iu lut Zotit të tij, si e lartësoi dhe madhëroi Atë? Është ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i cili ka thënë: *“Unë rri me Zotin tim, i Cili më ushqen dhe më jep të pijë.”* Nuk është e mundur të krahasohet kënaqësia e tij

kur falej ose ëmbëlsia e besimit që ndjente, ndaj cilësdo kënaqësi ose ndjenje të lumturisë në botën tonë.

Dhe përsëri, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte i lumtur me jetën e tij në këtë botë. E shohim këtë lumturi në të gjitha aspektet e jetës së tij. E shohim vlerësimin e kësaj lumturie dhe mirënjohjen e shquar të tij ndaj Allahut të Lartësuar. Ishte Allahu i Madhërishëm, Ai i Cili e kurseu atë nga pikëllimi dhe shqetësimi, dhe e mbrojti nga sëmundja e tmerrshme. Prandaj, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], jetonte me shëndet të mirë fizik dhe mendor, duke u kënaqur me një jetë të mirë familjare. Jeta e tij karakterizohej me mirëqenie totale dhe të përhershme. Kishte bashkëshorte të mira dhe dashuri reciproke. I ndante me to ndjenjat më të pastra të dashurisë dhe dhimbjes. E kishte një vajzë të çiltër dhe dy djemtë e saj, të cilët ishin begatia më e madhe në jetën e kësaj bote. Atyre ua përkushtoi ndjenjat më të ëmbla prindërore. I kishte shokët më të devotshëm, Ebu Bekrin dhe Omerin [radijallahu anhum]. Me ta i ndante të gjitha barrat e jetës. Shpesh thoshte: *“Shkoja tek Ebu Bekri dhe Omeri, ecja me ta dhe shëtisja me ta.”* E kishte një dhëndër, i cili ishte një

i afërm dhe jetonte afër tij. E donte fort Ali ibn Ebi Talibin [radijallahu anhu] dhe e dinte se edhe Allahu e donte atë. Kishte edhe dhëndurë të tjerë, të cilët ishin besnik ndaj tij. Ishin të vërtetë në atë që e thonin. Ata ishin Othman ibn Afani dhe Ebu el-As ibn el-Rebi [radijallahu anhum]. Kishte shokë të besueshëm. Shpalljet hyjnore e përgëzonin besimin e tyre dhe atë që ata ndjenin në zemër. *“Vërtet, Allahu që i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre, andaj u dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Hajberit).”* (El-Fet’h: 18)

Prandaj, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ishte më i lumturi me ata që ishin me të dhe rreth tij.

Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e jetonte një jetë në të cilën arritjet pasonin njëra-tjetrën me një tempo të shpejtë. Lumturia më e madhe në jetë është ajo që gjenerohet nga arritjet. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e përmbushi qëllimin e tij në jetë, që ishte bartja dhe dorëzimi i Mesazhit të Allahut të Lartësuar, dhe pa njerëzit ta pranonin besimin hyjnor në grupe të mëdha.

Nuk mund ta imagjinoj lumturinë që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndjeu derisa e shihte xhematin duke u rritur në xhaminë e tij, derisa e pa Islamin duke u përhapur gjithandej dhe njerëzit në numër të madh duke e deklaruar pranimin e Islamit. Me të vërtetë, nuk mund t'i përshkruaj ndjenjat e mia derisa përpiqem t'i imagjinoj ndjenjat e tij në Haxhin Lamtumirës, kur ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i pa turmat që vinin nga e gjithë Arabia duke deklaruar njëzëri: "Dëshmojmë se e ke përçuar mesazhin e Allahut, na ke këshilluar mirë dhe e ke përm-bushur detyrën tënde."

E gjithë kjo ishte thjesht begati e Allahut Fuqiplotë dhënë atij. Është Ai i Cili ka thënë: "*E Zoti yt do të jep ty, e ti do të kënaqesh.*" (Ed-Duha: 5)

21. Në jetën e tij gjejmë vlerësimin e kënaqësive të jetës, kënaqësisë së bukurive dhe mirënjohjes ndaj Zotit për mirësitë e dhëna. Pas një pije që e shijonte ose një kafshate që e hante, shprehte mirënjohje ndaj Allahut të Lartësuar, duke thënë: "*Lavdëruar qoftë Allahu. Falënderimi i qoftë Allahut, i Cili na ka dhënë me bollëk ushqim dhe pije. Zoti ynë nuk mund të lavdërohet siç e meriton. Ne as nuk*

largohemi nga Ai dhe as nuk e mohojmë nevojën tonë për Të. Zoti ynë, Ti je Ai i Cili na ke dhënë ushqim dhe pije, pasuri dhe udhëzim. Ty të takon falënderimi për gjithçka që na ke dhënë.”

Kur zgjohej nga gjumi, e falënderonte Allahun për gjumin e mirë. Zgjohej përplot me energji dhe e falënderonte Allahun e Lartësuar për këtë. Menjëherë thoshte: *“I tërë falënderimi i takon Allahut, i Cili na ngjalli pasi na bëri të vdekur. Tek Ai do të kthehemi.”*

Nëse kjo është ajo çfarë ai thotë dhe ndjen pas ushqimit dhe gjumit të zakonshëm, kënaqësia e së cilës bëhet shumë e rëndomtë përmes familjarizimit, mund të imagjinojmë se çfarë ndjeu ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], me posedimin e begative të ripërtërira. E kuptojmë se ai ndalej pas çdo begatie dhe mirësie, në mënyrë që ta vlerësonte atë dhe t'i shprehte mirënjohje Zotit, duke iu adresuar Zotit të Tij me fjalët: *“I gjithë falënderimi i takon Allahut, i Cili më ka begatuar me mirësinë e Tij dhe më ka dhënë furnizim të bollshëm. Lavdëruar goftë Allahu në të gjitha situatat.”*

I Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] na e tërheqte vëmendjen në masë të madhe rreth asaj

që është e njohur për ne, e të cilën pothuajse nuk e dëgjojmë: sigurinë e natës, ushqimin e ditës dhe shëndetin e mirë. Ai thoshte: *“Kushdo që zgjohet i sigurt, i shëndoshë dhe ka ushqim vetëm sa për një ditë të vetme, e tërë bota është e tij.”* Sa neve mendojmë mbi këto mirësi?

Ndjenja e begative dhe mirësive nga Allahu i Lartësuar, e ngritë kënaqësinë dhe lumturinë. Kjo e bën jetën shumë më të lumtur dhe siguron kënaqësi dhe mirënjohje ndaj Dhuruesit. Prandaj, një begati i sjellë të tjerat dhe jeta bëhet më e lumtur, më shkëlqyese dhe shumë më produktive.

22. Le të mësojmë nga ky program ditor i jetës shumë të angazhuar të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe të meditojmë mbi ndërveprimin e tij gazmor me jetën. Pastaj, le ta kujtojmë pikëllimin e madh që i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e përjetoi në jetën e tij dhe ishte në gjendje ta kapërcente. Si fëmijë, ai përjetoi humbje të mëdha të njëpasnjëshme, duke i humbur të dy prindërit dhe gjyshin. Pasi iu dha mesazhi, iu ekspozua një fushatë të persekutimit; pastaj e humbi dashurinë e jetës, Hatixhen [radijallahu anha], bashkëshorten e parë. Gjatë

jetës së tij i vdiqën gjashtë fëmijë. U detyrua të shpërngulej nga vendlindja, që ishte qyteti më i dashur i tij. I humbi shumë nga të dashurit dhe shokët në Betejën e Uhudit. U godit shumë nga shpifja, ku akuzohej bashkëshortja e tij e dashur dhe e pafajshme për kurorëshkelje. U përball edhe me shumë ngjarje të tjera të dhimbshme.

Dhe përsëri, pavarësisht gjithë kësaj, kishte aftësi të mëdha për t'i kapërcyer të gjitha ndjenjat negative dhe kishte vitalitet të fortë për të vazhduar jetën, duke ndërvepruar pozitivisht, në çdo moment.

Kur shikojmë në pasurimin e çdo dite të jetës së tij, themi se jeta e tij ishte sjellje e një njeriu i cili kurrë nuk kishte përjetuar ndonjë vështirësi ose sprovë. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pa dyshim nuk ishte njeri i tillë, por ishte në gjendje ta kapërcente dhimbjen në të gjitha aspektet. Secili moment i jetës së tij kishte synimin dhe qëllimin. Pastaj, ai qëllim kishte kënaqësinë e vet. Andaj, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ishte në gjendje ta jetonte një jetë ripërtërirëse. E jetonte jetën siç duhet jetuar.

23. Vrasim mendjen rreth singeritetit të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], pranisë së theksuar në jetën e shokëve të tij dhe ndërveprimit energjik me ta. Pothuajse mund të themi se secili prej tyre kishte një tregim dhe ndërveprim të veçantë me të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i pranonte fëmijët e porsalindur të tyre, i merrte në prehër. Gjëja e parë që ata shijonin, ishin bekimet e tij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Shokët e tij mblidheshin te xhamia në shkëndijën e parë të dritës, kërkonin bekimin e tij. Vajzat dhe djemtë e vegjël e takonin në rrugë dhe ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ua fshinte fytyrat dhe u tregonte se sa shumë i donte. E spërkaste me ujë në fytyrë një djalosh të ri dhe e vishte një vajzë të vogël me një petk plot ngjyra-ngjyra; thjesht i shkëlqente jetët e secilit fëmijë. Kur ata e takonin, ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], i pranonte me buzëqeshje dhe duart e tyre e pranonin dorën e tij të bekuar me aromë të mrekullueshme. Shkonte në shtëpinë e tyre dhe e ndante ushqimin me ta. Kënaqej me kënaqjen e tyre dhe që të gjithë ishin të lumtur për prezencën e tij. E ftonin që të merrte pjesë në ngjarjet e tyre, kur donin të thernin një deve për ushqim. Shkonte tek ta, i vizitonte dhe i priste.

Vizitoi delegacionin abisinas derisa vallëzonin vallëzimin e tyre në xhaminë e tij dhe ua bëri të qartë kënaqësinë e tij, duke u thënë: *“Vazhdoni me lojën tuaj o Beni Arfide.”* I vizitonte të sëmurët. Kur të sëmurët zgjoheshin nga gjumi, e gjenin atë, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duke i shikuar ata dhe dorën e tij të freskët duke i fshirë djersët e tyre. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], shkonte te varrezat e të dashurve të tij. Qante nga pikëllimi për ta. I mungonin shumë. Ata ishin njoftuar se ai kishte pyetur për ta. Kështu, jeta e tij e arriti të tyren. Jeta e tyre ishte shkëlqyer me praninë dhe ndërveprimin e tij.

Edhe pse i Dërguari [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ndërroi jetë, ai ngeli i pranishëm në mendjen e tyre, i gjallë në zemrat e tyre dhe i shkëlqyer në sytë e tyre. Secili kishte kujtime të paharrueshme me të. Kur flisnin për të, ndjeheshin sikur po-thuajse po e shihnin. I dëgjoje të thonë:

“Pothuajse po e shoh bardhësinë e këmbëve të tij...”; *“Sikur tani po e shoh shkëlqimin e unazës së tij...”*; *“Pothuajse po e shoh madhështinë e parfumit në ballin e tij...”*; *“Ende mund ta ndjej ftohtësinë e dorës së tij...”*; *“Dora e tij ishte më e*

freskët se akulli dhe kishte aromë më të mirë se misku...”; “Po e ndjej freskinë e këmbëve të tij në dorën time...”

24. Të marrësh udhë me të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duke qenë dëshmitar i ngjarjeve të ditës së tij, domosdo do të gjenerosh dashuri për shpirtin. Pa dyshim, sahabët e donin dhe e respektonin atë si askënd tjetër. Me të vërtetë, çdo gjë që ata panë në jetën e tij i mbushi zemrat e tyre me më shumë dashuri dhe respekt për të. Çdo detaj në jetën e tij fitonte më shumë respekt dhe atraksion. Neve nuk mund ta përjetojmë atë që e përjetuan ata, por sigurisht se mund të mësojmë nga ajo. Sa më shumë që e shikojmë dhe meditojmë mbi atë që shokët e tij panë dhe dëgjuan nga i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], aq më afër i afrohemi dashurisë së tij ashtu siç e donin ata. Të qenit në shoqëri me të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e pasuron dashurinë e tij në zemrat tona. Ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], është njeriu të cilin sa më mirë që e njihni, aq më shumë e doni, dhe sa më shumë që mësoni rreth tij, aq më shumë ju rritet shpresa për ta parë.

Shpesh lexoj tregime të caktuara të jetës së tij dhe e ndjej zbrazëtinë e urëlidhjes ashtu që t'i shoh ngjarjet që ndodhin para meje. Ndjej afërsinë e tij dhe pothuajse zhytem në dritën e tij. Është sikur pothuajse po e nuhas ajrin që ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e thithte. Dua të gjunjëzohem dhe t'ia puth dorën e ta ndjej freskinë e shuplakës së tij. Dëshiroj t'i them nga thellësia e zemrës: "Pasha Allahun, të dua, o i Dërguari i Allahut; të dua më shumë se veten time."

Zoti ynë, ne besojmë në të Dërguarin Tënd, Pejgamberin Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], dhe e pasojmë atë pa e parë fare. Zoti ynë, mos na privo që ta shohim atë, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në Ditën e Gjykimit. Na ringjall në mesin e pasuesve të tij dhe na bëj nga ata për të cilët ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], do të ndër-mjetësojë te Ti. Na mundëso të pijmë nga lumi i tij dhe na e mundëso të jemi në shoqërinë e tij në qiellin e lartë, së bashku me ata të cilët i ke mëshiruar Ti: të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe ata të cilët kurrë nuk devijojnë nga e Vërteta, shehidët dhe të singertit. Sa shoqëri e mirë që janë ata!

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Zoti ynë, ne besojmë në atë që na e ke zbritur dhe e pasojmë të Dërguarin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], andaj na shkruaj në regjistrin e të sinqertëve.

Zoti ynë, zbrit paqe dhe begati mbi Muhamedin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe familjen e tij, ashtu siç zbritë paqe dhe begati mbi Ibrahimin [alejhis-selam] dhe familjen e tij. Ti je Ai i Cili i meriton të gjitha falënderimet.

Një ditë me Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Përmbajtja:

Parathënie	7
Hyrje	9
Në shoqëri njëditore me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	12
Në agim me të Dërguarin e Allahut.....	14
[sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	14
Në mëngjes me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	29
Në xhami me të Dërguarin e Allahut.....	40
[sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	40
Në rrugët e Medinës, me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	61
Në vizitë ndaj të afërmeve dhe miqve me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].....	70
Në vizitë ndaj të sëmurëve me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	85
Në kopshtet e Medinës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	89
Në kotjen ditore me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	94
Në Kuba me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	106

Në mesditë me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	109
Pasditë me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	120
Pas perëndimit të diellit me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	131
Në namazin e natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	140
Në pjesën e parë të natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	144
Në thellësinë e natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	153
Ecja në thellësinë e natës me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	165
Një sy gjumë para agimit me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]	170
Përmbledhje e shëtijes njëditore me të Dërguarin e Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].....	171

NJË DITË *me* PROFETIN

[sal-lallahu alejhi ve sel-lem]

Në vazhdën e ditës së të Dërguarit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe ngjarjeve të jetës së tij, gjejmë atë që është përsosmërisht konsistente me përvojën njerëzore, në kontekstin më të gjerë dhe në aspektet e zakonshme. Kështu, do të mund ta shohin shembullin më të afërt të madhështores, njerëzores dhe praktikës: ***“Thuaj “SubhanAllah - i Madhërishëm është Zoti im, a mos jam unë tjetër vetëm se njeri, Pejgamber?””*** (El-Isra: 93)

Ajo çfarë ndodhte në një ditë, jo doemos ndodhte çdo ditë. Megjithatë, vlera e tyre e përgjithshme, na e jep për së afërmi një panoramë të asaj që ndodhte në një ditë të jetës së tij, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Në ditën e tij, çdo çast është i begatë. Asnjë sekondë nuk tretet, nuk humbet kot. Marrëveshjet me vetë jetën bëheshin në çdo sekondë në shtëpinë e tij, në xhami, nëpër rrugicat e Medinës, në shtëpitë e shokëve të tij, në rrogozin e fortë ku ai ulej, gjatë ngrënies së ushqimit, në shtrat dhe kur bëhej gati për të fjetur.

ISBN 978-608-216-174-7

